



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**“AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE MBI VEPRIMTARINË E AGJENCINË**  
**KOMBËTARE TË MJEDISIT”**



<b>PERMBAJTJA</b>	<b>Faqe</b>
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3-8
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	8-14
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	15-17
<b>II. Hyrje.....</b>	<b>17-21</b>
a. Titulli	
b. Marrësi	
c. Objektivat dhe qëllimi	
d. Identifikimi i çështjes	
e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
ë. Përgjegjësitë e audituesve	
f. Kriteret e vlerësimit	
g. Standardet e Auditimit	
h. Metodot e auditimit	
i. Dokumentimi i auditimit	
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>22-110</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	21-22
2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit.....	22-110
2.1. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit: .....	22-28
2.2. Prokurimet e fondeve publike:.....	29-41
2.3. Mbi auditimin e procedurave të miratimit të Lejeve Mjedisore të Tipit A, B, Licencat III.2.B dhe pranimit të Raporteve të vet monitorimit në AKM.....	41-64
2.4. Mbi auditimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara.....	65-70
2.5. Mbi auditimin e procedurave të kryerjes së inspektimeve dhe marrjen e masave për ndotësit e mjedisit.....	70-92
2.6. Analizimi i apelimeve, marrja e vendimeve, aplikimi dhe ndjekja e sanksioneve të vendosura.....	92-107
2.7. Të tjera gjate auditimit.....	107-110
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....</b>	<b>110-119</b>



## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

*Hartimi dhe zbatimi i buxhetit:*

AKM Tiranë, me shkresë nr.4299, datë 30.08.2019, i ka paraqitur MTM Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2020-2022, sipas relacionit pasqyrave përkatëse bashkëlidhur, si dhe Projekt-Buxhetin e AKM për vitin 2020. Në objektivat janë paraqitur ato referuar monitorimit të mjedisit, informimit të publikut, realizimit të funksionit rregullator për lejet e mjedisit dhe VNM, për informacionin dhe statistikat mjedisore.

Për vitin 2021, AKM Tiranë, nuk i ka paraqitur MTM Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2021-2023, dhe as Projekt-Buxhetin e AKM për vitin 2022, ku nga dokumentacioni i paraqitur nuk u gjet asnjë dokument për këtë qëllim.

Nga buxheti i planifikuar e akorduar rezulton se: buxheti i vitit 2020 është realizuar në masën 78%, pra me mosrealizim, dhe ne vlerë absolute me një vlerë prej 27,729,317 lekë diferencë; buxheti i vitit 2021 është realizuar në masën 85 %, pra me mosrealizim, dhe ne vlerë absolute me një vlerë prej 24,277,455 lekë; buxheti i vitit 2022 është realizuar në masën 91 %, pra me mosrealizim, dhe ne vlerë absolute prej 15,880,393 lekë diferencë.

Shkak i këtyre mosrealizimeve është planifikimi dhe kërkesa e fryrë dhe e paargumentuar e shpenzimeve. Zërat e mësipërm, në mosrealizimin e tyre, tregojnë në mënyrë eksplicite faktin se sa i shkëputur ka qenë procesi i hartimit të planit nga situata dhe nevojat faktike, sidomos për pagat, mirëmbajtjen e automjeteve, të pajisjeve të zyrave, etj.

Ndikim të konsiderueshëm ka patur mos realizimi i investimeve prej 8,960,000 lekë, të cilat janë gjendje në thesar, referuar shkresës së MTM nr. 6783 prot., datë 12.11.2020 lidhur me transferimin e fondeve për “Pasaporta Dixhitale Mjedisore”.

*Prokurimet e fondeve publike*

Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kritereve të pjesëmarrjes kundrejt operatorëve ekonomikë. Në 4 raste:

1. Urdhër Prokurimi Nr. 10, Datë 17.07.2020. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban”,
  2. Urdhër Prokurimi Nr. 5, Datë 25.03.2021. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluar në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni lëvizës”,
  3. Urdhër Prokurimi Nr. 134, datë 16.06.2022. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje reagentësh dhe materiale laborator”,
  4. Urdhër Prokurimi Nr. 09, Datë 05.05.2022. Zhvillimi i procedurës “Shërbim projektimi për rikonstruksionin e godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”,
- Njësia e Prokurimit, në hartimin e DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, “Kapaciteti teknik”, ka kërkuar: “Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, si dhe “Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, duke vepruar në kundërshtim me (VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 3 ç’fuqizuar) VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 4, ku është përcaktuar: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Veprime këto në shkelje të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 4.

Në prokurimet me vlera të vogla, nga Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes kundrejt operatorëve ekonomikë:

-Në 1 rast, prokurimi me vlerë të Vogël në vitin 2022 “Shërbim eksperti për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit”.

Në dosjen e paraqitur, mungon dokumentacion për punësimin e 2 inxhinierëve me eksperiencë të diplomuar në fushat elektronike, elektrike (pasi fotokopjet e paraqitura nuk vërtetojnë punësimin dhe marrëdhëniet e punës me këta inxhinierë).

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021), Neni 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” pika 4.

*Mbi auditimin e procedurave të miratimit të Lejeve Mjedisore të Tipit A, B, Licencat III.2.B dhe pranimit të Raporteve të vet monitorimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.*

-Nga komunikimi shkresor midis AKM dhe QKB u konstatua se: në regjistrin e lejeve ekzistojnë leje me format të vjetër, VNM/Deklarata Mjedisore si dhe subjekte të pajisur me leje mjedisore apo VNM pa raportuar asnjëherë konkretisht, 1274 Leje Mjedisore format i vjetër si dhe 590 VNM/Deklarata Mjedisore. Nga të cilat rezultojnë se subjekte disponues të këtyre lejeve mjedisore aktualisht janë me status pezulluar dhe jo aktiv në 271 raste që korrespondojnë me leje mjedisore format i vjetër si dhe 71 raste që korrespondojnë VNM/Deklarata Mjedisore. Mos azhurnimi dhe përditësimi i të dhënave të subjekteve pajisur me leje mjedisore është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 30 pika 1 dhe 2.

-Në 13 raste për të njëjtin instalim nga i njëjti subjekt ka dy apo më shumë leje mjedisore (PN) të lëshuar në vite, megjithëse është aprovuar Leja Mjedisore e re, në asnjë rast nuk është revokuar Leja Mjedisore e vjetër. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 8 “Kërkesat e përgjithshme për përdorimin e lejes së mjedisit të tipit A” pika 1 dhe 2 ; neni 20 “Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B” pika 1 dhe 2; si dhe neni 30 pika 1.

-Në 14 raste nga komisioni i verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimit të lejeve mjedisore në AKM janë miratuar kërkesa në mungesë dokumentacioni të kërkuar ligjor për subjektet: “N.2010”; “E”; “A.A”; “B.T”; “E.R”; “V.A.L.E. R”; “A”; “R.O”; “E.A”; “Z.P”; “E.E”; “K-F”; “PX”; “A&C”. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 4; nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar; ligjin me nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” ; VKM nr. 575, datë 24.6.2015; VKM nr. 419, datë 25.06.2014; si dhe VKM nr. 538, datë 26.5.2009.

-Nga mos evidentimi dhe arkëtimi i detyrimeve debitorë nga tarifat vjetore për numrin e lejeve mjedisore, për vitet 2020 - 2021 konstatohet një diferencë tarife vjetore prej 13 040 000 lekë. Gjithashtu nga evidentimi i bërë nga sektori i financës së AKM-së për periudhën 2015 deri më qershor 2020, janë evidentuar detyrime të tarifës vjetore për 840 subjekte në shumën 8 522 000 lekë. Në momentin e auditimit nga Sektorin e Financës në AKM nuk disponohet lista e 840 subjekteve debitorë. Sektorin e Monitorimit nuk ka bërë evidentimin e subjekteve të pajisur me leje mjedisore A dhe B për likuidimin e tarifës vjetore të lejeve sipas VKM nr. 417 datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit”, detyrë kjo funksionale e përcaktuar në rregulloren e AKM-së. Ky sektor duhet të kishte bashkërenduar informacionet me sektorin e financës dhe buxhetit për të evidentuar subjektet që kanë bërë likuidimin e tarifës dhe më pas të hartonte listën e subjekteve që nuk kanë likuiduar këtë tarifë dhe t’ja paraqiste drejtorit të drejtorisë. Kjo listë do



## Kontrolli i Lartë i Shtetit Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”

shërbente edhe si bazë për planifikimin e inspektimeve nga DIK. Veprime në kundërshtim ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 5 dhe neni 9 “Arkëtimet”, pika i; VKM nr. 417 datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit”, (ndryshuar me VKM-në nr. 462, datë 26.7.2023).

- Për periudhën objekt auditimi nga verifikim i pajisjeve me Kod Unik Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit për 6 subjekte ka miratuar 13 kode unik, kemi miratime të Kodit Unik sa herë subjekti ka aplikuar për ndryshim të licencës, ndryshim Kodesh mbetjesh si dhe shtim të vendndodhjeve. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në nenet 62 dhe 63; VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020), Pika 19; si dhe VKM nr. 371, datë 11.6.2014, “Për Miratimin e Rregullave për Dorëzimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe të Dokumentit të Dorëzimit të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 1032, datë 16.12.2020), Pika 25.

*Mbi auditimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) paraprahe dhe të thelluara.* Nga komisionet e shqyrtimit të aplikimeve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ka miratime të VNM në shkelje procedurave ligjore:

-Në 1 raste kemi miratim të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis *Subjekti B* me Komisionin nr. 64 Tiranë, më 23.12.2020 për projektin “Dallgëthyes (pistë) dhe stacion shërbimi” Qerret, Kavajë. Miratimi i VNM pasi ka mbaruar vepra si është cilësuar edhe në raportin teknik të paraqitur vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 10440 Nenin 6 “Përkufizime”. -Në 3 raste *Subjektet A-S “G-G”*, dhe “G.E”, nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura janë vendosur kushte në lidhje me afërsinë e Objektivit me Zonën e Mbrojtur. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” si dhe VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, si dhe VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.

*Mbi auditimin e procedurave të kryerjes së inspektimeve dhe marrjen e masave për ndotësit e mjedisit.*

Nga Drejtoria e Inspektimit dhe e Kontrollit për periudhën objekt auditimi janë hartuar e miratuar planë mujore inspektimi jo për tërë periudhën vjetore respektive konkretisht:

Nga Sektori i Inspektimit të Mjedisit: Për vitin 2020 ka plan inspektimi vetëm për muajin Shtator; Për vitin 2021 për 8 muaj; Për vitin 2022, për 11 muaj, Shkurt–Dhjetor.

Nga Sektori i Inspektimit të Ujërave: Për vitin 2020 ka plan inspektimi vetëm për 2 muaj Gusht, Shtator; Për vitin 2021 për 4 muaj; Për vitin 2022, për 5 muaj, Shkurt–Dhjetor.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit”

- në 9 raste në kryerjen e inspektimeve referuar dokumentimin on-line ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative, në subjektet “E”; “A-C”; “11 H”; “G.D.F”; “4A.M”; “B.V.2013”; “Ch.L”; “D.B”; “P”. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", date 7/14/2011i ndryshuar, neni 29, Pika 1, ligjin nr.10463, “Për menaxhimin e integruar te mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar, nenin 21, pikat 9, 10, dhe nenit 57, si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm



- në 6 raste në kryerjen e inspektimeve referuar dokumentimin on-line ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative, konkretisht: “E”; B.B; D.T; Gj.L; K.A.A; N. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar; ligjin nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar; VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020); Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Urdhri nr.13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm.

*Analizimi i apelimeve, marrja e vendimeve, aplikimi dhe ndjekja e sanksioneve të vendosura*

Për vitin 2020 janë përzgjedhur 2 dosje për shqyrtim

Subjekti “K.P” me Nr. AKM-FR-..... datë, 25.09.2020 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë i është vendosur masë administrative gjobë 2.000.000 lekë. Nga ana e AKM nuk është sugjeruar inspektim specifik me mjete matëse të pretendimit të inspektorëve nga konstatimi me sy të lirë të rrjedhjes minimale ekologjike.

Subjekti “A.K” me Nr. AKM-TR.... datë 12.11.2020 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit i është vendosur masë administrative me vlerë 300.000 lekë. Subjekti është gjobitur në shkelje “Për Lejet e Mjedisit”: Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, ose B nga operatori një instalimi. Nga ana e AKM nuk është sugjeruar inspektim specifik me mjete matëse të pretendimit të inspektorëve nga konstatimi.

Për vitin 2021 janë përzgjedhur 4 dosje për shqyrtim

Shoqëria “R” sh.p.k e regjistruar pranë QKB-së, me numër NIPT-t J..... Shfuqizim i aktit administrativ “Vendimit Përfundimtar të Inspektimit AKM-TR-..... datë 16.08.2021 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, i marrë në bazë të procesverbalit të Inspektimit të AKM-TR-..... Komisioni pasi shqyrtoj ankimmimin administrativ të subjektit referuar fakteve të përmendura, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vendosi: Shfuqizimin e gjobës masë administrative 1.5000.000 lekë.

Subjekti “A.G.O” sha me Nr. AKM-FR-..... datë 02.09.2021 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë i është vendosur masë administrative me vlerë 1,000,000 lekë. Subjekti është gjobitur për Kundërvajtjet Administrative për : Mos përmbushje dhe mosrespektimi i kërkesave ,parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A,B nga operatori i një instalimi si dhe për lejet e mjedisit të tipit A.

Nga komisioni nuk është dokumentuar dhe arsyetuar me dokumentacion i gjithë aktiviteti mbas transferimit të tij tek subjekti “A.G.O” realizimin e plan përmirësimi edhe për argjinaturave. Zbatimin e lejes nga Ministria e Mjedisit për kushtet e argjinaturës ekzistuese.

Subjekti “G.A.C” Shpk me nr NIPT L.... nuk disponon leje (nga QKB-ja, leje mjedisit të tipit C me PN-9351-09-2019 dhe titull instalimi “Industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve) me Vendim Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-TR-..... datë 06.10.2021, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 1.500.000 lekë për shkelje të kërkesave ligjore të nenit 62, pika 6 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2021.

Nga komisioni nuk është arsyetuar dalja e subjektit për inspektim kur nuk ka kushtet për pajisje me leje mjedisore.

Subjekti “K.K.A” me nr. NIPT K.....V me Vendim Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-TR-2021..... datë 14.07.2021, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 500.000 lekë për shkelje të kërkesave ligjore të nenit 29, pika 1.b.ii të Ligjit Nr. 10448, “Për Lejet e Mjedisit, I ndryshuar. Komisioni pasi shqyrtoi ankimmimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vendosi:



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Shfuqizimin e masë administrative gjobë në vlerën 500,000 lekë.

Për vitin 2022 janë përzgjedhur 5 dosje për shqyrtim.

K shpk, NIPT L.....C me objekt aktiviteti: “Nxjerrje,shfrytëzim, përpunim dhe transport i mineraleve” Me Leje Mjedisit Tipi B me PN-5755-09-2017. Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr.AKM-DQ-2022-000512-5, datë 24.10.2022 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për masën administrative gjobë në vlerën 500.000 lekë. Në AKM është dorëzuar dhe regjistri i shkarkimeve dhe transferimit të ndotësve, protokolluar në AKM me nr.2512 prot., datë 29.03.2022.

Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendosi:

-Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 500,000 lekë

U.K.L sh.a, NIPT J.....M, me objekt aktiviteti: “Shërbim i Ujit të pijshëm konsumatorëve dhe shitja e tij”, me Leje Mjedisit Tipi B me PN-1153-04-2022. Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-LE-....., datë 04.11.2022 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës për masën administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë.

Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendosi:

Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 500,000 lekë

R.P, NIPT J.....C, objekti i aktivitetit:“ Bar, restorant, berrari, hoteleri-turizëm import-eksport të mallrave të ndryshme industriale, bujqësore,ushqimore etj”.Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. 976-3, datë 19.08.2022 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tiranë, Durrës, Dibër, për masën administrative gjobë në vlerën 1.000.000 lekë. Komisioni ka në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar Argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë.

P.S, objekti i aktivitetit: “ Hapje dhe menaxhim baresh, restorantesh, hotelesh, fast-food etj. Shërbime turistike.” Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit. Komisioni argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë.

*Të tjera gjate auditimit*

Në lidhje me ankesat administruar në KLSH u shqyrtuan: Ankesat se bashku me dokumentacionin shoqërues, si dhe dokumentacioni i administruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

-Ankesa me Nr.prot 990 datë 27.10.2022 protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Në ankesë theksohet se Drejtori i Përgjithshëm ka rekrutuar në mënyrë jo ligjore 2 punonjëse, të cilat i ka ngritur në përgjegjësi jo në përputhje me ligjin.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në AKM mbi *procedurat e rekrutimit të punonjësve* rezultoi se proceduara e aplikimit është në përputhje me dokumentacionin e paraqitur -Në ankesën e subjektit “H.E.T.-H.E.T.H.H shpk” protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me Nr 854 prot, datë 04.10.2023, kërkohet Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-BR-202....., datë 19.09.2023, të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë, për masën administrative “Paralajmërim”, pasi është vepruar në kundërshtim me ligjin.

Nga dokumentacioni i administruar dhe audituar rezultoi: Nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve pranë AKM, në momentin e auditimit nuk është shqyrtuar ankimi pasi janë brenda afati ligjor të shqyrtimit.



## 2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimeve u konstatua se, në 4 raste në prokurimet e kryera nga Autoriteti Kontraktor konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>Urdhër Prokurimi Nr. 10, Datë 17.07.2020. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban”,</li><li>Urdhër Prokurimi Nr. 5, Datë 25.03.2021. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluar në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni lëvizës”,</li><li>Urdhër Prokurimi Nr. 134, datë 16.06.2022. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje reagentësh dhe materiale laborator”. - Njësia e Prokurimit, në hartimin e DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, “Kapaciteti teknik”, ka kërkuar: “Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, si dhe “Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, duke vepruar në kundërshtim me (VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 4, ç’fuqizuar) VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 4.</li></ol> <p>Në 1 rast</p> <p>-Urdhër Prokurimi Nr. 09, Datë 05.05.2022 zhvillimi procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim projektimi i godinës së Agjencisë”. Në dosjen e paraqitur, nuk u gjet dokumentacion nga Njësia e Prokurimit, lidhur me sigurimin dhe hartimin e specifikimeve teknike/termat e referencës si dhe për përlogaritjen e fondit për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë.</p> <p>Veprime në kundërshtim me ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, neni 124; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrit Financave nr.30, datë 27.12.2011, ” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.</p>	29-41	I mesëm	Njësia e Prokurimit të Autoritetit Kontraktor për çdo procedurë prokurimi të marrë masa që në hartimin e kriterëve të veçanta të plotësojnë Dokumentet Standarde të Tenderit në përputhje me rregullat e prokurimit publik për të mundësuar trajtim të barabartë dhe konkurrues midis konkurrentëve pjesëmarrës.
2	<p>Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimeve me blerje të vogël u konstatua se:</p> <p>- në 1 rast, prokurimi me vlerë të Vogël në vitin 2022 “Shërbim eksperti për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit”. Në dosjen e paraqitur, nuk u gjet dokumentacion i kërkuar sipas Ftesë Ofertës datë 16.03.2022 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, lidhur me sigurimin dhe hartimin e specifikimeve teknike/termat e referencës, si dhe dokumentacion për punësimin e 2 inxhinierëve me eksperiencë të diplomuar në fushat elektronike, elektrike (pasi fotokopjet e paraqitura nuk vërtetojnë punësimin dhe marrëdhëniet e punës me këta inxhinierë).</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021), Neni 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” pika 4.</p>	29-41	I mesëm	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël në ç’do procedurë prokurimi të marrë masa që të plotësojnë Dokumentet Standarde të Tenderit në përputhje me rregullat e prokurimit publik për të mundësuar pasqyrim të saktë të procedurës.
3	<p>Nga auditimi i komunikimit shpresor midis AKM dhe QKB u konstatua se: në regjistrin e lejeve ekzistojnë leje me format të vjetër, VNM/Deklarata Mjedisore si dhe subjekte të pajisur me leje mjedisore apo VNM pa raportuar asnjëherë konkretisht, 1274 Leje Mjedisore format i vjetër si dhe 590 VNM/Deklarata Mjedisore. Nga të cilat rezultojnë se subjekte disponues të këtyre lejeve mjedisore aktualisht janë me status pezulluar dhe jo aktiv në 271 raste qe korrespondojnë me leje mjedisore format i vjetër si dhe 71 raste qe korrespondojnë VNM/Deklarata Mjedisore. Mos azhurnimi dhe përditësimi i të dhënave të subjekteve pajisur me leje mjedisore është veprim në kundërshtim me</p>	41-64	I lartë	Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që të planifikojë kryerjen e inspektimeve në subjekte të konstatuar me leje mjedisore model i vjetër për të mundësuar evidentimin e veprimtarisë ose jo dhe për rastet me shkelje t’i kërkojë Ministrit të Turizmit dhe të





**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	<p>ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 30 pika 1 dhe 2.</p>			<p>Mjedisit për pezullim apo shfuqizimin e lejeve mjedisore.</p> <p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit të marrë masa që të unifikojë bazën e të dhënave mbi Lejet Mjedisore mbi të cilën operojnë Drejtori e Sektorë të AKM, duke mundësuar edhe përditësimin unik të saj.</p>																																																								
4	<p>Nga auditimi u konstatua se në 13 raste për të njëjtin instalim nga i njëjti subjekt ka dy apo më shumë leje mjedisore (PN) të lëshuar në vite, megjithëse është aprovuar Leja Mjedisore e re, në asnjë rast nuk është revokuar Leja Mjedisore e vjetër, konkretisht:</p> <table border="1" data-bbox="247 739 917 1108"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Emri Subjektit</th> <th>NIPT</th> <th>Vitet e Lejeve Mjedisore</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>1</td><td>P.G.T</td><td>K 3.....5S</td><td>2014-2022</td></tr> <tr><td>2</td><td>A.w</td><td>K8.....2B</td><td>2013-2022</td></tr> <tr><td>3</td><td>A.b.H</td><td>K3.....1E</td><td>2013-2016</td></tr> <tr><td>4</td><td>A.G.2015</td><td>L5.....0F</td><td>2012-2016</td></tr> <tr><td>5</td><td>D</td><td>L2.....1A</td><td>2012-2018</td></tr> <tr><td>6</td><td>A.B</td><td>J6.....0D</td><td>2011-2018</td></tr> <tr><td>7</td><td>P.M</td><td>K6.....2B</td><td>2011-2018</td></tr> <tr><td>8</td><td>A</td><td>K1.....1T</td><td>2011-2015-2018</td></tr> <tr><td>9</td><td>T</td><td>K2.....1I</td><td>2011-2012 s'ka te re</td></tr> <tr><td>10</td><td>B.T</td><td>J6.....1F</td><td>2011-2021</td></tr> <tr><td>11</td><td>P. X</td><td>K1.....2O</td><td>2011-2013</td></tr> <tr><td>12</td><td>M.P</td><td>K6.....0H</td><td>2011-2019</td></tr> <tr><td>13</td><td>A.G.T.</td><td>L1.....1C</td><td>2011-2022</td></tr> </tbody> </table> <p>Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 8 “Kërkesat e përgjithshme për përdorimin e lejes së mjedisit të tipit A” pika 1 dhe 2 ; neni 20 “Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B” pika 1 dhe 2 si dhe neni 30 pika 1 dhe 2.</p>	Nr.	Emri Subjektit	NIPT	Vitet e Lejeve Mjedisore	1	P.G.T	K 3.....5S	2014-2022	2	A.w	K8.....2B	2013-2022	3	A.b.H	K3.....1E	2013-2016	4	A.G.2015	L5.....0F	2012-2016	5	D	L2.....1A	2012-2018	6	A.B	J6.....0D	2011-2018	7	P.M	K6.....2B	2011-2018	8	A	K1.....1T	2011-2015-2018	9	T	K2.....1I	2011-2012 s'ka te re	10	B.T	J6.....1F	2011-2021	11	P. X	K1.....2O	2011-2013	12	M.P	K6.....0H	2011-2019	13	A.G.T.	L1.....1C	2011-2022	41-64	I lartë	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të marrë masa që të kërkojë revokimin e lejeve model i vjetër nga subjektet “P. G.T” me NIPT, K 3.....5S; “A.W” me NIPT K8.....2B; “A.b.H” me NIPT K3.....1E; “A.G.2015” me NIPT L5.....0F; “D” me NIPT L2.....1A; “A.B” me NIPT J6.....0D; “PM” me NIPT K6.....2B; “A me NIPT K1.....1T; “T” me NIPT K2.....1I; “B.Ti” me NIPT J6.....1F; “P. X” me NIPT K1.....2O dhe “M.P” me NIPT K6.....0H.</p>
Nr.	Emri Subjektit	NIPT	Vitet e Lejeve Mjedisore																																																									
1	P.G.T	K 3.....5S	2014-2022																																																									
2	A.w	K8.....2B	2013-2022																																																									
3	A.b.H	K3.....1E	2013-2016																																																									
4	A.G.2015	L5.....0F	2012-2016																																																									
5	D	L2.....1A	2012-2018																																																									
6	A.B	J6.....0D	2011-2018																																																									
7	P.M	K6.....2B	2011-2018																																																									
8	A	K1.....1T	2011-2015-2018																																																									
9	T	K2.....1I	2011-2012 s'ka te re																																																									
10	B.T	J6.....1F	2011-2021																																																									
11	P. X	K1.....2O	2011-2013																																																									
12	M.P	K6.....0H	2011-2019																																																									
13	A.G.T.	L1.....1C	2011-2022																																																									
5	<p>Nga auditimi u konstatua se në 15 raste nga komisioni i verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimit të lejeve mjedisore në AKM janë miratuar kërkesa në mungesë dokumentacioni të kërkuar ligjor:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në 1 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 25 i zhvilluar në datë 25.06.2020 u shqyrtua kërkesa e subjekti “A.K” nga AKM nuk ka sqarime të dokumentuara për mos zbatimin e afatit të lëshimit dhe publikimit të Lejes mjedisore të përcaktuar në Kreu III “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisore të tipit B”.</li> <li>- Në të 8 rastet nga komisionet janë miratuar Lejet Mjedisore për subjektet, por në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka të ngarkuar VNM. Konkretisht: Në mbledhjen e Komisionit nr. 8 i zhvilluar në datë 04.03.2021.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “N2010” LC 64161. Në mbledhjen e Komisionit nr. 3 i zhvilluar në datë 12.02.2021 janë shqyrtuar kërkesat e subjekteve “E”; “A.A” LC 9160 dhe “B.T”. Në mbledhjen e Komisionit nr. 8 i zhvilluar në datë 26.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E/R” LC 1275. Në mbledhjen e Komisionit nr. 48 i zhvilluar në datë 24.12.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “V.A.L.E. R” LC 3162. Në mbledhjen e Komisionit nr. 6 i zhvilluar në datë 11.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A”. Në mbledhjen e Komisionit nr. 2 i zhvilluar në datë 22.01.2020 u shqyrtuan kërkesa e subjektit “R.O” LC 6325. Në mbledhjen e Komisionit nr. 16 i zhvilluar në datë 27.04.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E.A”.</li> <li>- Në 2 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 14 i zhvilluar në datë 10.04.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “Z.I” LC 8285 dhe në mbledhjen e Komisionit nr. 3 i zhvilluar në datë 12.02.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E.E” LC 7860 nga ku në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka kontratë për depozitimin e mbetjeve dhe ka kontratë për depozitim mbetjesh lidhur më 01.07.2021 me</li> </ul>	41-64	I lartë	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të marrë masa që të kërkojë revokimin e lejet mjedisore të miratuar pa dokumentacionin e kërkuar ligjor për subjektet: “N 2010”;</p>																																																								



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	<p>“Nderkomunal Bushat” në adresën Bashkia Vau i Dejës Nj.A. Bushat, ndërkohe veprimtaria zhvillohet ne Durrës.</p> <p>- Në 1 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 6 i zhvilluar në datë 11.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A” nga ku aplikimi është pranuar pa dokumentacionin për shkarkimin e ujërave teknologjike,</p> <p>- Në 1 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 64 i zhvilluar në datë 24.05.2022 u shqyrtuan kërkesa e Subjekti “K-F” nga ku në dosjen e vënë në dispozicion për auditim (formatin PDF) nuk ka Formularin e dëgjimit në publik.</p> <p>- Në 1 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 53 i zhvilluar në datë 06.05.2022 u shqyrtuan kërkesa e subjektit “PX” ku nga dokumentacionin e paraqitur në PDF si dhe ngarkuara në sistem pagesa e tarifës është bërë në datë 15.04.2022 mbas datë s së aplikimit i cili mbaroi datën 17.03.2022.</p> <p>- Në 1 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 48, i zhvilluar në datë 06.10.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A&amp;C” LC 7088 nga ku miratim në heshtje pa akt-miratimi.</p> <p>Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 4; nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar; ligjin me nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; VKM nr. 575, datë 24.6.2015; VKM nr. 419, datë 25.06.2014; si dhe VKM nr. 538, datë 26.5.2009.</p>			<p>“E”; “A.A”; “B.T”; “ER”; “V.A.L.E. R”; “A”; “R.O”; “E. A”; “Z. I”; “E.E”; “K-F”; “PX”; “A&amp;C”.</p>
6	<p>Nga auditimi u konstatua se Sektori i Monitorimit në Drejtorinë e Inspektimit dhe Kontrollit në AKM nuk ka bërë evidentimin e subjekteve të pajisur me leje mjedisore A dhe B në lidhje me likuidimin e tarifës vjetore të lejeve detyrë kjo funksionale e përcaktuar në rregulloren e AKM-së. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 417 datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit”, (ndryshuar me VKM-në nr. 462, datë 26.7.2023).</p>	41-64	I lartë	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për të hartuar një bazë të dhënash unike ku të përcaktohen detyrimet e pagesës të tarifave vjetore të lejeve mjedisore nga subjektet që rezultojnë në Regjistrin Kombëtar të lejeve dhe licencave, në QKB me përditësimin nga arkëtimet.</p>
7	<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <p>- Nga verifikim i pajisjeve me Kod Unik Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit për 6 subjekte ka miratuar 13 kode unik, kemi miratime të Kodit Unik sa herë subjekti ka aplikuar për ndryshim të licencës, ndryshim Kodesh mbetjesh si dhe shtim të vendndodhjeve.</p> <p>- Për periudhën objekt auditimi nuk ka patur një rakordim/ndërveprim të dokumentuar midis Drejtorive Teknike dhe Inspektoratit në AKM pasi: Regjistri i licencave nuk është i mirë organizuar; Regjistri Kombëtar i Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme nuk është i azhurnuar në kohë me raportimet e transfertave dhe regjistrimet e Kodit Unik nga subjekte të pajisur me licencë III.2.B.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në nenet 62 dhe 63; VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020), Pika 19; si dhe VKM nr. 371, datë 11.6.2014, “Për Miratimin e Rregullave për Dorëzimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe të Dokumentit të Dorëzimit të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 1032, datë 16.12.2020), Pika 25.</p>	41-64	I lartë	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit ti kërkojë Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit për të marrë masa për revokimin e më shumë se një Kodi Unik për të 6 subjektet: “V.A.L.E. R”; “4 A-M”; “A P”; “E-P”; “GC”; “E”.</p> <p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që: Regjistri Kombëtar i Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme të azhurnohet në kohën reale të transfertave të deklaruara për të patur shkëmbim informacioni shkresor midis Drejtorive Teknike dhe Inspektoratit në AKM.</p>
	<p>Nga auditimi u konstatua se në 4 raste ka miratime të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në shkelje të procedurave ligjore konkretisht:</p> <p>- Në 1 raste kemi miratim të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis Subjekti B me Komisionin nr. 64 Tiranë, më 23.12.2020 për projektin “Dallgëthyesë (pistë) dhe stacion shërbimi” Qerret, Kavajë. Miratimi i VNM pasi ka mbaruar vepra si është cilësuar edhe në raportin teknik të paraqitur.</p> <p>-Në 2 raste</p> <p>-Subjekti A.S nga AKM me Vendimin nr. 7, datë 07.02.2020 ka miratuar Deklaratën mjedisore, me dokumentacion për dëgjuesën me publikun në vend ndodhjen e instalimit mbajtur në 13.11.2018 jo konform modelit të përcaktuar dhe pa pjesëmarrje publiku të</p>	65-70	I lartë	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që të planifikojë kryerjen e inspektimeve në subjekte, Bt, A-S, G.E dhe G-G, për vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedis.</p>



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

8	<p>dokumentuar me nënshkrime të rregulla nga ana vizuale. Megjithëse AKM me shkresë nr. 3105, datë 20.06.2019 “Njoftim për vazhdim procedure të VNM të thelluar” në qëndrimin e saj ka kërkuar plotësimin e informacionit me Konsultimin me publikun.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Subjekti “G.B”, komisioni nr. 06, datë 03.02.2022 ka miratuar “Deklarata Mjedisore” për projektin “Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike” (Ndërtim HEC “guri i bardhë 1 dhe 2) subjektit “G.B”.</li><li>- Nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura janë vendosur kushte në lidhje me afërsinë e Objektivit me Zonën e Mbrojtur.</li><li>- Në historikun e aplikimit pasqyruar në sistem konstatohet se në datë 07.09.2021 nga Njësia e Qeverisjes Vendore Klos është marrë “Aprovim automatik në heshtje” nga kërkesa e dërguar po në datë 31.08.2021. Nga Agjencia Rajonale e Mjedisit nuk është e dokumentuar qëndrimi i banorëve që kanë marrë pjesë në peticionin kundër objektivit, si dhe nuk ka sqarime apo korespondencë me NjQV Klos mbi peticionin e banorëve për të cilin është shprehur në shkresën e datës 21.04.2020.</li><li>- Në 1 rast me Vendimin nr. 45, datë 26.08.2020, vendosi Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për Zhvilluesin Personi juridik: “G-G” sh.p.k. Në dokumentacionin e administruar në sistemin “e-leje” nuk ka shkresë nga AKZM në shqyrtim të pozicionimit të karrierës në lidhje Zonën e Mbrojtur çka përbën kusht për shqyrtimin dhe dhënien e lejes mjedisore Veprime në kundërshtim me: Ligjin nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”; VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.; si dhe VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.</li></ul>			
9	<p>Nga auditimi u konstatua se në 9 raste në kryerjen e inspektiveve referuar dokumentimin on-line ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Proces-verbali i inspektimit datë 25.08.2020; Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. 5, datë 28/09/2020 në subjektin “E” shpk NIPT: K3.....2W. Grupi i inspektimit në dokumentacionin e inspektuar nuk ka paraqitur pajisjen të subjekt “E.K” me Licencë III. 2. B, si dhe paraqitja Regjistrale për menaxhimin e mbetjeve nuk është në përputhje me kërkesat ligjore. Për këtë nuk është vepruar me Masat Administrative të përcaktuara në ligjin nr. 10463/2011.</li><li>- Procesverbali i inspektimit datë 03.11.2021 në Subjektin: “A.C” shpk NIPT: K0.....1W, dhe procesverbali i inspektimit datë 03.11.2021 në Subjektin: “11H” shpk NIPT: K0.....1W. Vendimet e inspektimit në të dy rastet korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm.</li><li>- Proces –verbali i inspektimit datë 04.11.2021 në Subjektin: “G.D.F” NIPT: L8.....2M Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative e klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobë: 500,000 lekë; Gjobë: 300,000 lekë; Gjobë: 1,000,000 lekë; Gjobë: 300,000 lekë. Aplikimi i dënimit kryesor me gjobe sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datës 04.11.2021 dhe marrja e Vendimit datë 24.11.2021 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ me Gjobe në 4 raste nuk mbështetet dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës.</li><li>- Proces –verbali i inspektimit datë 30.06.2022, në Subjektin: 4 A-M NIPT: K9.....6L. Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit datë 14.07.2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ dhe është cilësuar “Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive”. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë.</li><li>- Proces –verbali i inspektimit datë 12.05.2022 në Subjektin: “B.V2013” NIPT: L3.....1V. Nga Inspektorët nuk është konstatuar shkelja e mos pagesës së tarifës jashtë afatit në datë 10.05.2022. Nuk ka</li></ul>	70-92	I lartë	Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektim Kontrollit të marrë masa për të analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për aplikimin e dënimeve administrative në Procesverbalet e Inspektimit dhe anulimin e tyre në Vendimet e marra, si dhe të planifikojë Inspektime për verifikim e konstatimeve dhe detyrave të lëna nga inspektimet në subjektet e inspektuara si dhe subjektet:



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	<p>dokumentacion për argumentimin e mos aplikimit të Gjorbës së propozuar në Proces-Verbal datë 12.05.2022, dhe marrjen e Masës Administrative “paralajmërim”.</p> <p>- Proces–verbali i inspektimit datë 16.11.2022 në subjektin “C.L” NIPT: L7.....4C. Nuk ka dokumentacion për mos aplikimit të Gjorbës për shkeljen e konstatuar. Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit datë 14/12/2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ “...Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive”.</p> <p>- Proces–verbali i inspektimit datë 23.11.2022 në subjektin D.B” NIPT: K9.....2R. Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjorbë: 300,000 lekë. Aplikimi i dënimit kryesor me gjorbë sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datës 23.11.2022 dhe marrja e Vendimit datë 16/12/2022 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ.</p> <p>- Proces–verbali i inspektimit datë 03.06.2022 në Subjektin “P” NIPT: J6.....6G. Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjorbë: 300,000 lekë; Gjorbë: 1,000,000 lekë; Aplikimi i dënimit kryesor me gjorbë sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datës 04.11.2021 dhe marrja e Vendimit datë 01.07.2022 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ me Gjorbë në 2 raste nuk mbështetet në dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës të Inspektimit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", datë 7/14/2011 i ndryshuar, nenin 29, Pika 1, ligjin nr.10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar, nenin 21, pikat 9, 10, dhe nenin 57, si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020). Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit.</p>			<p>“E” shpk NIPT: K3.....2W, "A.C" shpk NIPT: K0.....1W, "11H" shpk NIPT: K0.....1W, “G.D.F” NIPT: L8.....2M, 4 A-M NIPT: K9.....6L, “B.V2013” NIPT: L3.....1V, “C.L” NIPT: L7.....4C, D.B” NIPT: K9.....2R dhe “P” NIPT: J6.....6G.</p>
10	<p>Nga auditimi u konstatua se në 6 raste në kryerjen e inspektimeve referuar dokumentimin on-line ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative, konkretisht:</p> <p>Në 1 rast, Proces –verbali i inspektimit datë 08.06.2021 në subjektin “E”shpk NIPT: K3.....2W. Grupi i inspektimit në dokumentacionin e inspektuar nuk ka paraqitur “Kontratë evadimi mbetje jo të rrezikshme” me subjekt të pajisur me Licencë III. 2. B, si dhe nuk referohen apo paraqiten Regjistrat për menaxhimin e mbetjeve. Duke mos vepruar me Masat Administrative</p> <p>Në 5 raste</p> <p>-Proces–verbali i inspektimit datë 08.11.2022 në subjektin B.B</p> <p>-Proces–verbali i inspektimit datë 09.11.2022 në subjektin D.T</p> <p>-Proces–verbali i inspektimit datë 11.11.2022 në subjektin GJ.L</p> <p>- Proces–verbali i inspektimit datë 08.06.2022 në subjektin K.A.A</p> <p>- Proces –verbali i inspektimit datë 10.06.2022 në subjektin N</p> <p>Në proces verbalet e inspektimit nuk është cilësuar mbarimi i afatit të lejes së përdorimit të basenit ujqor por vetëm aplikimi për rinovim të lejes, dhe nuk theksohet që hyrja në fuqi e lejes së përdorimit bëhet “Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve”</p> <p>Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar; ligjin nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar; VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020); Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Urdhri nr.13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm</p>	70-92	I lartë	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektimit Kontrollit të marrë masa të planifikojë Inspektime për verifikim e konstatimeve dhe detyrave të lëna nga inspektimet në subjektet e inspektuara si dhe në subjektet: B.B, D.T, GJ.L, K.A.A dhe N, për verifikimin e pajisjes me leje përdorimi të basenit ujqor dhe aplikimin e kundërvajtjes administrative “gjorbë”.</p>



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

11	<p>Nga auditimi u konstatua se nuk ka inspektime të kryera me indicje nga rezultatet negative laboratorike për mostrat e mara në instalimet e subjekteve që ndotin mjedisin, konkretisht:</p> <p>Për periudhën objekt auditimi sipas indicjeve janë kryer 33 analiza nga laboratorit i analizimit të mostrave, nga të cilat: 5 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga institucionet e tjera (Policia, Prokurori), 19 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga AKM apo Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, si dhe 9 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga Taks-Forcë për sezonin turistik 2022.</p> <p>Në asnjë rast nuk ka informim për Drejtorinë e Inspektimit të Kontrollit mbi rezultatet e analizimit si për ato që kanë rezultuar me shkelje të normave të lejuara për mjedisin edhe për ato që kanë rezultuar brenda normave të lejuara. Inspektimet e kryera në këto subjekte janë sipas planifikimit të DIK, dhe në asnjë rast nuk kanë lidhje me rezultatet e analizimit të mostrave të ardhura në laborator apo të marra nga vetë specialistët e laboratorit.</p> <p>Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448 “Për Lejet e Mjedisit”, datë 7/14/2011 i ndryshuar; ligjin nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar; ligjin nr.10463, “Për menaxhimin e integruar të mbejtjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar; Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; “Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit” me nr. 120, datë 12.01.2021.</p>	70-92	I lartë	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të marrë masa:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Të hartojë një bazë të dhënash të aksesueshëm mbi historikun e rezultateve të analizimit për subjektet në të cilët merren mostrat për analizim nga Drejtoria e Regjistrave Mjedisore e Inovacionit dhe Analizave Laboratorike.</li><li>-Të përcaktojë mënyrën shpresore për shkëmbim informacionesh midis drejtorive të AKM.</li></ul> <p>Informacione këto për të përcaktuar riskun e inspektimeve dhe marrjen e masave për ndotësit e mjedisit.</p>
12	<p>Nga auditimi u konstatua se nga Drejtoria e Inspektimit dhe e Kontrollit për periudhën objekt auditimi janë hartuar e miratuar planë mujore inspektimi jo për tërë periudhën vjetore respektive konkretisht:</p> <p>Nga Sektori i Inspektimit të Mjedisit:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Për periudhën Gusht-Dhjetor 2020, vetëm për muajin Shtator.</li><li>-Për periudhën Janar-Dhjetor 2021 për 8 muaj, Muajt Janar-Shkurt, Maj-Qershor, dhe Gusht - Nëntor.</li><li>-Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, për 11 muaj, Shkurt-Dhjetor.</li></ul> <p>Nga Sektori i Inspektimit të Ujërave</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Për periudhën Gusht-Dhjetor 2020, për 2 Muajt Gusht dhe Shtator.</li><li>-Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, për 4 Muajt Qershor-Korrik dhe Nëntor-Dhjetor.</li><li>-Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, për 5 Muajt Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Nëntor.</li></ul> <p>Në asnjë rast nuk ka analizë risku, në përzgjedhjen e veprimtarive apo subjekteve për inspektim dhe në asnjë rast nuk ka planifikim të kontrolleve për rekomandimet e lëna për përmirësimin e situatës mjedisore në rastet e konstatimit të shkeljeve.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit”</p>	70-92	I lartë	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektimit të Kontrollit të marrë masa:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Në planet vjetore të planifikojë edhe inspektimet për verifikimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e situatës mjedisore në rastet e konstatimit të shkeljeve.</li><li>- Në bazë të vlerësimit të riskut dhe përcaktimit të subjektet me risk të lartë me ndikim në mjedis. të hartojë Planin Strategjik të Inspektimeve dhe në përputhje e zbatim të tij të hartojë e të miratojë Planet Vjetore e Mujore të Inspektimeve.</li></ul>
13	<p>Nga auditimi i apelimeve të masave administrative u konstatua:</p> <p>1.Subjekti “ K.I” me Nr. AKM-FR-2020-00007-5 datë, 25.09.2020 i është vendosur masë administrative gjobë 2.000.000 lekë. Nga konstatimi në shkelje të nenit 39 të Ligjit Nr. 110/2012 datë 15.11.2020 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (i ndryshuar). Komisioni i AKM-së pasi ka shqyrtuar ankimin administrativ referuar analizave dhe fakteve të pretenduara ka vendosur të shfuqizojë masën administrative të marrë, ne mbështetje të pikës 4 nenit 137, Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.</p> <p>2.Subjekti “A.K” me Nr. AKM-TR-2020-000087-1 datë 12.11.2020 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit i është vendosur masë administrative me vlerë 300.000 lekë. Subjekti është gjobitur ne shkelje “Për Lejet e Mjedisit”, për mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatës të mjedisit ti tipave A, ose B nga operatori në një instalimi.</p> <p>të vendosur nga inspektorët e Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tirane, për shkelje të nenit 29 pika 1/b,ii të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar. Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit</p>			<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Sektori i Ankimeve, (Apelim,</p>



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	<p>ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendosi: Shfuqizimin e masë administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë.</p> <p>3. R.P, objekti i aktivitetit:“ Bar, restorant, birrari, hoteleri-turizëm import-eksport të mallrave të ndryshme industriale, bujqësore, ushqimor etj”.</p> <p>Komisioni. Ka në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar konkretisht:</p> <p>a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.</p> <p>b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar.</p> <p>Argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë.</p> <p>4. P.S shpk, objekti i aktivitetit: “ Hapje dhe menaxhim baresh, restorantesh, hotelesh, fast-food etj. Shërbime turistike.”</p> <p>Komisioni. Ka marrë në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar konkretisht:</p> <p>a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.</p> <p>b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar.</p> <p>Argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë.</p>	92-107	I lartë	Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve) në rastet e ndryshmeve të vendimeve të analizojë vendosjen e masave administrative të pa mbështetura ligjërisht duke propozuar edhe masa administrative për personat përgjegjës.
14	<p>Nga auditimi u konstatua se nga mosrakordimi ndërmjet drejtorive dhe sektorëve të AKM-së për numrin e lejeve mjedisore, për vitet 2020 - 2021 evidentohet një diferencë tarife vjetore e pa arkëtuar prej 13 040 000 lekë. Gjithashtu nga evidentimi i bërë nga sektori i financës së AKM-së për periudhën 2015 deri më qershor 2020, janë evidentuar detyrime të tarifës vjetore për 840 subjekte në shumën 8 522 000 lekë. Në momentin e auditimit nga Sektorin e Financës në AKM nuk disponohet lista e 840 subjekteve debitorë.</p>	41-64	I lartë	Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të mundësojë evidentimin dhe arkëtimin e detyrimeve debitorë si dhe arkëtimin detyrime të tarifës vjetore nga 840 subjekte në shumën 8 522 000 lekë duke e evidentuar këto subjekte.

### **3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit**

#### ***Opinion mbi përputhshmërinë: (I modifikuar/kualifikuar)***

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me procedurat e lëshimit të lejeve mjedisore, monitorimin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore, inspektimet, etj.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë.

#### **Baza për opinionin**



Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne jemi të pavarur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

Në besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kualifikuar. Dhënien e opinionit të **modifikuar/kualifikuar** e mbështesim në konkluzionet e mëposhtme të arritura në përfundim të procesit të auditimit për marrjen e masave në zgjidhjen e çështjeve:

-Nga komunikimi shkresor midis AKM dhe QKB u konstatua se: në regjistrin e lejeve ekzistojnë leje me format të vjetër, VNM/Deklarata Mjedisore si dhe subjekte të pajisur me leje mjedisore apo VNM pa raportuar asnjëherë konkretisht, 1274 Leje Mjedisore format i vjetër si dhe 590 VNM/Deklarata Mjedisore. Nga të cilat rezultojnë se subjekte disponues të këtyre lejeve mjedisore aktualisht janë me status pezulluar dhe jo aktiv në 271 raste qe korrespondojnë me leje mjedisore format i vjetër si dhe 71 raste qe korrespondojnë VNM/Deklarata Mjedisore. Mos azhurnimi dhe përditësimi i të dhënave të subjekteve pajisur me leje mjedisore është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 30 pika 1 dhe 2

-**Në 13 raste** për të njëjtin instalim nga i njëjti subjekt ka dy apo më shumë leje mjedisore (PN) të lëshuar në vite, megjithëse është aprovuar Leja Mjedisore e re, në asnjë rast nuk është revokuar Leja Mjedisore e vjetër. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 8 “Kërkesat e përgjithshme për përdorimin e lejes së mjedisit të tipit A” pika 1 dhe 2 ; neni 20 “Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B” pika 1 dhe 2; si dhe neni 30 pika 1 dhe

-**Në 14 raste** nga komisioni i verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimit të lejeve mjedisore në AKM janë miratuar kërkesa në mungesë dokumentacioni të kërkuar ligjor për subjektet: “N2010”; “E”; “A.A”; “B.T”; “E.R”; “V.A.L.E.R “A”; “R.O”; “E.A”; “Z.I”; “E.E”; “K.F”; “P.X”; “A.C”. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 4; nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar; ligjin me nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” ; VKM nr. 575, datë 24.6.2015; VKM nr. 419, datë 25.06.2014; si dhe VKM nr. 538, datë 26.5.2009.

- Për periudhën objekt auditimi nga verifikim i pajisjeve me Kod Unik Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit për 6 subjekte ka miratuar 13 kode unik, kemi miratime të Kodit Unik sa herë subjekti ka aplikuar për ndryshim të licencës, ndryshim Kodesh mbetjesh si dhe shtim të vendndodhjeve. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në nenet 62 dhe 63; VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020), Pika 19; si dhe VKM nr. 371, datë 11.6.2014, “Për Miratimin e Rregullave për Dorëzimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe të Dokumentit të Dorëzimit të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 1032, datë 16.12.2020), Pika 25.

- **Në 4 raste** ka miratime të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në shkelje të procedurave ligjore subjektet: B, A.S, G,B dhe G-G. Veprime në kundërshtim me: Ligjin nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”; VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.; si dhe VKM nr.



247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.

- **Në 9 raste** në kryerjen e inspektimeve referuar dokumentimin on-line ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative, në subjektet “E”; “A.C”; “11H”; “G.D.F”; “4 A-M”; “B.V2013”; “C.L”; “D.B”; “P”. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", date 7/14/2011 i ndryshuar, neni 29, Pika 1, ligjin nr.10463, “Për menaxhimin e integruar te mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar, nenin 21, pikat 9, 10, dhe neni 57, si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm.

- **Në 6 raste** në kryerjen e inspektimeve referuar dokumentimin on-line ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative, konkretisht: “E”; B.B; D.T; G.J.L; K.A.A; N. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar; ligjin nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar te mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar; VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020); Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Urdhri nr.13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm.

- nga Drejtoria e Inspektimit dhe e Kontrollit për periudhën objekt auditimi janë hartuar e miratuar planë mujore inspektimi jo për tërë periudhën vjetore respektive konkretisht:

Nga Sektori i Inspektimit të Mjedisit: Për vitin 2020 ka plan inspektimi vetëm për muajin Shtator; Për vitin 2021 për 8 muaj; Për vitin 2022, për 11 muaj, Shkurt–Dhjetor.

Nga Sektori i Inspektimit të Ujërave: Për vitin 2020 ka plan inspektimi vetëm për 2 muaj Gusht, Shtator; Për vitin 2021 për 4 muaj; Për vitin 2022, për 5 muaj, Shkurt–Dhjetor.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit”.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit:**

Strukturat drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, janë përgjegjëse për miratimin e Lejeve të Mjedisit, Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis, si dhe Inspektimet në subjektet të pajisur me leje mjedisore në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, si dhe kryerjen e shërbimeve ndaj publikut brenda afateve ligjore, me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Stafi drejtues është përgjegjës për drejtimin e institucionit, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së mbi Auditimin e Përputhshmërisë:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat e miratimit të Lejeve të Mjedisit, Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis, si dhe Inspektimet në subjektet të pajisur me leje mjedisore, nuk paraqesin anomalie materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse miratimi i Lejeve Mjedisore dhe Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis janë kryer, në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe kërkesat ligjore. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me





auditimin e aktivitetit të institucionit gjatë të periudhës objekt auditimi, duke i përshkruar në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor, nuk lejon vënien në dispozicion të tyre, për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.562/1 prot., datë 30.06.2023, nga data 03.07.2023 deri në datë 13.10.2023, në subjektin Agjencia Kombëtare e Mjedisit për periudhën 01.01.2020 deri 31.12.2022 u krye auditimi me objekt “Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë të Agjencinë Kombëtare të Mjedisit” nga,

### Grupi i Auditimit me përbërje:

- |         |                            |
|---------|----------------------------|
| 1. A.M, | Përgjegjës grupi           |
| 2. E.S, | Audituese                  |
| 3. A.P, | Auditues (dalë në pension) |

**1. Titulli** - Mbi Auditimin e Përputhshmërisë për veprimtarinë e Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

**2. Marrësi** – Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

### 3. Objektivat dhe qëllimi

- **Objektivat** Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, mbi drejtimit e auditimit të përcaktuara në Programin e auditimit, në raport me kriteret e paracaktuara të vlerësimit, të cilat rrjedhin nga aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative, ku mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe realizimin e misionit kryesor, mbrojtjen e mjedisit.

- **Qëllimi i auditimit** është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhshmërisë së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, të cilësuara si kriteret vlerësimi, në lidhje me realizimin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit; prokurimeve e fondeve publike; procedurave të miratimit të Lejeve Mjedisore të Tipit A, B, Licencat III.2.B dhe pranimit të Raporteve të vetmonitorimit; procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara; procedurave të kryerjes së inspektimeve dhe marjen e masave për ndotësit e mjedisit; analizimit të apeliave, marrja e vendimeve, aplikimi dhe ndjekja e sanksioneve të vendosura, etj., vlerësimi dhe evidentimi i gabimeve materiale.

### 4. Identifikimi i çështjes

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) u krijua në mbështetje, të ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.568 datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizmin dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si dhe “Urdhrit të Kryeministrit Nr. 23, datë 03.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është një institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore të AKM-së dhe 4 Agjencive Rajonale të Mjedisit.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta si dhe ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara me legjislacionin në fuqi.



Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit janë: Sigurimi i performancës mjedisore; Kërkimi dhe dija mjedisore; Vlerësimi i impaktit mjedisor dhe licencimi; si dhe Inspektimi dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

Projekt Raporti Auditimit i përgatitur, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, përta i përket:

-Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis të projekteve publike si: Ndërtime godinash banimi/shërbimi; Ndërtime ujësjellësve; Rrugë; Projektet në fushën e turizmit dhe agroturizmit; Projekte infrastrukturore industriale. Në zbatim të: Ligjit nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar; Ligjit nr.10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” .

-Licencimit - Miratimet e lejeve mjedisore me specifika të veçanta sipas natyrës dhe llojit të aktivitetit, Refuzimet, si dhe ndjekja dhe administrimi i Vetë monitorimeve. Në zbatim të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

-Inspektimi dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore që kryhet nga Drejtoria e Inspektimit e Kontrollit atashuar pranë AKM në bazë të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si Inspektorat Shtetëror me funksion Inspektimit për mbrojtjen e mjedisit që përcaktohen në ligjin nr.10431, datë 9.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar.

Në lidhje me verifikimin e procedurave të mësipërme, nga Grupi i Auditimit u shqyrtuan dokumentacioni tekniko-ligjor i administruar si formularët e miratimit të lejeve mjedisore së bashku me dokumentacionin shoqëruar në formatin “PDF”, inspektimet nga sistemi “e-inspektimi”, dosjet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në sistemin “e- leje” etj.

*Drejtimit kryesore të auditimit të miratuara në programin e auditimit janë si më poshtë:*

1. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit:

a. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe shpenzimet.

2. Prokurimet e fondeve publike:

a. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.

b. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

3. Mbi auditimin e procedurave të miratimit të Lejeve Mjedisore të Tipit A, B, Licencat III.2.B dhe pranimit të Raporteve të vetmonitorimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

4. Mbi auditimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara.

5. Mbi auditimin e procedurave të kryerjes së inspektimeve dhe marrjen e masave për ndotësit e mjedisit.

6. Analizimi i apeliemeve, marrja e vendimeve, aplikimi dhe ndjekja e sanksioneve të vendosura.

7. Të tjera gjate auditimit.

## **5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar**

Strukturat drejtuese dhe punonjësit e subjektit Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM-ja) kanë përgjegjësi për Sigurimi i performancës mjedisore; Kërkimin mjedisore; Vlerësimi i impaktit mjedisor dhe licencimi; si dhe Inspektimi dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

-Sigurimin e performancës mjedisore: në përcaktimin e standardeve, kritereve mjedisore dhe metodologjive/udhëzuesve për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit; vlerësimin e vazhdueshëm të statusit mjedisor, rolit të aktivitetit njerëzor e natyror mbi mjedisin si dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e mjedisit; garantimin e ndërveprimit të efektshëm dhe angazhimin/pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm (institucione, shoqëria civile, biznesi, komunitetet dhe qytetarët).



-Kërkimin dhe dijen mjedisore: kryerjen e kërkimeve, analizave e bashkëpunimeve shkencore dhe propozimin e metodave e të teknikave inovative për rritjen e efektshmërisë së sektorit të mjedisit, përfshi implementimin e teknologjive inovative me impakt sa më të vogël në mjedis; projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e sistemit të integruar të informacionit (përfshi atë gjeografik - GIS), si dhe të regjistrave mjedisore, nëpërmjet të cilëve sigurohet informacioni në sektorin e mjedisit; ngritjen dhe administrimin e rrjetit të pajisjeve matëse të treguesve mjedisore dhe të laboratorëve mjedisore, të teknologjisë dhe infrastrukturës mjedisore, të cilat mundësojnë kryerjen në kohë të analizave mjedisore.

-Vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licencimin: vlerësimin e ndikimit në mjedis të shkaktuar nga projekte, aktivitete të subjekteve të ndryshme dhe fenomene natyrore/klimaterikë etj., duke mundësuar një mjedis brenda standardeve dhe parametrave të kërkuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, për jetë cilësore dhe të shëndetshme të qytetarëve; përgatitjen e projektdeklaratave mjedisore për programe, plane, strategji, projekte; hartimin e databazës së lejeve mjedisore ku të reflektohen të gjitha aplikimet për leje të bëra nga subjekte të ndryshme; përgatitjen e formatit standard të kërkesës për leje mjedisi; pranimin e aplikimeve për leje mjedisore dhe realizimin e procedurës së vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik për pajisjen me leje (A, B).

- Inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore: përgatitjen dhe ndjekjen e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit; sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin në fuqi; kryerjen e inspektimeve dhe kontroleve përmes një programi tematik mbi bazë rrisht, të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore, siç parashikohet në ligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi; sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit dhe ujërave; shqyrtimin e ankesave për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve në kuadër të aplikimit të përgjegjësive mjedisore, detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura etj.; bashkëpunimin me inspektoratet e tjera kompetente, në rast se kërkohet prej tyre.

## **6. Përgjegjësitë e audituesve**

-Të vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4100), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese;

-Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300);

-Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të objektivit.

Ne jemi të pavarur e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i përmbushim përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo aneMe që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.



## 7. Standardet e auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, e ndryshuar me nr. 63, datë 22.06.2020 dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

## 8. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues, Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ndryshuar; Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit Administrativ të KLSH-së, miratuar me Vendimin të Kryetarit të KLSH nr. 58, datë 08.04.2022; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), “Udhëzuesit e INTOSAI-t”; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik;

Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji nr. 10488 datë 14.07.2011 “Për lejet e Mjedisit ” i ndryshuar me ligji 52/2020; Ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar; Ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar; Ligji nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; Ligji, nr. 10433, date 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet administrative”; VKM nr. 419, datë 25.6.2014, “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”; VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”; VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme; VKM nr. 247, datë 30.04.2014 ”Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”; VKM nr. 47, datë 29.1.2014, “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit”; Urdhri nr. 23 03.02.2020 “Miratimi i strukturës dhe organikës në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”.

## 9. Metodat e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

**a. Metoda "Testim hap pas hapi":** Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.

**b. Metoda e ekzaminimit:** Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve.

**c. Metoda e ekzaminimit kryq:** Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për



të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve.

**d. Metoda e inspektimit fizik:** Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.

**e. Metoda e intervistimit:** Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

**f. Metoda e testimit të detajuar:** Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

## **10. Dokumentimi i auditimit**

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë.

Dokumentimi i Auditimit është bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 107 datë 08.09.2017 e ndryshuar me nr. 63, datë 22.06.2020 si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI).

Auditimi është në fazën ku nga subjekti audituar (*Agjencia Kombëtare e Mjedisit*), ka paraqitur kundërshtitë në lidhje me akt-konstatimin nr. 1-9, datë 13.10.2023, si dhe akt verifikimit nr. 1 – 3, datë 13.10.2023 për të cilën grupi i KLSH pasi analizojë me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizëm, mori në konsiderate rastet të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion. Ndërsa rastet e tjera të cilat nuk kishin argumentin e mjaftueshëm ligjorë gjejnë pasqyrim në këtë Projekt Raport Auditimi i cili i përcillet subjektit për njohje dhe veprim.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) u krijua në mbështetje, të ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 568 datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizmin dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si dhe “Urdhrit të Kryeministrit Nr. 23, datë 03.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është një institucion qendror publik në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore të AKM-së dhe 4 Agjencive Rajonale të Mjedisit.



Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta si dhe ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara me legjislacionin në fuqi.

Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit janë: Sigurimi i performancës mjedisore; Kërkimi dhe dija mjedisore; Vlerësimi i impaktit mjedisor dhe licencimi; si dhe Inspektimi dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

## **2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit**

### **2.1. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit:**

*Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe shpenzimit.*

**Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Financave për hartimin e buxhetit të shtetit.**

#### **VITI 2020**

AKM Tiranë, me shkresë nr.4299, datë 30.08.2019, i ka paraqitur MTM Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2020-2022, sipas relacionit pasqyrave përkatëse bashkëlidhur, si dhe Projekt-Buxhetin e AKM për vitin 2020.

Për vitin 2020 në relacion janë paraqitur objektivat, produktet dhe treguesit ekonomiko-financiarë. Në objektivat janë paraqitur ato referuar monitorimit të mjedisit, informimit të publikut, realizimit të funksionit rregullator për lejet e mjedisit dhe VNM, për informacionin dhe statistikën mjedisore. Në produktet hyjnë raportet monitorimit, inventarit për IKPK dhe regjistri i shkarkimit të ndotësve 14 copë; dosjet e përfitimit të VNM dhe Lejeve të mjedisit A dhe B: 1700 dosje.

Në treguesit ekonomiko-financiarë, trajtohet:

1. Numri i punonjësve gjithsej: 62 punonjës.
2. Fondi financiar I nevojshëm për pagat e punonjësve të AKM (600): 51.0 milion lekë.
3. Fondi financiar I nevojshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve të AKM(601): 8.7 milion lekë.
4. Fondi financiar I nevojshëm për shpenzime operative (602) është 46,57 milion lekë.
5. Fondi financiar I nevojshëm për transferata të brendshme për monitorimin e treguesve të mjedisit më bashkëpunëtorë (604) është 10 milion lekë.
6. Fondi I veçantë llogaritur në masën 5% mbi fondin e pagave është 2,595 milion lekë.
7. Mbi kostimin e shpenzimeve sipas produkteve që do realizojë AKM.
8. Të ardhurat për buxhetin e shtetit që janë planifikuar 28 milion lekë.
9. Nevojat për investime gjithsej (231) janë planifikuar 87.5 milionë lekë..

Gjithsej buxheti për vitin 2020 është planifikuar: **206,4 milionë lekë** prej të cilave: 118.9 milionë lekë shpenzime korrente; 87.5 milionë lekë investime; dhe Të ardhura **28 milionë lekë**.

**Argumentimi i kërkesave Megji thatë, kërkesat e bëra ishin të fryra, gjë që le shteg për keqpërdorim të, gjë që ndikon në aktivitetin dhe performancën, si dhe në rezultatet e arritura të AKM, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore.**

#### **VITI 2021**

Për vitin 2021, AKM Tiranë, nuk i ka paraqitur MTM Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2021-2023, dhe as Projekt-Buxhetin e AKM për vitin 2022, ku nga dokumentacioni i paraqitur nuk u gjet asnjë dokument për këtë qëllim.

#### **VITI 2022**

AKM Tiranë, me shkresë nr.6573, datë 24.08.2022, i ka paraqitur MTM Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2023-2025, sipas pasqyrave përkatëse bashkëlidhur, si dhe Projekt-Buxhetin e AKM për vitin 2023.

*Për vitin 2023 mungonte relacioni me objektivat, produktet dhe treguesit ekonomiko-financiarë.*  
Gjithsej buxheti për vitin 2023 është planifikuar: **333,5 milionë lekë** prej të cilave,



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

- 229,5 milionë lekë shpenzime korrente
- 104 milionë lekë investime
- Të ardhura **49,5 milionë lekë.**

Numri i punonjësve gjithsej 116

**Argumentimi i kërkesave:** Megjithatë, kërkesat e bëra ishin të fryra, gjë që le shteg për keqpërdorim të, gjë që ndikon në aktivitetin dhe performancën, si dhe në rezultatet e arritura të AKM, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore.

**Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, transferimi i fondeve buxhetore si dhe plani përfundimtar.**

**VITI 2020**

Referuar Ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, në zbatim të VKM nr. 568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.23, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, nga ana e AKM Tiranë, me shkresë nr. 3684 prot., datë 10.07.2020, i është kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), kalimi I buxhetit të ish-ISHMPUT-ve dhe ARM-ve sipas ndarjes, strukturës aktuale dhe fushës së përgjegjësisë, për pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet operative dhe investimeve për ushtrimin e aktivitetit dhe përmbushjes së detyrave funksionale për 6-mujorin e dytë të Vitit 2020.

-MTM, me shkresë nr. 5604, datë 06.08.2020, në përgjigje të shkresës së AKM Tiranë nr. 3684 prot., datë 10.07.2020, ka përcjellë bashkëlidhur shtesën e fondit të shpenzimeve korrente për vitin 2020.

Sipas tabelës, i janë alokuar AKM dhe njësisive ARM vendore, një vlerë e përgjithshme prej 79,063,818 lekë

-AKM Tiranë, me shkresë nr. 5177 prot., datë 07.10.2020, i është drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me kërkesën për fonde financiare shtesë, për vijimin e aktivitetit të AKM-së dhe ekzekutimin e vendimeve përmbarimore dhe konkretisht:

Gjithsej: 8,700,000 lekë,

Prej këtyre:

-Udhëtime dieta 6,000,000 lekë

-Të tjera material e shërbime special (për laboratorin) 200,000 lekë.

-Shpenzime gjyqësore: 2,500,000 lekë.

- MTM me shkresë nr. 6678/1, datë 15.10.2020, në përgjigje të shkresës së AKM Tiranë nr. 5177 prot., datë 07.10.2020, konfirmon përdorimin e vlerës së mbetur prej 6,168,923 lekë nga fondi I alokuar “Shërbimi I mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluar në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban”, për mbulimin e shpenzimeve operative.

**Plani Fillestar**

**Tabela e Buxhetit - Fondet e Miratuara për Vitin 2020**

Kodi	Grupi	Kapitulli	Art.	Projekti	Shuma (lekë)
1026060	26	01	600	92604AC	48,740,400
		01	600	92604AD	21,463,600
		01	601	92604AC	8,430,000
		01	601	92604AD	3,580,000
		01	602	92604AC	19,900,000
		01	602	92604AD	4,500,000
		01	604	92604AC	7,000,000
		01	606	92604AC	2,108,000
		01	231		8,960,000
		06	231		56,027



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

		06	602		4,732,945
		<b>GJITHSEJ</b>			<b>129,470,972</b>

Transferimi i Fondeve Buxhetore

Nga tabela a paraqitur prej Sektorit të Financës dhe Buxhetit: “Evidenca e Shpenzimeve për muajin Dhjetor 2020” e rakorduar me Degën e Thesarit, si dhe nga tabela bashkëlidhur “Evidenca e realizimit Dhjetor 2020”, rezulton se nuk ka patur transferime fondesh gjatë vitit 2020.

Në dokumentacionin e paraqitur nga Sektori i Financës dhe Buxhetit, nuk u gjetën shkresa dhe urdhra për transferimin e fondeve buxhetore gjatë vitit 2020.

**VITI 2021**

Referuar Ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, si dhe në mbështetje të shkresës së MTM për këtë qëllim, janë akorduar fondet për vitin 2021, sipas tabelës së mëposhtme:

Plani Fillestar

Tabela e Buxhetit - Fondet e Miratuara për Vitin 2021

Kodi	Grupi	Kapitulli	Art.	Projekti	Shuma (lekë)
1026060	26	01	600	92604AB	39,000,000
		01	600	92604AC	37,000,000
		01	600	92604AD	17,000,000
		01	601	92604AB	7,000,000
		01	601	92604AC	7,000,000
		01	601	92604AD	3,500,000
		01	602	92604AB	4,000,000
		01	602	92604AC	40,710,284
		01	602	92604AD	3,000,000
		01	604	92604AC	2,889,716
		01	606	92604AC	499,000
		06	231	92604AC	56,027
		06	602	92604AC	4,765,170.9
		<b>GJITHSEJ</b>			<b>166,420,198</b>

Transferimi i Fondeve Buxhetore

Nga tabela a paraqitur prej Sektorit të Financës dhe Buxhetit: “Evidenca e Shpenzimeve për muajin Dhjetor 2021” e rakorduar me Degën e Thesarit, si dhe nga tabela bashkëlidhur “Evidenca e realizimit Dhjetor 2021”, rezultojnë pakësime të buxhetit fillestar, rezulton një buxhet i rishikuar për vitin 2021 prej 161,599,000 lekë, më një ulje nga plani fillestar prej 4,821,198 lekë (166,420,198-161599,000).

***Në dokumentacionin e paraqitur nga Sektori i Financës dhe Buxhetit, nuk u gjetën shkresa dhe urdhra për transferimin e fondeve buxhetore gjatë vitit 2021.***

Plani përfundimtar.

Pas ndryshimeve të kryera gjatë vitit 2021, plani përfundimtar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela e Buxhetit - Fondet e Rishikuara për Vitin 2021

Kodi	Grupi	Kapitulli	Art.	Projekti	Shuma (lekë)
1026060	26	01	600	92604AB	39,000,000
		01	600	92604AC	37,000,000
		01	600	92604AD	17,000,000
		01	601	92604AB	7,000,000
		01	601	92604AC	7,000,000
		01	601	92604AD	3,500,000
		01	602	92604AB	4,000,000





**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

		01	602	92604AC	40,710,284
		01	602	92604AD	3,000,000
		01	604	92604AC	2,889,716
		01	606	92604AC	499,000
		06	231	92604AC	-
		06	602	92604AC	1,290,819
		<b>GJITHSEJ</b>			<b>161,599,000</b>

**VITI 2022**

Referuar Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22922, datë 07.01.2022 “Dërgohet miratimi I detajimit të buxhetit për vitet 2022-2024 për shpenzimet korrente”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresë nr. 547, datë 21.01.2022, ka dërguar detajimin e buxhetit të shpenzimeve korrente për vitet 2022-2024, ku Agjencisë Kombëtare të Mjedisit i është akorduar një buxhet në total prej 179,199,269 lekë.

Me shkresë të MTM, datë 08.02.2022, protokolluar në AKM me nr..946 prot, datë 10.02.2022, është dërguar detajimi I fondit të veçantë për vitin 2022.

Plani Fillestar

Tabela e Buxhetit - Fondet e Miratuara Për Vitin 2022

Kodi	Grupi	Kapitulli	Art.	Projekti	Shuma (lekë)
1026060	26	01	600	92604AB	42,000,000
		01	600	92604AC	38,543,778
		01	600	92604AD	13,771,187
		01	601	92604AB	6,603,027
		01	601	92604AC	6,508,033
		01	601	92604AD	2,645,312
		01	602	92604AB	4,000,000
		01	602	92604AC	35,936,367
		01	602	92604AD	3,000,000
		01	604	92604AC	7,039,633
		01	606	92604AC	1,574,000
		01	230		2,160,000
		01	231		1,140,000
		06	231		164,027
		06	602		12,665,242
		<b>GJITHSEJ</b>			<b>179,199,269</b>

Transferimi i Fondeve Buxhetore

Mbi bazën e shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 2927/4, datë 01.04.2022, “Miratimi i detajimit të ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022”, dërguar me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr..4934/57, datë 29.03.2022 “Dërgohet miratimi i detajimit të ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar”; të Udhëzimit nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, të ndryshuar, gjatë vitit 2022 janë bërë detajimet e ndryshimeve në planin fillestar.

-Me shkresë të MTM nr. 1706/3, datë 03.03.2022 është dërguar në AKM: “Transferim fondi për



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

vitin 2022”, sipas shkresës së MFE nr. 3085/1 prot., datë 28.02.2022, në zbatim të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018.

Me shkresë të MTM nr. 2927/6, datë 08.04.2022 është dërguar në AKM: “Detajimi i limitit mujor të shpenzimeve korrente për vitin 2022 në kuadër të AN nr..3, datë 12.03.2022.

-Me shkresë të MTM nr..4088/3, datë 27.05.2022: “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, sipas shkresës së MFE nr..8657/1, datë 19.05.2022, shtesë fondi 1,140,000 lekë Blerje pajisje (matje e trashësisë së qeseve plastike).

-Me shkresë të MTM nr..4339/2, datë 13.06.2022: “Transferim fondi për shpenzime korrente në buxhetin e vitit 2022”, shtesë fondi 2,960,367 lekë, sipas shkresës së MFE nr..9008/1, datë 06.06.2022, transferim fondi për vitin 2022, me qëllim kryerjen e pagesës për 2 programet: Vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve, bazuar në përcaktimin e TOC për vitin 2022” dhe “Monitorimi I cilësisë së ajrit urban në Berat, Kukës, Vlorë dhe Gjirokastrë për vitin 2022”.

Me shkresë të MTM nr. 6601/1, datë 13.09.2022 është dërguar në AKM: “Miratimi i detajimit të ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr..12, datë 29.07.2022, sipas shkresës së MFE nr. 14405/129, datë 06.09.2022.

Me shkresë të MTM nr. 6658/1, datë 14.09.2022, është dërguar në AKM “Miratimi i limiteve sipas Aktit Normativ nr..12, datë 29.07.2022”.

Me shkresë të MFE nr..14405/129, datë 06.09.2022 është dërguar në MTM: “Miratimi i detajimit të ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr..12, datë 29.07.2022.

Me shkresë të MTM nr. 720/4, datë 16.02.2022, është dërguar në AKM “Miratimi i limitit të fondit të veçantë për vitin 2022”.

Plani përfundimtar.

Shpenzimet korrente dhe kapitale të vitit 2022 nga 179,199,269 lekë të miratuara, pas ndryshimeve të kryera gjatë vitit rezulton në pakësim të buxhetit fillestar, konkretisht në 175,881,420 lekë

*Realizimi i planit të buxhetit*

**VITI 2020**

Plani i buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për vitin 2020, rezulton në vlerën total **129,470,972 lekë**. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të detajuar programet dhe realizimet sipas zërave, për vitin 2020, të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë, deri më datë 31.12.2020, si më poshtë:

Realizimi i Shpenzimeve Janar - Dhjetor 2020

Grupi	Kapit	Artikulli	Emërtimi	Plani Vjetor	Fakti Progres.	%
26	01	Artikulli 600	Paga, shpërblime e te tjera shpenzime personeli	70,204,000	63,348,183	90%
26	01	Artikulli 601	Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndet. shëndetësore	12,010,000	10,576,618	88%
26	01	Artikulli 602	Mallra dhe Shërbime te tjera	24,400,000	16,583,146	68%
26	01	Artikulli 604	Transferime	7,000,000	4,349,706	62%
26	01	Artikulli 606	Shpenzime nga fondi i veçantë	2,108,000	2,095,030	99%
26	01	Artikulli 231	Pasaporta	8,960,000	(gjendje thesar)	0
26	06	Artikujt (602+231)	Shpenzime nga sponsorizimet e donatorëve	1,255,320	1,255,320	100%
			Gjithsej Kap 01 dhe 06	125,937,320	98,208,003	78%

Nga sa duket sipas tabelës së mësipërme, rezulton se buxheti i vitit 2020 është realizuar në masën



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

78 %, pra me mosrealizim, dhe në vlerë absolute me një vlerë prej 27,729,317 lekë diferencë e përcaktuar, nga të cilat:

- shpenzimet e personelit (600) rezultojnë me një mosrealizim prej 90 % dhe në vlerë absolute - 6,855,817 lekë

- shpenzimet kontribute sigurime shoqërore e shëndetësore (601) rezultojnë me një mosrealizim prej 88% dhe në vlerë absolute -1,433,382 lekë

*Këto mosrealizime kanë si shkak faktin e mosplotësimit të strukturës organike me numrin e planifikuarve me një numër prej 21 punonjësish.*

- shpenzimet mallra dhe shërbime të tjera (602) rezultojnë me një realizim prej 68 % dhe në vlerë absolute 7,816,854 lekë.

*Shkak i këtyre mosrealizimeve është planifikimi dhe kërkesa e fryrë dhe i paargumentuar i shpenzimeve.*

*Zërat e mësipërm, në mosrealizimin e tyre, tregojnë në mënyrë konkrete faktin se sa i shkëputur ka qenë procesi i hartimit të planit nga situata dhe nevojat faktike, sidomos për pagat, mirëmbajtjen e automjeteve, të pajisjeve të zyrave, etj.*

*Ndikim të konsiderueshëm ka patur mos realizimi i investimeve prej 8,960,000 lekë, të cilat janë gjendje në thesar, referuar shkresës së MTM nr. 6783 prot., datë 12.11.2020 lidhur me transferimin e fondeve për “Pasaporta Digjitale Mjedisore”, si dhe shkresës së AKSH-it nr. 5036/1 prot., datë 27.10.2020 drejtuar AKM dhe MTM, AKM me shkresë nr. 5270/1, datë 04.12.2020 i ka kërkuar MTM kthim (pakësim) fondi, për shkak se kalimi kapital i Pasaportës Digjitale duhet të bëhet nga MTM pranë AKSH-it dhe jo pranë AKM. Në këtë rast nuk është bërë transferim fondi dhe nuk është realizuar investimi sepse nuk i përkiste AKM-së.*

**VITI 2021**

Plani përfundimtar i buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për vitin 2021, rezulton në vlerën total **162,889,819 lekë**.

Për vitin 2021, nga ana e AKM ishin hartuar evidencat sintetike dhe analitike të shpenzimeve të kryera, lidhur me nivelin e realizimit të tyre referuar planit të rishikuar të këtij viti, diferencat e rezultuara në mosrealizimin e tyre në vlerë absolute dhe në %je për vitin 2021, sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i Shpenzimeve Janar - Dhjetor 2021

<i>Grupi</i>	<i>Kapit.</i>	<i>Artikulli</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Plani</i>	<i>Fakti Progres.</i>	<i>Diferenca</i>	<i>%</i>
26	01	600+601	Shpenzime Personeli		105,451.9	5,048,065	95%
26	01	602+604	Shpenzime te Tjera			19,229,033	62%
26	06					357	100%
			<i>Totali</i>		138,612,3	24,277,455	85%

<i>Grupi</i>	<i>Kapit.</i>	<i>Artikulli</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Plani Vjetor</i>	<i>Fakti Progres.</i>	<i>Diferenca</i>	<i>%</i>
26	01	Artikulli 600	Paga, shperblime e te tjera shpenzime personeli	93,000,000	90,354,284	2,645,716	97%
26	01	Artikulli 601	Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndet.	17,500,000	15,097,651	2,402,349	86%
26	01	Artikulli 602	Mallra dhe Shërbime te tjera	47,710,284	28,680,403	19,029,88	60%



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

26	01	Artikulli 604	Transferime	2,889,716	2,701,564	188,152	93%
26	01	Artikulli 606	Shpërblime për fatkeqësi	499,000	488,000	11,000	98%

<b>Të Ardhurat</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Buxheti</b>
Totali	30,000	-	30,000
Të ardhura nga Tarifa e lejeve			30,000

<b>Kapitull</b>	<b>Artikull</b>	<b>Të Ardhurat nga sponsorizimet</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Buxheti</b>
6	721	Totali	1,287,545	1,287,545	
	602	Të ardhura nga Tarifa e lejeve	1,287,545	1,287,545	

<b>Kapitull</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	<b>Diferenca</b>	<b>%</b>
6	Shpenzime nga sponsorizimet	1,287,545	<b>1,290,819</b>	<b>(357)</b>	<b>100%</b>

Nga sa duket sipas tabelës së mësipërme, rezulton se buxheti i vitit 2021 është realizuar në masën 85 %, pra me mosrealizim, dhe në vlerë absolute me një vlerë prej 24,277,455 lekë diferencë e parealizuar, nga të cilat ndikim të madh kanë:

- shpenzimet mallra dhe shërbime të tjera (602) rezultojnë me një mosrealizim prej 60% dhe në vlerë absolute 19,029,881 lekë.

Zërat e mësipërm, në mosrealizimin e tyre, tregojnë në mënyrë konkrete faktin se si ka ndikuar mungesa e procesit të hartimit të planit të buxhetit në situatën dhe nevojat faktike dhe në fryrjen e buxhetit, sidomos për shpenzimet mallra dhe shërbime të tjera.

#### **VITI 2022**

**Plani** i përfundimtar i buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për vitin 2022, rezulton në vlerën total **175,881,420 lekë**, si dhe realizimin e të ardhurave. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të detajuar programet dhe realizimet sipas zërave:

#### **Realizimi i Shpenzimeve Viti 2022**

Grup	Kapitull	Artikulli	Emërtimi	Plani Vjetor	Limiti Progres.	Fakti Progres.	Diferenca	%
		600+601	Shpenzime Personeli	111,520,000	105,893,334	110,004,80	1,515,194	99%
							-	
		602+604+605+606	Shpenzime Tjera	51,550,000	39,078,882	45,473,618	6,076,382	88%
		230		2,160,000	2,160,000	2,160,000		
		231		1,140,000	1,140,000	1,106,568	33,432	
	6		Shpenz. nga sponsorizime	9,511,420	9,511,420	1,256,035	8,255,385	13%
			Totali	175,881,420	157,783,636	160,001,027	15,880,393	91%

Nga sa duket sipas tabelës së mësipërme, rezulton se buxheti i vitit 2022 është realizuar në masën 91 %, pra me mosrealizim, dhe në vlerë absolute prej 15,880,393 lekë diferencë e parealizuar, nga të cilat realizime ndikim më të lartë kanë pasur:

- shpenzimet mallra dhe shërbime të tjera (602+604+605+606) rezultojnë me një realizim prej 88% dhe një diferencë(-) në vlerë absolute 6,076,382 lekë.

-Shpenzimet e kap.6, Shpenzime nga sponsorizimet (602,231), me një realizim prej 13% dhe një diferencë(-) në vlerë absolute 8,255,385 lekë.

Shkak i këtyre mosrealizimeve është planifikimi dhe kërkesa e fryrë dhe e paargumentuar e shpenzimeve.



## 2.2. Prokurimet e fondeve publike:

Agjencia kombëtare e Mjedisit për periudhën objekt auditimit ka programuar sipas nevojave të njësisë, duke hartuar Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit, dhe gjatë periudhës ka realizuar prokurime gjithsej 44 procedura gjithsej. Nga prokurimet e realizuara ka kryer procedura prokurimi në 1 rast “Kërkesë për propozim”; në 2 raste “Procedure të hapur”; në 1 rast “Shërbim Konsulencë”, si dhe 40 raste “Blerje në vlera të Vogla”.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për auditim procedurat e prokurimit: “Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban” viti 2020; “Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluar në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni lëvizës” viti 2021; “Blerje reagentësh dhe materiale laborator” viti 2022; si dhe “Shërbim projektimi për rikonstruksionin e godinës së AKM”.

Nga auditimi u konstatua se: -në 4 raste, Njësia e Prokurimit, në hartimin e DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, “Kapaciteti teknik”, ka kërkuar: “Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, duke vepruar në kundërshtim me (VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 3 ç’fuqizuar) VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 4. -në 1 rast Kontrata nr. 2456, datë 01.06.2021 lidhur midis subjektit “E.C.C.A.T” dhe AKM në vlerën e kontratës (me TVSH) 8,616,000 lekë është realizuar për 605,714 lekë me një diferencë të pa realizuar prej 8,010,286 lekë. Veprime në kundërshtim me nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrit Financave nr.30, datë 27.12.2011, ” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.

*Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.*

*- Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.*

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (AK), janë respektuar afatet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e app.gov.al. AK ka përgatitur regjistrin e veprimtarive të prokurimit të kryera, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja.

AKM Tiranë kishte programuar sipas nevojave të njësisë, duke hartuar Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit, për vitet 2020, 2021, 2022. Kështu:

-Për vitin 2020 sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve, rezulton se janë programuar nevojat e AKM, ku janë parashikuar për t’u kryer prokurime për 14 objekte prokurimi.

-Për vitin 2021 sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve, rezulton se janë programuar nevojat e AKM Tiranë, ku janë parashikuar për t’u kryer prokurime për 13 objekte prokurimi.

-Për vitin 2022 sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve, rezulton se janë programuar nevojat e AKM Tiranë, ku janë parashikuar për t’u kryer prokurime për 17 objekte prokurimi.

### Realizimi i Prokurimeve Publike Viti 2020

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës	Lloji i procedurës së prokurimit	Fondi i përlogaritur	Realizimi
1	Shpenzime mirëmbajtje aparateve dhe	Shërbime	Kërkesë për propozim	7,833,333	4,418,800
2	Sigurimi i automjeteve tpl	Shërbime	Vlerë e Vogël	800,000	191,744
3	Shërbim me roje	Shërbime	Vlerë e Vogël	800,000	619,402



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

4	Materiale pastrimi	Mallra	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	100,000	-
5	Materiale kancelarie	Mallra	Vlerë e Vogël	250,000	78,033
6	Furnizime materiale zyre te përgjithshme	Mallra	Blerje nën vlerën 100,000	100,000	-
7	Shpenzime mirëmbajtje elektrike	Shërbime	Blerje nën vlerën 100,000	100,000	-
8	Shërbime mirëmbajtje ndërtimore	Shërbime	Vlerë e Vogël	416,666	84,165
9	Materiale për funksionimin e pajisjeve te	Mallra	Vlerë e Vogël	333,333	274,667
10	Shërbime mirëmbajtje mjete transporti	Shërbime	Blerje nën vlerën 100,000	50,000	-
11	Uniforma dhe veshje speciale	Mallra	Blerje nën vlerën 100,000	33,333	-
12	Materiale dhe pajisje laborator	Mallra	Vlerë e Vogël	800,000	710,000
13	Pjese këmbimi, goma, bateri	Shërbime	Vlerë e Vogël	800,000	568,850
14	Materiale kancelarie	Mallra	Vlerë e Vogël	458,333	129,000

**Realizimi i Prokurimeve Publike Viti 2021**

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës	Lloji i procedurës së prokurimit	Fondi i përlloritur	Realizimi
1.	Materiale pastrimi	Mallra	Blerje e Vogël	250000	154,900
2	Shërbime mirëmbajtje ndërtimore	Shërbime	Blerje nen vlerën 100 000 Leke	100000	-
3	Materiale për funksionimin e pajisjeve te zyrës	Mallra	Blerje e Vogël	400000	188,000
4	Furnizime materiale zyre te përgjithshme	Mallra	Blerje nen vlerën 100 000 Leke	100000	-
5	Siguracion i automjeteve TPL	Shërbime	Blerje e Vogël	800000	211,480
6	Uniforma dhe veshje speciale	Mallra	Blerje nen vlerën 100 000 Leke	100000	-
7	Shërbim mirëmbajtje aparate dhe pajisje teknike	Shërbime	Procedure e Hapur	13500000	7,180,000
8	Udhëtime me jashtë (bileta)	Shërbime	Blerje nen vlerën 100 000 Leke	100000	-
9	Materiale Kancelarie	Mallra	Blerje e Vogël	400000	399,000
10	Pjese këmbimi. Goma, bateri	Mallra	Blerje e Vogël	800000	622,300
11	Materiale dhe pajisje laborator	Mallra	Blerje e Vogël	800000	560,000
12	Shërbime mirëmbajtje mjete transporti	Shërbime	Blerje nen vlerën 100 000 Leke	100000	-
13	Shpenzime mirëmbajtje elektrike kondicionimi.	Shërbime	Blerje nen vlerën 100 000 Leke	100,000	-

**Realizimi i Prokurimeve Publike Viti 2022**

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës	Lloji i procedurës së prokurimit	Fondi i përlloritur	Realizimi
1.	Shërbim eksperti për inspektim dhe vlerësim te gjendjes	Shërbime	Blerje e Vogël	240,000	193,200
2	Materiale për funksionimin e pajisjeve te zyrës	Mallra	Blerje e Vogël	500,000	250,000
3	Materiale kancelarie	Mallra	Blerje e Vogël	250000	103,042
4	Siguracion i automjeteve TPL	Shërbime	Blerje e Vogël	416,667	210,597
5	Pjese këmbimi goma bateri	Mallra	Blerje e Vogël	1,000,000	708,800
6	Shërbim Projektimi i godinës se Agjencisë Kombëtare te	Shërbime	Shërbim Konsulence	1,833,334	1,800,000
7	Blerje bileta avioni	Shërbime	Blerje e Vogël	500,000	366,350
8	Materiale Kancelarie	Mallra	Blerje e Vogël	500,000	477,777
9	Ri konceptim i faqes Web	Shërbime	Blerje e Vogël	500,000	389,999
10	Blerje pajisje për matjen e trashësisë se qeseve plastike	Mallra	Blerje e Vogël	950,000	922,140
11	Materiale dhe pajisje laboratorike	Mallra	Procedurë e Hapur	3,466,973	3,034,045
12	Shërbim për hartimin e dokumenteve tekniko ligjor	Shërbime	Blerje e Vogël	1,000,000	965,500
13	Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim		Blerje e Vogël	400,000	279,800
14	Mirëmbajtje elektrike hidraulike		Blerje e Vogël	200,000	-
15	Uniforma dhe veshje speciale		Blerje e Vogël	200,000	89,800
16	Shërbim për mirëmbajtjen e pajisjeve TIK (Printer,		Blerje e Vogël	500,000	-
17	Shërbime mirëmbajtje ndërtimore (lyerje)		Blerje e Vogël	100,000	-

**-Regjistri i Realizimit të Prokurimeve.**

Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit. Nga ana e grupit të auditimit u për periudhën objekt auditimi u audituan 4 dosjeve të prokurimit, vetëm për ato me procedurën e hapur dhe kërkesë për propozim dhe shërbim konsulence sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit (lekë)	Lloji i Procedurës	Oferta Fituese	Dif. me f. Limit	Operatori Ekon
1.	Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban	4,444,000	Kërkesë për propozim	4,418,800	25,200	K



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

2.	Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluar në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni lëvizës	9,117,496	Procedure e hapur	7,180,000	1,937,496	E.C.C.A.T
3.	Blerje reagentësh dhe materiale laborator	3,466,973	Procedure e hapur	3.034.045	432,928	K
4.	Shërbim projektimi për rikonstruksionin e godinës së AKM	1,833,334	Shërbim Konsulence	1,800,000	33,334	Instituti Dekliada-ALB

Nga auditimi rezultoi sa më poshtë vijon:

**1- Procedura e prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban”**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 10, Datë 17.07.2020</b>		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Kërkesë për propozim"	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 10, dt. 17.07.2020. E.H, Jurist Kryetar A.K, Përgjegjës I.K, Specialist Laboratori	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 3822, datë 17.07.20 J.M S.P K.C
5. Fondi Limit (pa TVSH) 4,444,000 lekë	6. Oferta fituese “K” (pa TVSH) 4,418,800 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 25,200 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 19.09.2020	9. Burimi Financimit Buxheti I shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 (një) OE b) Shkualifikuar 0 (zero) OE
11. Ankimime AK s'ka/ka; APP s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. datë _____	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4701, Datë 14.09.2020	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 3,231,077 lekë	16. Likuiduar deri dt. 31.12.2020 3,197,477 Lekë Pa likuiduar deri dt. 31.12.2020 Lekë 33,600.
17- Situacioni Përfundimtar...	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 108 ditë, Zbatuar 108 ditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë Shkresa (Amendamenti) nr..... dt.....
-Faturë Shërbimi nr. 20-13650, dt. 31.12.2020 Vlera me TVSH 910,363 lekë, Vlera pa TVSH 758,636 lekë -Faturë Shërbimi nr. 20-B293, dt. 31.10.2020 Vlera me TVSH 927,439 lekë, Vlera pa TVSH 772,866 lekë -Faturë Shërbimi nr. 20-B462, dt. 31.11.2020 Vlera me TVSH 880,997 lekë, Vlera pa TVSH 734,164 lekë -Faturë Shërbimi nr. 20-B101, dt. 30.09.2020, Vlera me TVSH 478,678 lekë, Vlera pa TVSH 398,898 lekë		
20. Mbikëqyrësi i punimeve	Licen. Nr.....	Kontrata Nr.....Prot.....datë .....lekë
21. Kolaudatori i punimeve	Licen. Nr.....	Nr.....Prot.....datë .....
22. Akt Kolaudimi datë .....	23. Akt i marrjes në dorëzim datë 30.10.2020, 30.11.2020, 31.12.2020.	24. Fletë Hyrja Nr.-, datë ...lekë..... (për mallrat)

**Në hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit**

Nga Njësia e Prokurimit në DST në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, rubrika 2.3 “Kapaciteti teknik”, kërkohen: **“Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”.**

Kërkesë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 3, ku përcaktohet se:

**“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.**

*Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”*



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

*Sa më sipër vlerësojmë, se si rezultat i kërkesave për punë të ngjashme mbi limitin e 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, është kufizuar mundësia potenciale e pjesëmarrjes në prokurimet e kryera, të operatorëve ekonomikë me kapacitete të ulëta dhe të mesme prodhimi dhe tregtie, duke kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve, si dhe duke shkaktuar një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues për operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.*

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 19.09.2020 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 19.09.2020 më poshtë vijon:

OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“K”	4,418,800 lekë	<i>Kualifikuar dhe shpallur fituese</i>

Nga verifikimi në faqen e APP, konstatohet e OE e shpallur fituese “K” shpk, ka paraqitur dokumentacionin lidhur me punët e ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit, ndaj U.K në një vlerë prej 9,347,920 lekë, në një kohë që vlera për punët e ngjashme nuk duhej të kalonte 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës prej 1,386,789 lekë (40 % X 3,466,973).

Përveç sa më sipër, konstatohet se në një kohë që oferta fituese është 4,418,800 lekë pa TVSH dhe 5,302,560 lekë me TVSH, kontrata me OE “K” është 3,231,077 lekë, ose me një diferencë prej 2,071,483 lekë dhe nuk ka sqarime për këtë ulje të vlerës së kontratës. Përgjegjësia znj. J.M dhe Ish-Drejtori z. E.K

**Zbatimi i Kontratës:** Kontrata nr. 4701, Datë 14.09.2020 lidhur për 3,231,077 lekë (me TVSH) është likuiduar sipas: -Faturë Shërbimi nr. 20-13650, dt. 31.12.2020 Vlera me TVSH 910,363 lekë; Faturë Shërbimi nr. 20-B293, dt. 31.10.2020 Vlera me TVSH 927,439 lekë; Faturë Shërbimi nr. 20-B462, dt. 31.11.2020 Vlera me TVSH 880,997 lekë; Faturë Shërbimi nr. 20-B101, dt. 30.09.2020, Vlera me TVSH 478,678 lekë.

2- Procedura e prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluar në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni lëvizës”

<b>b. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluar në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni lëvizës”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 5, Datë 25.03.2021</b>		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 43, dt. 01.02.2021 (për specifikimet teknike) GJ.F E.C B.P	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 45, datë 01.03.2021 S.P A.B K.C
5. Fondi Limit (pa TVSH) 9,117,496 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) “E.C.C.A.T” 7,180,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 1,937,496 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 30.04.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 (dy) OE “E.C.C.A.T” dhe “K” b) S’kualifikuar 0 (zero) OE
11. Ankimime AK s’ka; APP- s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr..... datë .....	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë .....
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 2456, Datë 01.06.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 8,616,000 lekë	16. Likuiduar deri dt. 16.11.2021 605,714 lekë Pa likuiduar deri dt. 31.12.,2022 Lekë 8,010,286
17. Situacion përfundimtar	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar ditë Zbatuar __ditë	19. Zgjatja e kontratës me..... ditë Shkresa _____
Faturë Elektronike Shërbimi nr. 27/2021 dt. 26.08.2021. Vlera me TVSH 500,887.8 lekë Vlera pa TVSH 417,406.5 lekë Faturë Tatimore Shitje nr. 104/2021, datë 25.10.2021 Vlera me TVSH 177,764.61 lekë Vlera pa TVSH 148,137.18 lekë		
20. Mbikëq. i punimeve	Licen. Nr.....	Kontrata Nr.....Prot.....datë ... lekë
21. Kolaudatori i punimeve	Licen. Nr.....	Nr.....Prot.....datë .....
22. Akt Kolaudimi datë .....	23. Akt i marrjes në dorëzim Proces-Verbal Korrik 2021 Proces-Verbal datë 26.08.2021	24. Fletë Hyrja Nr..... datë ....lekë..... (për mallrat)





### **Në hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit**

Sipas Proces-Verbalit nr. 1385 prot., datë 29.03.2021, e mbajtur nga Njësia e Prokurimit dhe nga DST, konstatohet se në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, rubrika 2.3 “Kapaciteti teknik”, kërkohen: “Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 3, ku përcaktohet se:

*“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”*

***Sa më sipër vlerësojmë, se si rezultat i kërkesave për punë të ngjashme mbi limitin e 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, është kufizuar mundësia potenciale e pjesëmarrjes në prokurimet e kryera, të operatorëve ekonomikë me kapacitete të ulëta dhe të mesme prodhimi dhe tregtie, duke kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve, si dhe duke shkaktuar një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues për operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2.***

Përgjegjësia: Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: B.P, Specialist Jurist, GJ.F, E.C,

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 30.04.2021 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 06.05.2021 më poshtë vijon:

OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“E.C.C.A.T”	7,180,000 lekë	<i>Kualifikuar dhe shpallur fituese</i>
“K”	8,700,000 lekë	<i>kualifikuar</i>

Nga verifikimi në faqen e APP, konstatohet se OE i shpallur fituese “E.C.C.A.T” shpk, ka paraqitur dokumentacionin lidhur me punët e ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit, e cila tejkalon 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

### **Zbatimi i Kontratës:**

Nga auditimi i realizimit të kontratës u konstatua se: Për realizimin e kontratës është ngritur komisioni me urdhër nr. 46/1, datë 29.06.2021, si dhe me Urdhër nr.46/1 “Ndryshim i Komisionit të Marrjes në Dorëzim” me nr.939/1 Prot. Datë 29.06.2021. Drejtorja e financës dhe shërbimeve mbështetëse deri në fund të vitit 2022 ka kryer pagesat sipas urdhër-shpenzimeve me objekt shpenzimi: “Shërbim i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit” nga kompania “E.C.C.A.T” vetëm 7 % e vlerës së lidhur ose 605,714 lekë. Për moszbatimin e këtij detyrimi dhe diferencën e pa realizuar prej 8,010,286 lekë pjesë e mbetur e vlerës të përcaktuara në kontratën e lidhur në mes palëve nga subjekti i audituar AKM arsyetohet se subjekti nuk ka sjell faturat tatimore pranë AKM-së.

Për ndjekjen e realizimit të kontratës me urdhër nr. 46/1, datë 29.06.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm është ngritur Grupi i Punë i përbërë prej E.C, B.P dhe I.H.Sipas Memo nr. 1250, datë 21.02.2022 informojnë Drejtori Përgjithshëm të AKM se subjekti “E.C.C.A.T” ka dorëzuar faturat e shërbimit me nr. 740, datë 03.02.2022. Me proces verbal nr. 469/1, datë 01.03.2022 “ Për realizimin e kontratës me nr. 2456, datë 01.06.2021” mbajtur midis Drejtorit të Përgjithshëm të AKM dhe subjektit “E.C.C.A.T” janë dakortësuar se që nuk ka pagesa të tjera për të likuiduara.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Nuk janë zbatuar sanksionet ligjore për mos plotësimin e kontratës, nuk ka ndjekje të zbatimit të kontratës nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit. Veprime në kundërshtim me nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011, ” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, mban përgjegjësi. Komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit E.C, B.P dhe I.H dhe Drejtori E.K.

**3- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje reagentësh dhe materiale laborator”**

<b>c. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje reagentësh dhe materiale laborator”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 134, datë 16.06.2022</b>		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur"	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 13, dt. 16.06.2022 A. Q, Kryetar A.A, Anëtar K.T, Anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 134, datë 16.06.2022 I.H, Kryetar I.Z, Anëtar X.G, Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 3,466,973 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 3.034.045 lekë	7. Diferenca me fondin limit(pa TVSH) 432,928.....lekë
8. Data e hapjes së tenderit 15.07.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 (Katër) OE b) S'kualifikuar 3 (tre) OE
11. Ankimime AK E.C.C.A.T nr. 1631/2, datë 28.07.2022; APP nr. 5931, datë 01.08.2022; KPP-s'ka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 6599, datë 24.08.2022	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr. 6527/1, datë 23.08.2022. Përgjigje AK nr..6599, dt. 24.08.2022 (jashtë afateve procedurale)
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 7144, Datë 12.09.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 3,640,854 lekë	16. Likuiduar deri dt. 27.10.2022, 3,640,854 Lekë Palikuiduar deri dt..... Lekë -
17- Situacion Përfundimtar	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë. Zbatuar 28 ditë	19. Zgjatja e kontratës me-ditë Shkresa (Amendamenti) nr..... dt.....
Faturat e Malli: datë .23.09.2022 dhe datë 10.10.2022 është Vlera pa TVSH 3.034.045 lekë dhe Vlera me TVSH 3,640,854 lekë;		
20. Mbikëq. i punimeve	Licen. Nr.....	Kontrata Nr.....Prot.....datë ... lekë
21. Kolaudatori i punimeve	Licen. Nr.....	Nr.....Prot.....datë .....
22. Akt Kolaudimi datë .....	23. Akt i marrjes në dorëzim -Proces-Verbali nr. 7144/3, datë 23.09.2022 Proces-Verbali nr. 7144/4, dtatë 10.10.2022.	24. Fletë Hyrja Nr. 8, datë 23.09.2022, 3,262,710 lekë Nr. 9, datë 10.10.2022, 378,144 lekë

**Në hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit**

Njësia e Prokurimit, ka hartuar DST, ku në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, rubrika 2.3 “Kapaciteti teknik”, kërkohen: *“Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 4, ku citohet se:*

*“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Sa më sipër vlerësojmë, se si rezultat i kërkesave për punë të ngjashme mbi limitin e 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, është kufizuar mundësia potenciale e pjesëmarrjes në prokurimet e kryera, të operatorëve ekonomikë me kapacitete të ulëta dhe të mesme prodhimi dhe tregtie, duke kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve, si dhe duke shkaktuar një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues për operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2.*

Përgjegjësia: Hartuesit e dokumenteve të tenderit: A. Q., A.A, Specialist K.T.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 15.07.2022 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 15.07.2022 më poshtë vijon:

OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
“K”	3.034.045 lekë pa TVSH	<i>Kualifikuar dhe shpallur fituese</i>
“A”	3.114.370 lekë pa TVSH	<i>Është skualifikuar për mungesa në dokumentacionin, sipas kritereve të vendosura në DST</i>
“OE.E.C.C.A.T”	2.875.380 lekë pa TVSH	<i>Në formularin e ofertës nuk ka pasqyruar Njësinë për sasinë sipas specifikimeve të DST</i>
“I”	-----	<i>nuk ka paraqitur ofertë dhe dokumente të tjera</i>

Nga auditimi i ofertave të paraqitura në faqen e APP, konstatohet e OE e shpallur fituese K shpk, ka paraqitur dokumentacionin lidhur me punët e ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit, e cila tejkalon 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Në auditimin e vlerësimit të ofertave nga komisioni i vlerësimit të ofertave në procedurën e prokurimit “Blerje reagentësh dhe materiale laboratorit” u konstatua se: Në hapjen e ofertave janë paraqitur 4 Operatorë Ekonomikë konkretisht: “K”; A’ “E.C.C.A.T” dhe “I” nga të cilët janë shkualifikuar 3 oferta për mungesë dokumentacioni dhe ka mbetur vetem oferta e “K”, si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “A Shpk” ka paraqitur dokumentacionin lidhur me punët e ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit, ku vlera e punëve në total e kalon vlerën 1,386,789 lekë, por një pjesë e madhe e faturave janë për subjekte privatë dhe fatura jo tatimore, ku nuk përcaktohet TVSH dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen dhe te merren parasysh. Kjo ofertë është skualifikuar për mungesa në dokumentacionin, sipas kritereve të vendosura në DST.

- Mungon Materiali reference I certifikuar (CRM për TOC)

- Nuk ka autorizim për dy prodhues specifikisht I dhe E

- Në formularin e ofertës nuk ka pasqyruar Njësinë për sasinë sipas specifikimeve të DST

2. Operatori Ekonomik “OE.E.C.C.A.T” me vlerë oferte 2,875,380.3 lekë, është skualifikuar për:

- Në deklaratën e origjinës së mallit për artikujt 1,2 dhe 4 nuk është paraqitur autorizim prodhuesi nga kompania “M”

- Në deklaratën e origjinës së mallit për Artikullin 3 origjina e mallit është deklaruar M, ndërsa në catalog është kompania “L”

- Në deklaratën e origjinës së mallit për Artikullin 5, nuk plotësohet specifikimi teknik për diametrin e poreve.

- Në deklaratën e origjinës së mallit për Artikullin 48, 51, 52,53,54 dhe 55 nuk është paraqitur autorizim prodhuesi nga kompania “M”

- Në deklaratën e origjinës së mallit për Artikullin 51, 52,53,54 dhe 55 nuk është paraqitur autorizim prodhuesi nga kompania “S.P”

- Në formularin e ofertës nuk ka pasqyruar Njësinë për sasinë sipas specifikimeve të DST

Ankimi administrative i OE.E.C.C.A.T, sipas AKM është paraqitur në shërbimin postar në datë n 23.08.2022, jashtë afateve procedural për shqyrtim dhe si I tillë nuk është pranuar nga AKM.

3. Operatori Ekonomik “I” nuk ka paraqitur ofertë dhe dokumente të tjera sipas ligjit dhe nuk ka paraqitur dokument për punët e ngjashme.

### **Zbatimi i kontratës**

Në lidhje me procedurën e tenderit është lidhur kontrata midis Agjencinë Kombëtare e Mjedisit dhe subjektit “K” lidhur në datë 12.09.2022 “Blerje reagentësh dhe materiale laboratorit” me një afat realizimi prej 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Me Urdhër të brendshëm nr. 136, datë 16.06.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit është ngritur Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave objekt kontrate. Komisioni i marrjes në dorëzim sipas Proces verbalit nr. 1, datë 23.09.2022 dhe Proces verbalit nr. 2, datë 10.10.2022, ka dokumentuar verifikimin e mallit të dorëzuar Në Drejtorinë e financës janë paraqitur faturat e Malli datë.23.09.2022 dhe datë 10.10.2022 në vlerë totale prej 3,640,854 lekë me TVSH.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

**4- Procedura e prokurimit me objekt “Shërbim projektimi i godinës së Agjencisë”**

<b>d.”Shërbim projektimi për rikonstruksionin e godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi Nr. 09, Datë 05.05.2022</b>		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Shërbim Konsulence"	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 13, dt. 16.06.2022 I.M, Kryetar A.K, Anëtar E.P, Anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 89., datë 05.05.2022 K.T, Kryetar P. M, Anëtar X.G, Anëtar E.S
5. Fondi Limit (pa TVSH) 1,833,334 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSH) 1,800,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit(pa TVSH) 33,334.....lekë
8. Data e hapjes së tenderit 12.07.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 5 (Pesë) OE b)S’kualifikuar 1 (një) OE
11. Ankimim -s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -	13. Përgjigje Ankesës nga APP -
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 6615, Datë 25.08.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 2,160,000 lekë	16 .Likuiduar deri dt. 26.10.2022, 2,160,000 Lekë Palikuiduar deri dt..... Lekë -
17- Faturë Tatimore 62/22, dt. 25.10.2022. Vlera me TVSH 2,160,000 lekë Vlera pa TVSH 1,180,000 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 2 muaj. Zbatuar 2 muaj	19. Zgjatja e kontratës me-ditë Shkresa (Amendamenti) nr..... dt.....
Faturë Tatimore 62/22, dt. 25.10.2022. Vlera me TVSH 2,160,000 lekë Vlera pa TVSH 1,180,000 lekë		
20. Mbikëq. i punimeve	Licen. Nr.....	Kontrata Nr.....Prot....datë ... lekë
21. Kolaudatori i punimeve	Licen. Nr.....	Nr.....Prot.....datë .....
22. Akt Kolaudimi datë .....	23. Akt i marrjes në dorëzim - Proces-Verbali nr. 6615/8, dt. 25.10.2022.	24. Fletë Hyrja Nr. 11, datë 25.10.2022, 2,160,000 lekë

**Në hartimin e Dokumenteve Standarte të Tenderit**

- DST në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, rubrika 2.3 “Kapaciteti teknik”, kërkohen: ”Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 2, pika ç. dhe neni 40 pika 4. Përgjegjësia: Hartuesit e dokumenteve të tenderit: I.M, A.K, E.P.

**Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin datë 12.07.2022 dhe është vlerësuar me procesverbalin datë 12.07.2022 më poshtë vijon:  
Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 4877/3, datë 27.07.2022 ka dërguar ftesë për ofertë subjekteve I.D.A; S.R; S.S.K-A; N.S.

<b>Operator Ekonomik</b>	<b>Oferta ekonomike</b>	<b>Vlerësimi i KVO</b>
I.D.A	1,800,000 lekë	<i>Oferta kualifikuese e shpallur fitues</i>
S.R	1,760,000 lekë	<i>Nuk ka sjellë deklaratën e disponueshmerisë</i>
S.S.K-A	1,708,000 lekë	<i>S’ ka staf të nevojshëm për projektim</i>
“S&L Studio”	-----	<i>S’kualifikuar mungesë dokumentacioni të kërkuar</i>
N.S	-----	<i>Nuk është paraqitur në fazën e dytë</i>

**Auditimi i ofertave:**

-Në vlerësimin e ofertave është skualifikuar “S&L Studio”, pasi: mungon Vërtetimet, nga OSSHE, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Listë pagesat Janar-Maj 2022; nuk ka kryer sigurimin e ofertës.

-Në vlerësimin e ofertave është kualifikuar “S.R” dhe vlerësohet me 96 pikë pasi nuk ka sjellë deklaratën e disponueshmerisë, me të cilën do të angazhohet në zbatim të kontratës.

-Në vlerësimin e ofertave është kualifikuar “I.D.A” dhe vlerësohet me 98 pikë pasi nuk ka sjellë grafikun e punimeve.

-Në vlerësimin e ofertave është kualifikuar “S.S.K-A” dhe vlerësohet me 95 pikë pasi s’ka paraqitur staf të nevojshëm për projektim.

Me proces verbalin nr. 4877/6, datë 15.08.2022 “Shqyrtimi i propozimeve të kandidatëve për procedurën me objekt “Shërbim projektimi i godinës së Agjencisë”, Komisioni i Vlerësimit të



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Ofertave, vlerëson Operatorin ekonomik “I.D.A” m ofertë ekonomike 1,800,000 lekë me totalin e pikëve 292.2 si oferta me e suksesshme.

**Zbatimi i kontratës**

Në datë 25.08.2022 është lidhur kontrata midis Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Operatorit Ekonomik “ I.D.A për “Shërbim projektimi i godinës së Agjencisë”, me grafik lëvrimi brenda 2-muajve, në një vlerë totale 1,800,000 lekë pa TVSH.

Me nr. 6619/8, datë 25.10.2022 është mbajtur proces verbali i marrjes në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr. 198, datë 25.08.2022 me objekt “Shërbim projektimi për rikonstruksionin e godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

Urdhër Shpenzimi datë 25.10.2022 për likuidimin e shumës prej 2,160,000 lekë me TVSH është lëshuar sipas Fletë Hyrje n. 11, datë 25.10.2022.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kritereve të pjesëmarrjes kundrejt operatorëve ekonomikë.
<b>Situata:</b>	<p><b>Në 3 raste</b></p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Urdhër Prokurimi Nr. 10, Datë 17.07.2020. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban”,</li><li>2. Urdhër Prokurimi Nr. 5, Datë 25.03.2021. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluar në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni lëvizës”,</li><li>3. Urdhër Prokurimi Nr. 134, datë 16.06.2022. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje reagentësh dhe materiale laborator”, - Njësia e Prokurimit, në hartimin e DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, “Kapaciteti teknik”, ka kërkuar: <u>“Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”,</u> si dhe <u>“Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”,</u> <u>duke vepruar në kundërshtim me (VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 3 ç’fuqizuar) VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 4, ku është përcaktuar: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.</u></li></ol> <p><b>Në 1 rast</b></p> <p>-Urdhër Prokurimi Nr. 5, Datë 25.03.2021, zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluar në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni lëvizës” u konstatua se në fund të vitit 2021 Kontrata nr. 2456, datë 01.06.2021 lidhur midis subjektit “E.C.C.A.T” dhe AKM në vlerën e kontratës (me TVSH) 8,616,000 lekë është realizuar për 605,714 lekë me një diferencë të pa realizuar prej 8,010,286 lekë. Pjesa e parealizuar e vlerës të përcaktuara në kontratën e lidhur në mes palëve, nga subjekti i audituar AKM arsyetohet se subjekti nuk ka sjell faturat tatimore</p>



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	pranë AKM-së. Nuk janë zbatuar sanksionet ligjore për mos plotësimin e kontratës. Veprime në kundërshtim me nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrit Financave nr.30, datë 27.12.2011, ” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.
<b>Kriteri:</b>	ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 4, neni 124; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrit Financave nr.30, datë 27.12.2011, ” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Aplikimi i kriterëve jo në përputhje me dokumentet standarte, kufizon mundësinë potenciale për pjesëmarrjen në prokurimet e kryera, të operatorëve ekonomikë me kapacitete të ulëta dhe të mesme prodhimi dhe tregtie, duke kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve, si dhe duke shkaktuar një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues për operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës.
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm
<b>Rekomandime:</b>	Njësia e Prokurimit të Autoritetit Kontraktor për çdo procedurë prokurimi të marrë masa që në hartimin e kriterëve të veçanta të plotësojnë Dokumentet Standarde të Tenderit në përputhje me rregullat e prokurimit publik për të mundësuar trajtim të barabartë dhe konkurrues midis konkurrentëve pjesëmarrës.

**- Realizimit të Prokurimeve (Blerje të vogla).**

Agjencia kombëtare e Mjedisit për periudhën objekt auditimit ka programuar sipas nevojave të njësisë, duke hartuar Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit, dhe gjatë periudhës ka realizuar prokurime gjithsej 44 procedura gjithsej. Nga prokurimet e realizuara ka kryer në 40 raste “Blerje në vlera të Vogla”. Nga Autoriteti Kontraktor për kryerjen e procedurave të prokurimit me Vlera të Vogla për periudhën objekt auditimi në ç’do rast ka nxjerrë Urdhër Prokurimi.

Nga ana e grupit të auditimit, u kryen me zgjedhje për dosjet e prokurimit, procedurën e mëposhtme:

viti	Objekti Prokurimit	Tipi i kontratës	Fondi limit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues
2020	Shërbim roje	Shërbime	800,000	619,402	23/09/2020	SH.P.S.F "SNAJPER SECURITY"
2021	Reagentë për laborator	Mallra	800,000	560,000	30/09/2021	K
2022	Shërbim ekspert për inspektim dhe vlerësim të gjendjes fizike dhe teknike të Stacioneve të Monitorimit të Ajri	Shërbime	240,000	193,200	24/03/2022	EUROMED

*Nga auditimi u konstatua se:*



**Urdhër Prokurimi nr. 07, datë 16.03.2022 me objekt: “Shërbim eksperti për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit”.**

Dokumentacioni i administruar për prokurimin:

- 1- Memo nga Drejtoria e Kërkimit dhe e Dijes Shkencore, sektori i laboratorëve, Teknologjisë dhe Infrastrukturës Mjedisore. Drejtuar Znj. A.D, Nr. 1249, datë 01.02.2022, Lënda: Informacion mbi gjendjen e pajisjeve të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit Urban. (kontrata e mirëmbajtjes të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit Urban për vitin 2021 ka mbaruar në datë 31.12.2021 dhe procedura për mirëmbajtjen në vitin 2022 është në proces)
- 2- Memo nga Drejtori e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Drejtuar Znj. A.D, Nr. 1249/1, datë 02.03.2022, Lënda: Kërkesë për ekspertë për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit
- 3- Memo nga Sektori Juridik dhe i marrëdhënieve ligjore, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Drejtuar Znj. A.D, Nr. 1249/2, datë 10.03.2022, Lënda: Kërkesë për ekspertë për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit gjendja e fondeve është e mjaftueshme për realizimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël)
- 4- Proces verbal i datë s 11.03.2022 me nr. Prot. 1249/3, në zbatim të Urdhrit të Prokurimit nr. 3, datë 06.01.2022, për përcaktimin e fondit limit prej 213,266 lekë pa TVSH. Komisioni: S.H, O.T dhe M.P.

Emërtimi	Operatorët ekonomik				
	E.M Çmim pa TVSH	K Çmim pa TVSH	I Çmim pa TVSH	Çmim mesatar Pa TVSH	Vlera mestare Pa TVSH
Inspektimi dhe vlerësimi i gjendjes fizike dhe teknike i Stacioneve të Monitorimit të Ajrit	193,200	210,000	236,600	213,266	213,266
<b>Vlera pa TVSH</b>					<b>213,266</b>

- 5- Urdhër Prokurimi nr. 07, datë 16.03.2022 “Për ngritjen e komisionit për prokurimin me vlerë të vogël” të përbërë: J.M , Kryetar, K.T e A.K Anëtarë.
- 6- Ftesë për ofertë me nr. 2087/1, datë 16.03.2022 për zhvillimin e tenderit on-line në datë 23.03.2022, ora 10.30.
- 7- Me Proces verbal të datë 24.03.2022 me nr. Prot. 2087/2, i mbajtur nga Komisioni i blerjeve të Vogla ngritur me Urdhrin nr. 21, datë 01.02.2022, në zbatim të Urdhrit të Prokurimit nr. 7, datë 16.03.2022, pasi vlerësoi ofertat ekonomike të paraqitura konstatoi dhe përcaktoi ofertuesin me vlerë me të ulët “E.M” me ofertë 193,200 lekë pa TVSH.  
Sipas ofertuesve të paraqitur vlerat e ofruara janë:  
-Operatori Ekonomik “S.ADPK” u s’kualifikua pasi paraqiti oferte mbi fondin limit  
-Operatori Ekonomik “E.M” paraqiti oferte 193,200 lekë pa TVSH  
-Operatori Ekonomik “V.E” paraqiti oferte 203,389.83 lekë pa TVSH  
-Operatori Ekonomik “K” paraqiti oferte 210,000 lekë pa TVSH.
- 8- Deklaratë e subjektit “E.M” datë 23.03.2022 në lidhje me specifikimet teknike të shërbimit, së bashku me formularin e ofertës, dhe formularin e vetëdeklarimit.
- 9- Proces verbal për dorëzimin e dokumenteve të tenderit mbajtur datë 25.03.2022 përcakton: për procedurën e blerjeve me vlerë të vogël me objekt “Shërbim eksperti për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit” me nr. REF-22649-03-02-2022 operatori ekonomik “E.M”. Komisioni J.M, A.K dhe K.T.
- 10- Kontrata shërbimi datë 28.03.2022 e lidhur midis “E.M” dhe AKM.
- 11- Diplomati fotokopje noterizuar për Inxh. Telekomunikacioni dhe Inxh. Elektrike.
- 12- Proces verbal i marrjes në dorëzim, datë 26.04.2022 të shërbimit “Shërbim eksperti për inspektim dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të stacioneve të monitorimit të ajrit” .



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Në dosjen e paraqitur, dokumentacion për punësimin e 2 inxhinierëve me eksperiencë të diplomuar në fushat elektronike, elektrike nuk është në përputhje me kërkesat (pasi fotokopjet e paraqitura nuk vërtetojnë punësimin dhe marrëdhëniet e punës me këta inxhinierë).

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” ku përcaktohet:

*2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqëror*

Përgjegjësia: Komisioni i Vlerësimit të ofertave S.H, O.T, M.P,

*Për sa më lart më hollësisht është mbajtur Projekt Raport i Auditimit nisur me nr. 562/7, datë 22.11.2023 për të cilin në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të auditimit, janë paraqitur observacione, marrës KLSH, me nr. 562/8, datë 20.12.2023; nr. 562/9, datë 21.12.2023; nr. 562/10, datë 21.12.2023; nr. 9757/1, datë 22.12.2023 marrës KLSH me nr. 562/15, datë 22.12.2023 nga nëpunësit: E.K, E.H, A.K, , P.M, E.SH, E.P, E.C, B.P, I.H.*

**- Në lidhje me pretendimi se:** Në Seksionin Krieterëve të Veçanta të Kualifikimit, rubrika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, kërkohej: “Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ky përcaktim është kërkuar duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet e një konkurrencë të hapur dhe për shkak të rëndësisë dhe kompleksitetit objekt prokurimi.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë. Njësia e Prokurimit, ka hartuar DST, në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, rubrika 2.3 “Kapaciteti teknik”, miratuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 4.

**- Në lidhje me pretendimi se:** Referuar procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim Projektimi i godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, kjo procedurë është realizuar në bazë të procedurës së mëparshme të prokurimit “Blerje e vogël” në të cilën janë përcaktuar specifikimet teknike/termat e referencës si dhe përlllogaritja e fondit limit, të cilat cilësohen dhe në Memon nr.3492 prot., datë 05.05.2022 me lëndë “Kërkesë për fillim procedure për Shërbim Projektimi i godinës së AKM-së”.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** në lidhje me observacionin merret në konsideratë.

**- Në lidhje me pretendimi se:** Komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes së stacioneve të ajrit urban ka mbajtur proces verbal cdo muaj për konstatimet.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë pasi për shkeljen e konstatuar është përshkruar hollësisht në Raportin e Auditimit

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e krieterëve të pjesëmarrjes kundrejt operatorëve ekonomikë.
<b>Situata:</b>	<i>Në rast, prokurimi me vlerë të Vogël në vitin 2022 “Shërbim eksperti për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit”.</i> Në dosjen e paraqitur, dokumentacion për punësimin e 2 inxhinierëve me eksperiencë të diplomuar në fushat elektronike, elektrike (pasi fotokopjet e paraqitura nuk vërtetojnë punësimin dhe marrëdhëniet e punës me këta inxhinierë). Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021), Neni 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” pika 4.





**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, neni 76, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos plotësimi i dokumentacionit të kërkuar në një procedurë prokurimi me vlera të vogla, nuk mund të sigurojë që të gjitha operacionet e njësive publike të dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandime:</b>	Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël në ç’do procedurë prokurimi të marrë masa që të plotësojnë Dokumentet Standarde të Tenderit në përputhje me rregullat e prokurimit publik për të mundësuar pasqyrim të saktë të procedurës.

**2.3. Mbi auditimin e procedurave të miratimit të Lejeve Mjedisore të Tipit A, B, Licencat III.2.B dhe pranimit të Raporteve të vetmonitorimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.**

**Mbi auditimin e procedurave të miratimit të Lejeve Mjedisore të Tipit A, B, Licencat III.2.B**

Për periudhën objekt auditimi në gjendje 31.12.2022 në Drejtori të ndryshme në AKM disponojnë baza të dhënash mbi lejet mjedisore aktive që nuk përputhen me njëra tjetrën, e ardhur nga ndryshimi i legjislacionit, lëvizja dhe shtimi i instalimeve të subjekteve, mbarimi i afatit të përputshmërisë së lejeve të mjedisit me ligjin e ri etj.

Nisur nga mos pasja e një baze të dhënash unike për lejet mjedisore. Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 3885, datë 24.05.2023 ka kërkuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit informacion mbi lejet mjedisore aktive. Nga QKB në 31.05.2023 është përcjellë informacioni mbi lejet mjedisore aktive të lëshuara nga vitit 2009. Aktualisht në formatin elektronik janë të regjistruara 5329 në formatin PN (Informacion nga QKB).

Nga analizimi i të dhënave të disponuara ë Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe krahasimi i të dhënave të disponuara në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në përgjigje të komunikimit shkresor konstatohet se:

Në regjistrin e lejeve ekzistojnë leje me format të vjetër, VNM/Deklarata Mjedisore si dhe subjekte të pajisur me leje mjedisore apo Vlerësim të Ndikimit në Mjedis (VNM) pa raportuar asnjëherë konkretisht:

**Subjekte me leje format i vjetër**

Subjekte/vitet	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Shuma
Leje format vjetër	9	193	336	335	284	117	-	1274
VNM/Deklarata Mjedisore					160	30	400	590

Nga shqyrtimi i të dhënave për subjektet e mësipërme konstatohet subjekte me leje mjedisore aktive por me aktivitet te pezulluar apo mbyllur, janë si me poshtë:

**Subjekte jo aktive me leje format i vjetër**

Subjekte/vitet	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Shuma
Leje format vjetër	4	67	146	30	7	17		271
VNM/Deklarata Mjedisore					16	5	50	71



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Mos azhurnimi dhe përditësimi i të dhënave të subjekteve pajisur me leje mjedisore është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 30 pika 1 dhe 2 ku përcaktohet:

1. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit A dhe të tipit B do të zbatojnë të gjitha dispozitat e këtij ligji jo më vonë se tetë vjet nga hyrja në fuqi e tij.
2. Operatori i një instalimi ekzistues të tipit A ose të tipit B, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përmes QKB-së, kërkesën për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit të tipit A ose të tipit B, sipas rastit, në përputhje me kërkesat e reja të këtij ligji dhe planin e përputhshmërisë, së bashku me afatet përkatëse.

Nga auditimi i praktikave të lejeve të mjedisit për disa subjekte u konstatua se për të njëjtin instalim nga i njëjti subjekt ka dy apo më shumë leje mjedisore (PN) të lëshuar në vite, megjithëse është aprovuar Leja Mjedisore e re, në asnjë rast nuk është revokuar Leja Mjedisore e vjetër si më poshtë:

Nr.	Emri Subjektit	NIPT	Vitet e Lejeve Mjedisore
1	P.G.T	K3.....5S	2014-2022
2	A.W	K8.....2B	2013-2022
3	A.B.H	K3.....1E	2013-2016
4	A.G2015	L5.....0F	2012-2016
5	D	L2.....1A	2012-2018
6	A.B	J6.....0D	2011-2018
7	P.M	K6.....2B	2011-2018
8	A	K1.....1T	2011-2015-2018
9	T	K2.....1I	2011-2012 s'ka te re
10	B.T	J6.....1F	2011-2021
11	P.X	K1.....2O	2011-2013
12	M.P	K6.....0H	2011-2019
13	A.G.T	L1.....1C	2011-2022

Për sa më lart kemi veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 8 “Kërkesat e përgjithshme për përdorimin e lejes së mjedisit të tipit A” pika 1 dhe 2 ku përcaktohet:

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, instalimet e kategorisë A pajisen me leje mjedisi të tipit A, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
2. E njëjta leje mjedisi e tipit A mund të lejojë funksionimin e më shumë se një instalimi të të njëjtit operator në të njëjtën vendndodhje. Instalimet e operatorëve të ndryshëm, që ndodhen në të njëjtën vendndodhje dhe instalimet e të njëjtit operator, që ndodhen në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipit A, B apo C, sipas rastit.

Në neni 20 “Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B” pika 1 dhe 2 ku përcaktohet:

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, instalimet e kategorisë B pajisen me leje mjedisi të tipit B, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
2. E njëjta leje mjedisi e tipit B mund të lejojë funksionimin e më shumë se një instalimi të të njëjtit operator, në të njëjtën vendndodhje. Instalimet e operatorëve të ndryshëm, që ndodhen në të njëjtën vendndodhje dhe instalimet e të njëjtit operator, që ndodhen në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipave A, B apo C, sipas rastit.

Si dhe neni 30 pika 1 dhe 2 ku përcaktohet:

1. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit A dhe të tipit B do të zbatojnë të gjitha dispozitat e këtij ligji jo më vonë se tetë vjet nga hyrja në fuqi e tij.
2. Operatori i një instalimi ekzistues të tipit A ose të tipit B, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përmes QKB-së, kërkesën për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit të tipit A ose të tipit B, sipas rastit, në përputhje me kërkesat



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

*e reja të këtij ligji dhe planin e përputhshmërisë, së bashku me afatet përkatëse.*

Për sa më lart mbajnë përgjegjësi E.K ish-Drejtor i Përgjithshëm, F.K ish-Drejtor Drejtoria e Vlerësimit të Impaktit dhe Licencimit, B.T ish-Përgjegjës Sektori i Lejeve Mjedisore, A.D Drejtor i Përgjithshëm.

Sipas të dhënave të marra nga sektori i lejeve mjedisore, nga viti 2020 deri në vitin 2022 janë miratuar leje mjedisore sipas tabelës mëposhtme:

Viti/Tipi Lejes	A	B	Totali A+B	III. 2. B
<b>2020</b>	10	149	159	65
<b>2021</b>	10	544	554	64
<b>2022</b>	15	636	651	68
<b>Shuma</b>	<b>35</b>	<b>1329</b>	<b>1364</b>	<b>197</b>

Për vitin 2020, 2021 dhe 2022 janë miratuar:

- gjithsej 1364 Leje Mjedisore të tipit “A” dhe “B” nga të cilat 25 leje mjedisore tipi A; 1339 leje mjedisore tipi B dhe 197 Leje Mjedisore të tipit III.2.B.

Nga vlerësimi i procedurës së ndjekur për pajisje me leje mjedisore për disa subjekte me zgjedhje: U shqyrtuan vendimmarrjet në komisioneve: nr. 8, datë 26.02.2020; nr. 48, datë 24.12.2020; nr. 14, datë 10.04.2020; nr. 6, datë 11.02.2020; nr. 2, datë 22.01.2020; nr. 16, datë 27.04.2020; nr. 3, datë 12.02.2021; nr. 36, datë 25.08.2021; nr. 48, datë 06.10.2021; nr. 8, datë 04.03.2021.2021; nr. 64, datë 24.05.2022; nr. 53, datë 06.05.2022.

Më poshtë dokumentet dhe arsyetimet ku janë mbështetur marrjet e vendimeve, plotësimet dhe refuzimet e disa aplikimeve, të konstatuar nga auditimi.

### **Vitit 2020**

Në mbledhjen e **Komisionit nr. 25 i zhvilluar në datë 25.06.2020** u shqyrtuan gjithsej 8 akte Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 5 Akte Miratimi konkretisht: “4-AM”; “A.K”; “DPR.NP”; “M.V”; “V.M”.
- 3 Akt Refuzimi konkretisht “A.A.PH”, “GJ”, “G77” .

Nga auditimi me zgjedhje:

#### **Subjekti “A.K”**

Kërkesa për pikat 7.3 a; ose 7.3 b, Veprimtaritë që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi, Pranë Nënstacionit Zëmlak Korçë.

Ka aplikuar për leje mjedisore datë 15.04.2020, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi B me nr. 4700 prot, datë 01.07.2020, Nr. I identifikimit të lejes 3162; K. Nr. 25.

- Nuk ka sqarime të dokumentuara për mos zbatimin e afatit të lëshimit dhe publikimit të Lejes mjedisore të përcaktuar në Kreu III “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisore të tipit B” në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014, “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisore të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” i ndryshuar.

Komisioni: E.K Drejtor, F.K Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit në Mjedis, B.T P/Sektorit të Lejeve të Mjedisit, E.M P/Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJ P/Sektorit të Përgjegjësisë Mjedisore.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Në mbledhjen e **Komisionit nr. 8 i zhvilluar në datë 26.02.2020** u shqyrtuan gjithsej 8 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 5 Akte Miratimi konkretisht: “E.R”; “ASAB”; “A.B”; “AZ.R”, “G.2002”.
- 3 Akt Refuzimi konkretisht “A.G”, “C.SH”, “C.C”.

Nga auditimi me zgjedhje:

**E.R LC 1275**

Kërkesa për pikën: Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1a), ose lëndfillimit (5.2a). Pastrim, larje, sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme.

Në adresën: Metalurgji, Bradashesh, Elbasan

Ka aplikuar për shtesë leje mjedisore, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi “B” me Vendim nr. 08 prot, datë 09.03.2020.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

- Konsultimi me publikun
- Pagesa e tarifës
- Dokumentacioni I pronës
- Karta teknologjike
- Raporti i Sigurisë
- Raporti i mbrojtjes nga zjarri

Dokumentacion për aprovimin e lejes tipit “B” të cituar më lart.

Aplikimi është bërë për shtimin e pajisjeve mjekësore (Autoklave).

Në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka VNM, për kapacitetet teknologjike të reja që do shtohen. Veprim në kundërshtim me nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, ku përcaktohet:

*Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:”*

*a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;*

*b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, F.K Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit në Mjedis, B.T P/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.M P/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, B.K(P) P/Spektorit të Përgjegjësive Mjedisore.

Në mbledhjen e **Komisionit nr. 48 i zhvilluar në datë 24.12.2020** u shqyrtuan gjithsej 28 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 15 Akte Miratimi, 2 Akte Korrigjim dhe 11 Akt Refuzimi.

Nga auditimi me zgjedhje:

**V.A.L.E. Recycling LC 3162**

Kërkesa për pikën: Ndryshim shtim kodesh Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Në adresën: Fshati Gurrëz, Fushë Krujë, Lezhe.

Ka aplikuar për ndryshim leje mjedisore, datë 10.12.2020 aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi “B” me Vendim nr. 48 prot, datë 28.12.2020.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

- Konsultimi me publikun
- Pagesa e tarifës
- Dokumentacioni I pronës
- Karta teknologjike



-Raporti i Sigurisë

-Raporti i mbrojtjes nga zjarri

Dokumentacion për aprovimin e lejes tipit “B” të cituar më lart.

Aplikimi është bërë për ndryshim fushe aktiviteti dhe shtim “Pastrim larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontejnerëve në mënyrë që të ripërdoren. Stacionim transferim të mbetjeve të rrezikshme. Stacionim transferim të mbetjeve jo të rrezikshme”.

Në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka VNM, për aktivitet dhe kapacitetet teknologjike të reja që do shtohen. Veprim në kundërshtim me nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, ku përcaktohet:

*Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:”*

*a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;*

*b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, B.TP/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.MP/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJP/Spektorit të Monitorimit, J.M P/Spektori Juridik dhe Marrëdhënieve Ligjore, O.DH Specialist Spektori i Lejeve Mjedisore.

Në mbledhjen e **Komisionit nr. 14 i zhvilluar në datë 10.04.2020** u shqyrtuan gjithsej 4 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 3 Akte Miratimi konkretisht: “Z.I”; “M”; “E.K”.

- 1 Akt Refuzimi konkretisht “FP.K”.

Nga auditimi me zgjedhje:

#### **Z.I LC 8285**

Kërkesa për pikën: Grumbullim depozitim dhe përpunim I mbetjeve jo te rrezikshme skorieve te kripës industriale. Në adresën: Elbasan.

Ka aplikuar për leje mjedisore, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi III.2.B me Vendim nr. 14 prot, datë 14.04.2020.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

-Formular Aplikimi LC-8285-03-2020

-Dokumentacioni i pronës/qirasë,

-Planimetria

-Kontratë Pune me Inxhinier Mjedisit për Trajtimin e Ujërave.

Në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka kontratë për depozitim të mbetjeve në kundërshtim me ligjin me nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” si dhe VKM nr. 575, datë 24.6.2015, “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, F.KDrejtor i Drejtorisë së Vlerësimit në Mjedis, B.TP/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.MP/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJP/Spektorit të Përgjegjësi Mjedisore.

Në mbledhjen e **Komisionit nr. 6 i zhvilluar në datë 11.02.2020** u shqyrtuan gjithsej 3 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 3 Akte Miratimi konkretisht: “A”; “B.A”; “R”.

Nga auditimi me zgjedhje:

#### **A**

Kërkesa për pikën: 3.1. Përzierja e çimentos ose përdorimi I çimentos ne mase te madhe por jo ne sheshin e ndërtimit , përfshire ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos.

Në adresën: Helmes, Kavajë,Tiranë.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Ka aplikuar për leje mjedisore, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi B me Vendim nr. 6 prot, datë 24.02.2020.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

-Konsultimi me publikun

-Pagesa e tarifës

-Dokumentacioni i pronës/proces legalizimi

-Raporti i Sigurisë

-Raporti i mbrojtjes nga zjarri

- Aplikimi është pranuar pa dokumentacionin për shkarkimin e ujërave teknologjike, Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisore të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” i ndryshuar, Kreu I, pika 1 ku përcaktohet:

*1. Miratimin e formularit informues për lejet e tipit A, B dhe C, si dhe të formatit standard të aktit të miratimit/refuzimit për këto leje, sipas shtojcave bashkëlidhur këtij vendimi.*

Në shtojcën nr. 2 përcaktohet:

*Pika. 6.3. “Shkarkimet në ujërat sipërfaqësore”*

*Për shkarkimet në ujërat sipërfaqësore duhet të plotësoni Tabelat: 6.3.1. dhe 6.3.2.*

*Rendisni të gjithë pikat e shkarkimit shoqëruar me planimetritë, skicat dhe dokumentet përkatëse bashkëngjitur këtij formulari si Aneksi 6.*

*Për secilën pikë shkarkimi, është e nevojshme të tregoni substancat që shkarkohen. Duhet të llogariten të gjithë llojet e shkarkimeve të lëngshme si dhe llumrat në ujërat sipërfaqësore si dhe reshjet atmosferike që për shkak të forcave të gravitetit shkojnë drejt ujërave sipërfaqësore. Pikat e shkarkimit duhet të tregohen në hartën e terrenit me koordinata të shënuara në sistemin GAUS KRUGE 1942\_GK\_ZONË\_4. Duhet të specifikohen gjithashtu dhe identiteti dhe tipi i mjedisit ujqor pritës.*

- Në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka VNM, pasi instalimi është i ri dhe shtojcë në aktivitet . Veprim në kundërshtim me nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, ku përcaktohet:

*Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:”*

*a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;*

*b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, F.KDrejtor i Drejtorisë së Vlerësimit në Mjedis, B.TP/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.MP/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJP/Spektorit të Përgjegjësi Mjedisore.

Në mbledhjen e Komisionit nr. 2 i zhvilluar në datë 22.01.2020 u shqyrtuan gjithsej 8 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 5 Akte Miratimi konkretisht: “R”; “G.W”; “R.O”; “Z”, “A.SH.G”.

- 3 Akt Refuzimi konkretisht “S”, “M”, “L.N” .

Nga auditimi me zgjedhje:

**R.O LC 6325**

Kërkesa për Prodhim alkoli dhe pije alkoolike duke përfshirë edhe fabrikat e berrës.

Në adresën: Maminas, Durrës.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Ka aplikuar për leje mjedisore dt 24.12.2019, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi B me Vendim nr. 2 prot, datë 27.01.2020.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

- Konsultimi me publikun
- Pagesa e tarifës
- Dokumentacioni I pronës
- Karta teknologjike
- Raporti i Sigurisë

Në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka VNM. Veprim në kundërshtim me nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, ku përcaktohet:

*Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:”*

- a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;*
- b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, F.K Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit në Mjedis, B.T(mungon)P/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.M P/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJP/Spektorit të Përgjegjësi Mjedisore, A.F Specialist Spektori i Lejeve Mjedisore.

Në mbledhjen e **Komisionit nr. 16 i zhvilluar në datë 27.04.2020** u shqyrtuan gjithsej 5 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 3 Akte Miratimi konkretisht: “GTS Gazra Teknike Shqiptare”; “E.A”; “Z.I”.
- 2 Akt Refuzimi konkretisht “S.I.S”, “C.SH”.

Nga auditimi me zgjedhje:

**E.A**

Kërkesa për Prodhim i pajisjeve elektrike.

Në adresën: Rruga: S. Z. Xhazotaj, Rruga Durrës-Shijak, Durrës.

Ka aplikuar për leje mjedisore dt 17.04.2020, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi B me Vendim nr. 16 prot., datë 30.04.2020.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

- Konsultimi me publikun
- Pagesa e tarifës
- Dokumentacioni I pronës
- Raporti i Sigurisë
- Raporti i mbrojtjes nga zjarri

Në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka VNM. Veprim në kundërshtim me nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, ku përcaktohet:

*Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:”*

- a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;*
- b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, F.K Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit në Mjedis, B.T P/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.M P/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJP/Spektorit të Përgjegjësi Mjedisore, E.H Jurist, A.F Specialist Spektori i Lejeve Mjedisore.



## 2021

Në mbledhjen e Komisionit nr. 3 i zhvilluar në datë 12.02.2021 u shqyrtuan gjithsej 30 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit: 12 Akte Miratimi dhe 18 Akt Refuzim.

Nga auditimi me zgjedhje:

### Subjekti: E

Kërkesa për pikën: 3.5.- a. Prodhim i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit. Në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 11, Laprakë Tirane.

Ka aplikuar për leje mjedisore datë 28.08.2020, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi “A” me Vendim nr. 3 prot, datë 12.02.2020.

Në dosjen e vënë në dispozicion për auditim në formatin PDF ka paraqitur:

- Aplikimin për Leje Mjedisore të tipit “A”, datë 28.08.2020
- VNM të Thelluar hartuar (Tiranë më 2012) nga “E.S.P”,
- Në formularin e kërkesës për leje mjedisi të Tipit “A” ka referuar pajisjen me Leje mjedisore të përfituara më parë e tipit “B” me Nr. 3709/5 Prot datë 24.04.2012.
- Shkresa me nr. 3724/5, datë 24.12.2018 “Kthim përgjigje”, nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM drejtuar subjektit “E.C” në shënim, përcakton se: *Në rast se keni ndryshim të koordinatave , shpërfaqjes dhe kapacitetit të miratuar në Lejen Mjedisore ekzistuese, operatori të ndjekë procedurën nga e para për tu pajisur me Vendim Paraparak apo/ose Deklaratë Mjedisore dhe më pas për Leje Mjedisore.*

- Formulari “Dëgjesa me publikun për tu pajisur me leje mjedisi të instalimit të tipit “A” ose “B” ndryshime në funksione instalimit të tipit “A” dhe “B”, realizuar datë 07.02.2019.

Në procesverbalin e komisionit nr. 03, datë 12.02.2021 citohet: *“ka bashkëngjitur Raportin e VNM”. Nga aksesi në sistemin “e-leje”, konstatoam se për periudhën e vitit 2018 deri në vitin 2020 e 2021 nuk ka të regjistruar Vendim Paraparak apo/ose Deklaratë Mjedisore, për subjektin “E.C”.*

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” i ndryshuar, në Kreun II “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit A” Pika 1.1 ku përcaktohet:

*1.1. Dokumentet “Kopje të vendimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraparak ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraparak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për VNM-në” do të kërkohen gjatë këtij procesi, por këto dokumente do të gjenerohen nga vetë ministria përgjegjëse për mjedisin dhe institucionet e saj të varësisë, të përfshira në këtë proces.*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, B.T P/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.M P/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJ P/Spektorit të Monitorimit, J.M P/Spektori i Marrëdhënieve Ligjore, O.DH Specialist i Sektorit të Lejeve të Mjedisit.

Në mbledhjen e Komisionit nr. 36 i zhvilluar në datë 25.08.2021 u shqyrtuan gjithsej 11 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 10 Akte Miratimi/Ndryshim konkretisht: “J11”; “G2”; “R.D”; “V.AL.S”; “M.A”; B.T”; “F”; “E.E”; “C.C”; “A.A”.
- 1 Akt Refuzim “B.P”.

Nga auditimi me zgjedhje:





### **A.A LC 9160**

Kërkesa për pikën: Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to.

Në adresën: Zona qendrore e vendburimit të kromit, Miniera Bulqize, Dibër.

Ka aplikuar për ndryshim leje mjedisore, për shtesë leje shfrytëzimi sipas Shkresës MIE nr. 3458/1, datë 15.07.2021 dhe aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi B me Vendim nr. 36 prot, datë 26.08.2021.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

-Konsultimi me publikun

-Pagesa e tarifës

-Raporti i Sigurisë

Në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka Raporti i mbrojtjes nga zjarri. Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjetikës me shkresë nr. 3458/1, datë 15.07.2021 ka miratuar procedurat për zgjerimin e lejes minerare ekzistuese. Subjekti nuk ka paraqitur VNM për zgjerimin e lejes minerare. Veprim në kundërshtim me nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, ku përcaktohet:

*Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë: ”*

*a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;*

*b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, P/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.MP/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJ P/Spektorit të Monitorimit, J.M P/Spektori i Marrëdhënieve Ligjore, O.DH Specialist i Sektorit të Lejeve të Mjedisit.

### **B.T**

Kërkesa për pikën: Prodhimi i Birrës. Në adresën: Rruga Konferenca e Pezës, Tiranë..

Ka aplikuar për leje mjedisore, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi “B” me Vendim nr. 36 prot, datë 26.08.2021.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

-Konsultimi me publikun

-Pagesa e tarifës

-Dokumentacioni I pronës

-Planimetria

-Raporti i Sigurisë

-Raporti i mbrojtjes nga zjarri

Në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka VNM. Veprim në kundërshtim me nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, ku përcaktohet:

*Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë: ”*

*a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;*

*b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, P/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.MP/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJP/Spektorit të Monitorimit, J.M P/Spektori i Marrëdhënieve Ligjore, O.DHSpecialist i Sektorit të Lejeve të Mjedisit.

### **E.E LC 7860**

Kërkesa për pikën: "Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme" dhe "stacion transferimi për mbetje të rrezikshme". Në adresën: Maminas, Lagjja “Krapen”, Rruga e vjetër, Durrës.

Ka aplikuar për leje mjedisore, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi “B”. me Vendim nr. 36 prot., datë 26.08.2021.



Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

- Konsultimi me publikun
- Pagesa e tarifës
- Dokumentacioni I pronës
- Raporti i Sigurisë
- Raporti i mbrojtjes nga zjarri

Në dokumentacionin e paraqitur kontratë për depozitim mbetjesh lidhur më 01.07.2021 me “Ndërkomunal Bushat” në adresën Bashkia Vau i Dejës Nj.A. Bushat, ndërkohe veprimtaria zhvillohet në Durrës. Për sa më Nuk është respektuar plani i menaxhimit të mbetjeve referuar rajoneve. Veprime në kundërshtim me: nenin 10 “Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”; nenin 12 “Planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve”; dhe nenin 14 “Programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve” të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar,

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, P/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.MP/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJ P/Spektorit të Monitorimit, J.M P/Spektori i Marrëdhënieve Ligjore, O.DH Specialist i Sektorit të Lejeve të Mjedisit.

Në mbledhjen e **Komisionit nr. 48, i zhvilluar në datë 06.10.2021** u shqyrtuan gjithsej 39 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 4737, datë 08.10.2021, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 2 Akte Miratimi konkretisht: “A.CO” LC 7088 dhe Transferim nga subjekti “V.M” tek subjekti CH.L” LC 8100.

- 37 Akt Refuzimi

#### **A,C LC 7088**

Kërkesa për pikën: ID.1.10. Furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane. ID.1.7 Gaz natyror aromatik ose GNL.

Në adresën: Rruga Nacionale Gjirokastër - Kakaviqe, pranë fshatit Dervican.

Ka aplikuar për leje mjedisore më 11.06.2021, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi B me Vendim nr. 48 prot, datë 06.10.2021.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

-Mendim për Leje Mjedisore (Tipi “B”) nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër me nr. 2821, datë 21.07.2021.

- Mendim sugjerues nga Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Turizëm e Mjedis, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me nr. 5659, datë 05.08.2021.

-Pagesa e tarifës

-Dokumentacioni I pronës

-Raporti i Sigurisë

-Raporti i mbrojtjes nga zjarri

Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr. 6521, datë 20.12.2021 Lënda: Kërkesë për ngarkim akti” për QKB ka përshkruar: *Në sistemin kombëtar të lejeve dhe licencave subjekti “A.CO” me LC -7088-06-2021, ka kaluar në statusin “miratim në heshtje”, kërkojmë nga na juaj të ngarkoni aktin e miratimit të çështjes me PN-0850-10-2021, pasi në nuk kemi akses. Miratim në heshtje pa akt-miratimi është veprim në kundërshtim ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 4 “Sistemi i lejeve të mjedisit” pika 1.b. ku përcaktohet:*

*b) Ministri është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;*

si dhe

- KREU III “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisore të tipit B” i VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisore të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri,



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” (Ndryshuar me VKM nr. 97, datë 14.2.2018).

- VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” Fusha III “Mjedisi dhe burimet mjedisore bazë”, Pika 4 e Kategoria III.1, “Për ndikimin në mjedis” ku përcaktohet:

*4. Leja e nënkategorive A dhe B, trajtohet sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese që dorëzohen nga kërkuesi, kuptimi i llojit të veprimtarive dhe i ndikimit të tyre në mjedis, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkesës prej tij dhe afatet për t’iu përgjigjur QKB-së për një kërkesë që ka kaluar fazën e parë nga QKB-ja, për nënkategoritë A dhe B, janë ato respektivet e përcaktuara nga ligji për lejet e mjedisit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, P/Spektori të Lejeve të Mjedisit, E.M P/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJ P/Spektorit të Monitorimit, J.M P/Spektori i Marrëdhënieve Ligjore, O.DH Specialist i Sektorit të Lejeve të Mjedisit.

Në mbledhjen e **Komisionit nr. 8 i zhvilluar në datë 04.03.2021.2021** u shqyrtuan gjithsej 6 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 5 Akte Miratimi konkretisht: “4-AM”; “T”; “N2010”; “Z”; “Q.S”.

- 1 Akt Refuzim “B.D.C”.

Nga auditimi me zgjedhje:

**N2010 LC 64161**

Kërkesa për pikën: Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guoret.

Në adresën: Midis fshatrave Goranxi dhe Dervician, Dropull i Poshtëm, Gjirokastrë.

Ka aplikuar për leje mjedisore, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi B me Vendim nr. 8 prot, datë 09.03.2021.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

-Konsultimi me publikun

-Pagesa e tarifës

-Dokumentacioni I pronës/Kontratë qiraje

-Plan veprimi të karrierës për shfrytëzim mineralit gur gëlqeror pllakos.

-Raporti i Sigurisë

Nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës me nr. 8963, datë 14.11.2012, ka Akt Miratimi 1591, për Zonën Minerale nr. 397. Në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka VNM. Veprim në kundërshtim me nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, ku përcaktohet:

*Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:”*

*a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;*

*b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor, B.T P/Spektori të Lejeve të Mjedisore, E.M P/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJ P/Spektorit të Monitorimit, J.M P/Spektori i Marrëdhënieve Ligjore, O.DH Specialist i Sektorit të Lejeve të Mjedisit.



### Viti 2022

Në mbledhjen e Komisionit nr. 64 i zhvilluar në datë 24.05.2022 u shqyrtuan gjithsej 5 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 3 Akte Miratimi konkretisht: “A.K”; “K.F”; “L.Z”.
- 2 Akt Refuzim “GJ”; “M”;

Nga auditimi me zgjedhje:

#### Subjekti: K.F

Kërkesa për pikën: 7.7 f. Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve. Në adresën: Rruga Elbasan-Metalurgji, km 5, Elbasan.

Ka aplikuar për leje mjedisore dt 10.05.2022, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi B me Vendim nr. 64 prot, datë 24.05.2022.

Në proces Verbalin nr. 64, datë 24.05.2022 gjatë shqyrtimit të dokumentacionit është shprehur – “Ka zhvilluar dëgjuesën e publikut datë 17.11.2021”. Në dosjen e vënë në dispozicion për auditim në formatin PDF nuk ka Formularin e dëgjimit në publik veprim në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” i ndryshuar, në Kreun III “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit B” Pika 1. dh. ku përcaktohet:

*1. Kërkuesi që aplikon pranë QKB -së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B duhet të dorëzojë këto dokumente:*

*dh)Relacionin rreth dëgjuesës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi.*

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: A.D Drejtor, N.P Drejtor i drejtorisë së Kërkimit dhe Dijes Mjedisore, A.T Drejtor i Drejtorisë së Përfomancës Mjedisore, B.T P/Spektori të Lejeve të Mjedisore, E.M P/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJ P/Spektorit të Monitorimit, E.H Specialisti i Sektorit Juridik dhe i Marrëdhënieve Ligjore.

Në mbledhjen e Komisionit nr. 53 i zhvilluar në datë 06.05.2022 u shqyrtuan gjithsej 5 akte për miratimin e Akte-Miratime/Akte Refuzimi nga të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit:

- 2 Akte Miratimi konkretisht: “A”; “P.X”.
- 3 Akt Refuzim “3A-160”; “P.L”; “P”.

Nga auditimi me zgjedhje:

#### P.X

Kërkesa për pikën: ID 3.7 Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga gurorët.

Në adresën:Thumanë Durrës.

Ka aplikuar për leje mjedisore, aprovuar me akt Miratimi i Leje Mjedisore Tipi B me Vendim nr. 53 prot, datë 09.05.2022.

Në dosjen e aplikimit paraqitur për auditim në formatin PDF janë paraqitur dokumentacioni:

- Konsultimi me publikun
- Pagesa e tarifës
- Dokumentacioni I pronës
- Karta teknologjike
- Raporti i Sigurisë
- Raporti i mbrojtjes nga zjarri

Në dokumentacionin e paraqitur në PDF si dhe ngarkuara në sistem pagesa e tarifës është bërë në datë 15.04.2022 mbas datë së aplikimit i cili mban datë n 17.03.2022. Veprim në kundërshtim me



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: A.D Drejtor, B.T P/Sektorit të Lejeve të Mjedisore, E.M P/Sektorit i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, E.KP/Sektorit të Monitorimit, J.M P/Sektorit i Marrëdhënieve Ligjore.

*Për sa më lart më hollësisht është mbajtur Projekt Raport i Auditimit nisur me nr. 562/7, datë 22.11.2023 për të cilin në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të auditimit, janë paraqitur observacione, marrës KLSH, nr. 562/10, datë 21.12.2023; nr. 562/11, datë 22.12.2023; nr. 562/13, datë 22.12.2023; nr. 9757/1, datë 22.12.2023 marrës KLSH me nr. 562/15, datë 22.12.2023 nga nëpunësit: A.D, E.K, F.K, M.P, E.M, B.T, L.GJ, J.M, A.K, O.DH, E.H, B.K, A.F, E.K,*

**- Në lidhje me pretendimi se:** *Për të përmirësuar këtë bazë të dhënash gjatë vitit 2022-2023, është bërë një këqyrje e regjistrit të lejeve dhe licencave për të bërë evidentimin e formatit të lejeve mjedisore aktive si dhe verifikimin e akteve të ngarkuara për lejet përkatëse.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** *Në lidhje me observacionin merret në konsideratë pasi procesi ka filluar në vitin 2023.*

**- Në lidhje me pretendimi se:** *Subjektet “A.K”, “ECO.R”, “V.A.L.E.R”, “Z.I”, “A”, “R.O”, “E.A”, “E”, “A.A”, “B.T”, “E.E”, “A.C”, “N2010”, “K.F”, “P.X”, janë pajisur me leje mjedisi apo VNM në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** *Në lidhje me observacionin merret në konsideratë pasi me lart rast pas rasti janë përshkruar shkeljet e konstatuara.*

**- Në lidhje me pretendimi se:** *Dokumentacioni i aplikimit rruhet në një dosje e cila është share me QKB e AKM edhe personat që kanë marrë akses nga drejtuesi, si dhe nga kryerja e punimeve nuk mund të gjendet dokumentacioni, pasi dosjet e dhëna ne file PDF kane mangësi.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** *Në lidhje me observacionin merret në konsideratë pasi me lart rast pas rasti janë përshkruar shkeljet e konstatuara.*

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Në gjendje 31.12.2022, Drejtori të ndryshme në AKM disponojnë baza të dhënash mbi lejet mjedisore aktive që nuk përputhen me njëra tjetrën.
<b>Situata:</b>	Nga rakordimi shkresor midis AKM dhe QKB u konstatua se në regjistrin e lejeve ekzistojnë leje me format të vjetër, VNM/Deklarata Mjedisore si dhe subjekte të pajisur me leje mjedisore apo VNM pa raportuar asnjëherë konkretisht, 1274 Leje Mjedisore format i vjetër si dhe 590 VNM/Deklarata Mjedisore. Nga të cilat rezultojnë se subjekte disponues të këtyre lejeve mjedisore aktualisht janë me status pezulluar dhe jo aktiv në 271 raste qe korrespondojnë me leje mjedisore format i vjetër si dhe 71 raste qe korrespondojnë VNM/Deklarata Mjedisore. Mos azhurnimi dhe përditësimi i të dhënave të subjekteve pajisur me leje mjedisore është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 30 pika 1 dhe 2.
<b>Kriteri:</b>	Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 30 pika 1 dhe 2.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nga mos pasja e një baze të dhënash unike dhe të përditësuar ulet mundësia e ndjekjes dhe kontrollit të zbatim të detyrimeve ligjore në mbrojtje të mjedisit
<b>Shkaku:</b>	Mos unifikimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave mbi lejet mjedisore nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

<b>Rëndësia:</b>	e Lartë
<b>Rekomandime:</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit të marrë masa që të unifikojë bazën e të dhënave mbi Lejet Mjedisore mbi të cilën operojnë Drejtori e Sektorë të AKM, duke mundësuar edhe përditësimin unik të saj.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Për të njëjtin instalim nga i njëjti subjekt ka dy apo më shumë leje mjedisore (PN) të lëshuar në vite.
--------------------------	---

<b>Situata:</b>	Megjithëse është aprovuar Leja Mjedisore e re, në asnjë rast nuk është revokuar Leja Mjedisore e vjetër, si në tabelë:
-----------------	--

Nr.	Emri Subjektit	NIPT	Vitet e Lejeve Mjedisore
1	P.G.T	K3.....5S	2014-2022
2	A.W	K8.....2B	2013-2022
3	A.B.H	K3.....1E	2013-2016
4	A.G2015	L5.....0F	2012-2016
5	D	L2.....1A	2012-2018
6	A.B	J6.....0D	2011-2018
7	P.M	K6.....2B	2011-2018
8	A	K1.....1T	2011-2015-2018
9	T	K2.....1I	2011-2012 s'ka te re
10	B.T	J6.....1F	2011-2021
11	P.X	K1.....2O	2011-2013
12	M.P	K6.....0H	2011-2019
13	A.G.T	L1.....1C	2011-2022

Për sa më lart kemi veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 8 “Kërkesat e përgjithshme për përdorimin e lejes së mjedisit të tipit A” pika 1 dhe 2 ; neni 20 “Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B” pika 1 dhe 2; si dhe neni 30 pika 1 dhe 2.

<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar nenin, 8, 20, dhe 30 pika 1 dhe 2.
-----------------	---

<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nga mos pasja e një baze të dhënash unike dhe të përditësuar ulet mundësia e ndjekjes dhe kontrollit të zbatim të detyrimeve ligjore në mbrojtje të mjedisit.
------------------------	---

<b>Shkaku:</b>	Mos unifikimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave mbi lejet mjedisore nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
----------------	--

<b>Rëndësia:</b>	E lartë
------------------	---------

<b>Rekomandime:</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të marrë masa që të kërkojë revokimin e lejeve model i vjetër nga subjektet “P.G.T” me NIPT, K 3.....5S; “A.W” me NIPT K8.....2B; “A.B.H” me NIPT K3.....1E; “A.G2015” me NIPT L5.....0F; “D” me NIPT L2.....1A; “A.B” me NIPT J6.....0D; “P.M” me NIPT K6.....2B; “A me NIPT K1.....1T; “T” me NIPT K2.....1I; “B.T” me NIPT J6.....1F; “P,X” me NIPT K1.....2O dhe “M.P” me NIPT K6.....0H.
---------------------	---

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Nga komisioni i verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimit të lejeve mjedisore në AKM janë miratuar kërkesa në mungesë dokumentacioni të kërkuar ligjor.
--------------------------	---

<b>Situata:</b>	- Në mbledhjen e Komisionit nr. 25 i zhvilluar në datë 25.06.2020 u shqyrtua kërkesa e subjekti “A.K” nga AKM nuk ka sqarime të dokumentuara për mos zbatimin e afatit të lëshimit dhe publikimit të Lejes mjedisore të përcaktuar
-----------------	--



në Kreu III “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit B” në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014,

- Në mbledhjen e Komisionit nr. 8 i zhvilluar në datë 04.03.2021.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “N2010” LC 64161. Në mbledhjen e Komisionit nr. 3 i zhvilluar në datë 12.02.2021 janë shqyrtuar kërkesat e subjekteve “E”; “A.A” LC 9160 dhe “B.T”. Në mbledhjen e Komisionit nr. 8 i zhvilluar në datë 26.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E.R” LC 1275. Në mbledhjen e Komisionit nr. 48 i zhvilluar në datë 24.12.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “V.A.L.E.R” LC 3162. Në mbledhjen e Komisionit nr. 6 i zhvilluar në datë 11.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A”. Në mbledhjen e Komisionit nr. 2 i zhvilluar në datë 22.01.2020 u shqyrtuan kërkesa e subjektit “R.O” LC 6325. Në mbledhjen e Komisionit nr. 16 i zhvilluar në datë 27.04.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E.A”. Në të 8 rastet e mësipërme nga komisionet janë miratuar Lejet Mjedisore për subjektet, por në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka të ngarkuar VNM. Veprime në kundërshtim me nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar.
- Në mbledhjen e Komisionit nr. 14 i zhvilluar në datë 10.04.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “Z.I” LC 8285 nga ku në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka kontratë për depozitimin e mbetjeve veprim në kundërshtim me ligjin me nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” si dhe VKM nr. 575, datë 24.6.2015.
- Në mbledhjen e Komisionit nr. 3 i zhvilluar në datë 12.02.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E.E” LC 7860 nga ku në dokumentacionin e paraqitur ka kontratë për depozitim mbetjesh lidhur më 01.07.2021 me “Ndërkomunal Bushat” në adresën Bashkia Vau i Dejës Nj.A. Bushat, ndërkohe veprimtaria zhvillohet në Durrës. Nuk është respektuar plani i menaxhimit të mbetjeve referuar rajoneve, veprime në kundërshtim me: nenin 10 “Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”; nenin 12 “Planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve”; si dhe nenin 14 “Programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve” të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar.
- Në mbledhjen e Komisionit nr. 6 i zhvilluar në datë 11.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A” nga ku aplikimi është pranuar pa dokumentacionin për shkarkimin e ujërave teknologjike, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014.
- Në mbledhjen e Komisionit nr. 64 i zhvilluar në datë 24.05.2022 u shqyrtuan kërkesa e Subjekti “K.F” nga ku në dosjen e vënë në dispozicion për auditim (formatin PDF) nuk ka Formularin e dëgjimit në publik veprim në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.6.2014 në Kreun III “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit B” Pika 1. Dh.
- Në mbledhjen e Komisionit nr. 53 i zhvilluar në datë 06.05.2022 u shqyrtuan kërkesa e subjektit “P,X” ku nga dokumentacionin e paraqitur në PDF si dhe ngarkuara në sistem pagesa e tarifës është bërë në datë 15.04.2022 mbas datë s së aplikimit i cili mban datë n 17.03.2022. Veprim në kundërshtim me VKM Nr. 419, datë 25.6.2014.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	- Në mbledhjen e Komisionit nr. 48, i zhvilluar në datë 06.10.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A,C” LC 7088 nga ku miratim në heshtje pa akt-miratimi është veprim në kundërshtim ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 4; VKM nr. 419, datë 25.6.2014 - KREU III “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit B” si dhe VKM nr. 538, datë 26.5.2009.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar; ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar; ligji me nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; VKM nr. 538, datë 26.5.2009; VKM nr. 419, datë 25.6.2014; VKM nr. 575, datë 24.6.2015.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Miratimi i lejeve mjedisore pa u paraqitur më parë dokumentacioni i kërkuar ka efekt negativ në mbrojtjen e mjedisit.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i kërkesave ligjore në plotësimi e dokumentacionit nga Komisionet e verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimit të lejeve mjedisore në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të marrë masa që të kërkojë revokimin e lejet mjedisore të miratuar pa dokumentacionin e kërkuar ligjor për subjektet: “N2010”; “E”; “A.A”; “B.T”; “E.R”; “V.A.L.E. R “A”; “R.O”; “E.A”; “Z.I”; “E.E”; “K.F”; “P,X”; “A,C”.

### ***Auditimi mbi tarifën vjetore të lejeve mjedisore***

Tarifave e lejeve të mjedisit si tarifa përkatëse e shërbimit për shqyrtimin e kërkesës, tarifa për ndryshim të kushteve të lejes së mjedisit dhe tarifa vjetore janë përcaktuar me VKM nr. 417, datë 25.6.2014, “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”, (ndryshuar me VKM-në nr. 462, datë 26.7.2023) ku është përcaktuar dhe mënyra e arkëtimit të tyre.

Të ardhurat nga tarifat vjetore të lejeve të mjedisit arkëtohen për llogari të Ministrisë së Turizmit dhe e Mjedisit (MTM), çdo fund muaji Dega e Thesarit Tiranë i dërgon MTM të gjitha të ardhurat mujore në total të pa specifikuar në mënyrë analitike (pavarësisht nqs janë për tarifat e lejeve apo për tarifa /shërbime të tjera që mund të ofrojë MTM).

Nga ana e sektorit të financës së MTM i janë dërguar rregullisht (me e-mail) financës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) të ardhurat mujore (formati Excel siç është dërguar nga dega e thesarit) kjo praktikë aplikohet që nga viti 2015 e në momentin e auditimit.

Referuar informacionit të dërguar nga sektori i financës së MTM-Dega e Thesarit, si dhe mandat pagesave të dorëzuara nga subjektet (në rastet kur i kanë dorëzuar në AKM), AKM i ka verifikuar pagesat që janë kryer nga subjektet, përllogaritur sa duhet të kishte paguar për të gjitha lejet (PN) që disponon dhe llogaritur nëse rezulton debitor apo jo.

Duke qënë se të ardhurat nga tarifat e lejeve mjedisore arkëtohen në llogarinë e MTM dhe jo në llogarinë e AKM-së, për periudhën objekt auditimi, Sektori i Financës dhe Buxhetit në AKM nuk ka mbajtur evidence për shlyerjen e detyrimeve financiare.

Deri në 31.12.2022 Sektori i Financës i evidentonte debitorët sipas kërkesave të Sektorit të Lejeve dhe/ ose Drejtorisë së Inspektim-Kontrollit, por nuk ishte ndërtuar ndonjë evidencë/database ku të evidentoheshin subjektet e verifikuara nqs janë debitor apo jo.

Sipas Programit të Auditimit nr. 8619/1, datë 1.12.2021 nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit (MTM), është ushtruar auditim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në lidhje me arkëtimin e tarifave vjetore të lejeve të mjedisit në zbatim të VKM nr. 417 datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”, detyrë kjo funksionale e AKM-së përcaktuar në rregulloren.





Nga auditi është konstatuar se:

-Nga mosrakordimi ndërmjet drejtorive dhe sektorëve të AKM-së për numrin e lejeve mjedisore, për vitet 2020 - 2021 konstatohet një diferencë tarifë vjetore prej 13 040 000 lekë. Gjithashtu nga evidentimi i bërë nga sektori i financës së AKM-së për periudhën 2015 deri më qershor 2020, janë evidentuar detyrime të tarifës vjetore për 840 subjekte në shumën 8 522 000 lekë. Në momentin e auditimit nga Sektorin e Financës në AKM nuk disponohet lista e 840 subjekteve debitoare.

-Sektori i Monitorimit nuk ka bërë evidentimin e subjekteve të pajisur me leje mjedisore A dhe B për likuidimin e tarifës vjetore të lejeve sipas VKM nr. 417 datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit”, detyrë kjo funksionale e përcaktuar në rregulloren e AKM-së. Ky sektor duhet të kishte bashkërenduar informacionet me sektorin e financës dhe buxhetit për të evidentuar subjektet që kanë bërë likuidimin e tarifës dhe më pas të hartonte listën e subjekteve që nuk kanë likuiduar këtë tarifë dhe t’ja paraqiste drejtorit të drejtorisë. Kjo listë do shërbente edhe si bazë për planifikimin e inspektimeve nga DIK.

-Mos rakordimi ndërmjet sektorit të lejeve mjedisore, sektorit të Monitorimeve dhe sektorit të Financës për numrin e lejeve të dhëna nga viti 2015 e vijim ka bërë që të mos planifikohen si të ardhura në buxhet tarifa vjetore e lejeve mjedisore për vitin 2020 në shumën 12 090 000 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 12 955 000 lekë, kjo në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 5 dhe neni 9 “Arkëtimet”, pika i, ku përcaktohet se të ardhurat e buxhetit të shtetit përbëhen nga tatimet, taksat dhe tarifat. Në këtë pikë janë dhe tarifat vjetore për lejet e tipit A,B,C sipas VKM-së nr. 417 datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit”.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr. 3324/2, datë 18.05.2023 drejtuar Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit “Kërkesë për dërgimin e databazës së debitorëve për tarifat e lejeve A dhe B”, ku kërkohet ...Të ndodhur në kushtet që tarifat nga lejet e mjedisit kreditohen në llogari të Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit dhe jo në Llogarinë e AKM-së kërkojmë nga ana Juaj të na vini në dispozicion database me listën e subjekteve debitorë për tarifën e Leje Mjedisore A dhe B në mënyrë që të procedojmë në zbatim të rekomandimit të Auditit të MTM-së”

Në momentin e auditimit nuk ka përgjigje nga MTM në lidhje me kërkesën e AKM.

Me ndryshimet ligjore të VKM nr. 417, datë 25.6.2014, “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”, (ndryshuar me VKM-në nr. 462, datë 26.7.2023). Në vitin 2023 Sektori i Financës dhe Buxhetit ka marrë masa për përmirësimin e situatës dhe arkëtimin e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit, duke krijuar databazën e subjekteve (format excel) me të gjitha lejet që disponojnë, shumën totale që duhet të kishin paguar që nga vitit 2014 deri në vitin 2022 (pa përfshirë tarifën e vitit 2023 e cila ka afat pagese deri në fund të vitit) dhe shumën totale që rezultojnë të kenë paguar subjektet (NIPT) nga 2014 - 2022 për të gjitha lejet që disponojnë.

Për sa më lart më hollësisht është mbajtur Projektraporti i Auditimit nisur me nr. 562/7, datë 22.11.2023, për të cilin në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë paraqitur observacione në rrugë elektronike dhe me shkresën nr. 9757/1, datë 22.12.2023, marrës KLSH, me nr. 562/15, datë 22.12.2023; nga nëpunësit: A.D, E.K, E.M, O.DH, E.K, N.N.

- Në lidhje me pretendimi se: AKM ka nisur procedurat për evidentimin e subjekteve debitorë dhe për përmirësimin e situatës për arkëtimin e të ardhurave

- Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin merret në konsideratë .

- Në lidhje me pretendimi se: konfirmimi i dosjeve për pajisjen me leje mjedisore në rastet e cituara në projekt raportin e auditimit është në përputhje me dokumentacionin ligjor të kërkuar

- Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë për pjesën e shkeljeve të konstatuar është përshkruar hollësisht në pjesën e Raportit Përfundimtar të Auditimit, ndërsa merret në konsideratë mos përgjegjësia administrative për ata që nuk kanë nënshkruar procesverbalin e mbledhjes së komisionit.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Mos evidentimi dhe arkëtimi i detyrimeve debitore nga tarifat vjetore.
<b>Situata:</b>	<p>-Nga mosrakordimi ndërmjet drejtorive dhe sektorëve të AKM-së për numrin e lejeve mjedisore, për vitet 2020 - 2021 konstatohet një diferencë tarife vjetore prej 13 040 000 lekë. Gjithashtu nga evidentimi i bërë nga sektori i financës së AKM-së për periudhën 2015 deri më qershor 2020, janë evidentuar detyrime të tarifës vjetore për 840 subjekte në shumën 8 522 000 lekë. Në momentin e auditimit nga Sektorin e Financës në AKM nuk disponohet lista e 840 subjekteve debitore.</p> <p>-Sektori i Monitorimit nuk ka bërë evidentimin e subjekteve të pajisur me leje mjedisore A dhe B për likuidimin e tarifës vjetore të lejeve sipas VKM nr. 417 datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit”, detyrë kjo funksionale e përcaktuar në rregulloren e AKM-së. Ky sektor duhet të kishte bashkërenduar informacionet me sektorin e financës dhe buxhetit për të evidentuar subjektet që kanë bërë likuidimin e tarifës dhe më pas të hartonte listën e subjekteve që nuk kanë likuiduar këtë tarifë dhe t’ja paraqiste drejtorit të drejtorisë. Kjo listë do shërbente edhe si bazë për planifikimin e inspektimeve nga Drejtoria e Inspektimit e Kontrollit.</p>
<b>Kriteri:</b>	ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 5 dhe neni 9 “Arkëtimet”, pika i VKM nr. 417 datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit” (ndryshuar me VKM-në nr. 462, datë 26.7.2023).
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos rakordimi ndërmjet sektorit të lejeve mjedisore, sektorit të Monitorimeve dhe sektorit të Financës për numrin e lejeve të dhëna nga viti 2015 e vijim ka bërë që të mos planifikohen si të ardhura në buxhet tarifa vjetore e lejeve mjedisore.
<b>Shkaku:</b>	Mos rakordimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për evidentimin e detyrimeve të pa paguara nga tarifa vjetore për lejet mjedisore.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa: - Në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit për të evidentuar dhe arkëtuar detyrime të tarifës vjetore nga 840 subjekte në shumën 8 522 000 lekë; - Për të hartuar një bazë të dhënash unike ku të përcaktohen detyrimet e pagesës të tarifave vjetore të lejeve mjedisore nga subjektet që rezultojnë në Regjistrin Kombëtar të lejeve dhe licencave, në QKB me përditësimin nga arkëtimet.

***Lejet Mjedisore III.2.B. sipas bazës së të dhënave administruar në AKM***

Aktiviteti i subjekteve në fushën e grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme, si veprimtari licencohet mbështetur në VKM nr. 538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar.

Baza ligjore për këtë kategori mbi të cilën mbështet licencimi: Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; ligji nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; ligjin nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” të ndryshuar; ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar; VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

rrezikshme”, ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020), VKM nr. 371, datë 11.06.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, ndryshuar me VKM nr. 1032, datë 16.12.2020; Urdhrit të Ministrit të Mjedisit nr. 135 datë 16.04.2015 “Për Miratimin e Mënyrës së Administrimit të Formatit të Regjistrit të Transfertave Individuale dhe të Regjistrit Kombëtar të Transfertave si dhe Mënyrën e Administrimit të tyre”.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori përkatës referuar regjistrave të licencave për periudhën nga viti 2012 deri në 31.12.2022 janë miratuar gjithsej 497 Licenca III. 2. B nga të cilat 39 prej tyre në momentin e auditimit kanë statusin “Jo aktiv”, “Pezulluar” apo “Revokuar” në QKB.

Nga total 458 Licenca III.2.B. aktive, 80 prej tyre janë përsëritje për subjekte të cilat janë pajisur njëherë me licence III.2.B., por që kanë kërkuar shtim kodesh ose ndryshim vendndodhje, pra gjithsej janë 378 subjekte aktive me licenca III.2.B.

Në 31.12.2022 subjekte të pajisur me Kod Unik në përputhje e zbatim të VKM nr. 229, datë 23.4.2014 i ndryshuar, është 233 subjekte, nga 378 subjekte aktive me licenca III.2.B., ndërsa 145 subjekte operojnë dhe janë aktivë pa Kod Unik.

Për periudhën 2014 deri 2019 Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka miratuar kode unike për 171 subjekte. Ndërsa në momnetin e auditimit me gjithë miratimet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, (me ndryshime ligjore) nëpërmjet sistemit e-Albania numri i subjekteve me Kod Unik ka arritur në 246.

Nga verifikim i pajisjeve me Kod Unik konstatohet se Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit ka miratuar më shume se një kod për të njëjtin subjekt në 13 raste. Megjithëse Kodi unik 7 shifror duhet të jetë një për çdo subjekt, kemi miratime të Kodit Unik sa herë subjekti ka aplikuar për ndryshim të licencës, ndryshim Kodesh mbetjesh si dhe shtim të vendndodhjeve duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit” (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020) pika 16 ku përcaktohet:

*16. Pjesa e parë e kodit unik është individuale dhe e papërsëritshme për çdo subjekt që transferon mbetje jo të rrezikshme, ndërsa pjesa e dytë e këtij kodi vendoset nga vetë personi që transferon mbetjet te pritësi dhe ndryshon për çdo transfertë.*

Rastet e konstatuara të miratimit të Kodeve Unik të ndryshëm për subjekte të njëjtë:

Subjekti	NIPT	PN	Kodi Unik
V.A.L.E. R	L2.....1Q	LN-6125-02-2013	VLR0064
			VER0190
4 A-M	K9.....6L	LN-5609-07-2018	AML0093
			KAM0193
			KAM0194
A.P	K9.....1A	LN-2170-10-2016	APO0051
			APO0253
E.P	L1.....2A	LN-5356-06-2018	EPK0175
			EGP0143
G.C.LC9017	K6.....4K	LN-1648-12-2020	GTC0226
			GTC0225
E.LC5390	K6.....2Q	LN-4646-09-2022	EMR0255
			EMR0258



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Nga regjistri i monitorimeve për raportimet e transfertave të mbetjeve nga subjektet e pajisura me kod unik, duke mos marrë për bazë vitin 2020 i cili ka qenë viti i pandemisë ku kanë raportuar mesatarisht 20 subjekte, në vitet 2021 dhe 2022 kanë raportuar mesatarisht 50 subjekte regjistrat e transferimit të mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme pranë AKM-së.

Ne rastin e miratimit të Kodit Unik nga AKM, subjekti me marrjen e Kodit Unik raportimi e transfertave e realizonte brenda të njëjtit institucion. Duke qenë se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (e cila miraton Kodet Unike nga 01.01.2021 me ndryshimet ligjore) bazën e të dhënash për Kodet Unike, ia përcjell të përditësuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, brenda datë s 10 janar të çdo viti dhe baza e të dhënave shërben si pjesë e “Regjistrat Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve Jo të Rrezikshme”, regjistër që mban Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Kjo ka krijuar një hapësirë kohore për mos koordinim dhe kontroll të kësaj baze të dhënash mbi subjektet të pajisur me Kod Unik, duke favorizuar operatorët të mos raportojnë në vitin e parë të pajisjes me kod unik. Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur një rakordim/ndërveprim të dokumentuar midis Drejtorive Teknike dhe Inspektoratit në AKM pasi:

- Regjistri i licencave nuk është i mirë organizuar dhe i unifikuar.
- Regjistri Kombëtar i Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme nuk është i azhurnuar në kohë me raportimet e transfertave dhe regjistrimet e Kodit Unik nga subjekte të pajisur me licencë III.2.B.

Për mos veprime në përputhje e zbatim të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në nenet 62 dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020), Pika 19 ku përcaktohet:

*Pika 19. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim dhe në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.*

VKM nr. 371, datë 11.6.2014, “Për Miratimin e Rregullave për Dorëzimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe të Dokumentit të Dorëzimit të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 1032, datë 16.12.2020), Pika 25 ku përcaktohet:

*Pika 25. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.*

Si dhe në kundërshtim me Neni 63 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, ku përcaktohet:

*3. Licenca e transportit të mbetjeve, e tregtarit dhe agjentit të mbetjeve revokohet nga ministri, me propozimin e inspektoratit, kur shkelen kushtet dhe rregullat e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit për ushtrimin e veprimtarisë dhe për këtë ministri njofton Qendrën Kombëtare të Licencimit.*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi E.K dhe N.P

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Mos azhurnimi i Regjistrat Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve Jo të Rrezikshme, dhe pajisja jo në përputhje me kërkesat ligjore me Kod Unik të subjekte me licenca III.2.B.
<b>Situata:</b>	1. Nga verifikim i pajisjeve me Kod Unik konstatohet se Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit ka miratuar më shume se një kod për të njëjtin subjekt në 13 raste. Megjithëse Kodi unik 7 shifror duhet të jetë një për çdo subjekt, kemi miratime të Kodit Unik sa herë subjekti ka aplikuar për ndryshim të licencës, ndryshim Kodesh mbetjesh si dhe shtim të vendndodhjeve duke vepruar në



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	<p>kundërshtim me VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit” (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020) pika 16.</p> <p>2. Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur një rakordim/ndërveprim të dokumentuar midis Drejtorive Teknike dhe Inspektoratit në AKM pasi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Regjistri i licencave nuk është i mirë organizuar,</li><li>- Regjistri Kombëtar i Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme nuk është i azhurnuar në kohë me raportimet e transfertave dhe regjistrimet e Kodit Unik nga subjekte të pajisur me licencë III.2.B. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në nenet 62 dhe 63 si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020), Pika 19 dhe VKM nr. 371, datë 11.6.2014, “Për Miratimin e Rregullave për Dorëzimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe të Dokumentit të Dorëzimit të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 1032, datë 16.12.2020), Pika 25.</li></ul>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në nenet 62 dhe 63 si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020), Pika 19 dhe VKM nr. 371, datë 11.6.2014, “Për Miratimin e Rregullave për Dorëzimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe të Dokumentit të Dorëzimit të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 1032, datë 16.12.2020), Pika 25.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nga mos pasja e një baze të dhënash unike dhe të përditësuar ulet mundësia e ndjekjes dhe kontrollit të zbatim të detyrimeve ligjore në mbrojtje të mjedisit.
<b>Shkaku:</b>	Mos unifikimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave në kohë me raportimet e transfertave dhe regjistrimet e Kodit Unik nga subjekte të pajisur me licencë III.2.B. nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit .
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ti kërkojë Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të marrë masa për revokimin e më shumë se një Kodi Unik për të 6 subjektet: “V.A.L.E. R“4 A-M”; “A.P”; “E.P”; “G.C”; “ELC”.</li><li>2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që: Regjistri Kombëtar i Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme të azhurnohet në kohën reale të transfertave të deklaruara për të patur shkëmbim informacioni shkresor midis Drejtorive Teknike dhe Inspektoratit në AKM.</li></ol>

***Mbi auditimin e procedurave të Sektorit të Monitorimit***

Sektori i Monitorimit në zbatim të Rregullores së brendshme ka për detyrë të hartojë një bazë të dhënash me të gjithë subjektet e pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe B dhe të marrë në dorëzim dhe analizojnë Raportet e Vet Monitorimit nga subjektet pranë kësaj zyre duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, kryesisht edhe në Ligjin nr. 9024, datë 6.3.2003 “Për akreditimin e laboratorëve testues kalibrues, organizmave certifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë”, të VKM nr. 435, datë 12.9.2002 “Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

e Shqipërisë”, të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, të VKM nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”, Udhëzimit nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.

Për vitin 2021 pranë këtij sektori janë dorëzuar 1462 Raporte vetëmonitorimi nga të cilat 1396 raporte vetëmonitorimi nga subjekte të pajisur me leje mjedisore tipi B dhe 66 raporte vetëmonitorimi nga subjekte të pajisur me leje mjedisore tipi A, si dhe 830 Vlerësime të Ndikimit në Mjedis dhe Deklarata Mjedisore. Gjatë vitit 2021 janë evidentuar 514 subjekte të cilët nuk kanë përmbushur kushtin e dorëzimit të raporteve Vetëmonitorimit për të cilat sipas raportit vjetor është njoftuar Drejtoria e Inspektim kontrollit.

Për vitin 2022 pranë këtij sektori janë dorëzuar 2741 Raporte vetëmonitorimi nga të cilat 165 raporte vetëmonitorimi nga subjekte të pajisur me leje mjedisore tipi A dhe 2576 raporte vetëmonitorimi nga subjekte të pajisur me leje mjedisore tipi B, si dhe 81 Vlerësime të Ndikimit në Mjedis dhe Deklarata Mjedisore. Po kështu janë administruar 45 raporte vjetore vetëmonitorimi nga subjekte të pajisur me leje mjedisore tipi A; 1183 raporte vjetore vetëmonitorimi nga subjekte të pajisur me leje mjedisore tipi B, si dhe 17 Vlerësime të Ndikimit në Mjedis.

Gjatë vitit 2022 sipas raportimit të vetë sektorit për subjektet që nuk kanë paraqitur raportet e Vetëmonitorimit me rrugë shkresore është njoftuar Drejtoria e Inspektim kontrollit.

Për subjektet të evidentuara që nuk kanë dorëzuar raportin e vetëmonitorimit nuk ka dokumentacion që ky sektor të ketë njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm për fillimin e proceduarve të revokimit, veprim në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.

Për periudhën objekt auditimi në gjendje 31.12.2022 në Drejtori të ndryshme në AKM disponojnë baza të të dhënave mbi lejet mjedisore aktive që nuk përputhen me njëra tjetrën. Sektori i Monitorimit ka numër të ndryshëm leje mjedisore të miratuar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit konkretisht në vitin 2022 sipas Sektorit të Lejeve Mjedisore janë miratuar 15 Leje Mjedisore të tipit A dhe 636 Leje Mjedisore të Tipit B, ndërsa sipas Sektorit të Monitorimit janë miratuar 2 Leje Mjedisore të tipit A dhe 284 Leje Mjedisore të Tipit B.

Diferenca në evidentim të lejeve mjedisore ndërmjet dy sektorëve ka sjellë si pasojë mos evidentimin e saktë të subjekteve që kanë detyrimin ligjor që të sjellin raportet e monitorimeve, gjë që ndikon në evidentimin e saktë të detyrimeve të lindura, por edhe në planifikimin e inspektimeve nga Drejtoria e Inspektimit e Kontrollit.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” (Ndryshuar me ligjin nr. 44/2013, datë 14.2.2013, nr. 60/2014, datë 19.6.2014, nr. 52/2020, datë 30.4.2020) në nenin 23 “Menaxhimi i informacionit” dhe neni 29 “Kundërvajtjet” pika 2 ku përcaktohet:

*2. Informacioni që i jepet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga operatori i një veprimtarie, subjekt i këtij ligji, nëpërmjet procesit të vetëmonitorimit, mund të përdoret për të vërtetuar përgjegjësinë penale apo administrative të atij operatori apo çdo personi tjetër në një çështje gjyqësore.*

Si dhe Ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (Ndryshuar me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015, nr. 128/2020, datë 22.10.2020) neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria” pika 1 e 2 ku përcaktohet:

*1. AKM-ja përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit e të ndikimeve të rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në vendimin për VNM-në paraprake apo deklaratën mjedisore.  
2. Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, kryen vetëmonitorimin e ndikimeve të rëndësishme të projektit në mjedis dhe i raporton AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.*



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Procesi i aplikimit për pajisje me leje mjedisore kryhen në QKB, nga ku kalojnë në AKM dhe pasi plotësohet dokumentacioni subjektet marrin njoftim për pajisjen me leje mjedisore nga QKB-ja.

Nisur nga mos pasja e një baze të dhënash unike për lejet mjedisore. Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 3885, datë 24.05.2023 ka kërkuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit informacion mbi lejet mjedisore aktive. Nga QKB në 31.05.2023 është përcjellë informacioni mbi lejet mjedisore aktive të lëshuara nga vitit 2009. Aktualisht në formatin elektronik janë të regjistruara 5329 në formatin PN.

Nga analizimi i të dhënave të disponuara konstatohet se:

Në regjistrin e lejeve ekzistojnë leje me format të vjetër, VNM/Deklarata Mjedisore si dhe subjekte të pajisur me leje mjedisore apo VNM pa raportuar asnjëherë konkretisht:

*Subjekte me leje format i vjetër*

Subjekte/vitet	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Shuma
Leje format vjetër	9	193	336	335	284	117	-	1274
VNM/Deklarata Mjedisore					160	30	400	590

Nga shqyrtimi i të dhënave për subjektet e mësipërme konstatohet subjekte me leje mjedisore aktive por me aktivitet te pezulluar apo mbyllur.

*Subjekte jo aktive me leje format i vjetër*

Subjekte/vitet	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Shuma
Leje format vjetër	4	67	146	30	7	17		271
VNM/Deklarata Mjedisore					16	5	50	71

Mos azhurnimi dhe përditësimi i të dhënave të subjekteve pajisur me leje mjedisore është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 i ndryshuar neni 30 pika 2 ku përcaktohet:

2. *Operatori i një instalimi ekzistues të tipit A ose të tipit B, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përmes QKB-së, kërkesën për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit të tipit A ose të tipit B, sipas rastit, në përputhje me kërkesat e reja të këtij ligji dhe planin e përputhshmërisë, së bashku me afatet përkatëse.*

Me ristrukturimin e AKM në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr. 187, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” me efekt nga data 01.04.2023. Sektori i Monitorimit nga varësia e Drejtorisë së Inspektimit dhe Kontrollit kalon në varësi të Drejtorisë së Lejeve Mjedisore e VNM.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Në gjendje 31.12.2022, Drejtori të ndryshme në AKM disponojnë baza të dhënash mbi lejet mjedisore aktive që nuk përputhen me njëra tjetrën.
<b>Situata:</b>	Nga rakordimi shkresor midis AKM dhe QKB u konstatua se në regjistrin e lejeve ekzistojnë leje me format të vjetër, VNM/Deklarata Mjedisore si dhe subjekte të pajisur me leje mjedisore apo VNM pa raportuar asnjëherë konkretisht, 1274 Leje Mjedisore format i vjetër si dhe 590 VNM/Deklarata Mjedisore. Nga të cilat rezultojnë se subjekte disponues të këtyre lejeve mjedisore aktualisht janë me status pezulluar dhe jo aktiv në 271 raste qe korrespondojnë me leje mjedisore format I vjetër si dhe 71 raste qe korrespondojnë VNM/Deklarata Mjedisore. Mos azhurnimi dhe përditësimi i të dhënave të subjekteve pajisur me leje mjedisore është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 30 pika 1 dhe 2.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

<b>Kriteri:</b>	Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 30 pika 1 dhe 2.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nga mos pasja e një baze të dhënash unike dhe të përditësuar ulet mundësia e ndjekjes dhe kontrollit të zbatim të detyrimeve ligjore në mbrojtje të mjedisit.
<b>Shkaku:</b>	Mos unifikimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave mbi lejet mjedisore nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa të planifikojë kryerjen e inspektimeve në subjekte të konstatuar me leje mjedisore model i vjetër për evidentimin e veprimtarisë ose jo dhe për rastet me shkelje t’i kërkojë Ministrit të Turizmit dhe të Mjedisit për pezullim apo shfuqizimin e lejeve mjedisore.

**2.4. Mbi auditimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara.**

Për periudhën objekt auditimi nga data 1 Janar 2020 deri më 31.12.2022, marrja e Vendimeve të Ndikimit në Mjedis aplikimi, shqyrtimi dhe dhënia e vendimit përkatës nga Komisioni i Shqyrtimit të Aplikimeve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), zhvillohet nëpërmjet sistemit elektronik. Procesi i VNM-së është kryer në zbatim të bazës ligjore dhe në përputhje me afatet e vendosura në të. VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, (Ndryshuar me VKM nr. 95, datë 14.2.2018, nr. 714, datë 6.11.2019), në përputhje e zbatim të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”(Ndryshuar me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015, nr. 128/2020, datë 22.10.2020).

Në këtë kuadër ka dalë edhe aktet ligjore e nënligjore: VKM Nr. 43, datë 15.01.2020 “Për funksionimin e procesit të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik”. (SQDNE); Urdhri i Kryeministrit Nr. 153 Prot, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 01.01.2020”; si dhe Urdhrin e Brendshëm Nr. 154, datë 29.10.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM.

Në zbatim të VKM-së Nr. 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, (ndryshuar me vendimin e KM-së nr. 268, datë 27.4.2023), për projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të VNM-së, nuk parashikohet konsultimi me publikun. Nga auditimi i dosjeve për VNM e lëshuara on-line në sistemin e-leje për instalime e prodhimit të energjisë hidroelektrike (HEC-e), në përgjithësi janë dokumentuar dëgjesa me publikun, pranë njësive të banuara, kjo e bazuar në VKM 686, datë 29.7.2015, të ndryshuar.

Gjatë auditimit u konstatua se në komunikimin për marrjen e mendimeve për shqyrtimin e aplikimeve nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikes dhe Bashkitë në të shumtën e rasteve janë miratuar në heshtje, në përputhje e zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” pa një reflektim shkresor për mendimin e kërkuar, megjithëse mund të kenë impakt mjedisor për komunitetin dhe mjedisin.





**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Aktiviteti i këtij sektori për periudhën e auditimit paraqitet sipas viteve në tabelat e mëposhtme:

Përmbledhje e bazës së të dhënave për procedurë të VNM-ve, Viti 2020		
1	Aplikime gjithsej	1096
2	VNM paraprake	682
3	Aplikim VNM e thelluar	7
5	Refuzime	27
6	Dosje të çuara për Info shtesë	333
7	Miratime VNMTH (Deklaratë Mjedisore)	34
8	Projekte shtetërore	120

Përmbledhje e bazës së të dhënave për procedurë të VNM-ve, Viti 2021		
1	Aplikime gjithsej	1284
2	VNM paraprake	841
3	Aplikim VNM e thelluar	4
5	Refuzime	49
6	Dosje të çuara për Info shtesë	359
7	Miratime VNMTH (Deklaratë Mjedisore)	31
8	Projekte shtetërore	140

Përmbledhje e bazës së të dhënave për procedurë të VNM-ve, Viti 2022		
1	Aplikime gjithsej	1375
2	VNM paraprake	885
3	Aplikim VNM e thelluar	19
5	Refuzime	31
6	Dosje të çuara për Info shtesë	404
7	Miratime VNMTH (Deklaratë Mjedisore)	36
8	Projekte shtetërore	91

Nga vlerësimi i procedurës së ndjekur për pajisje me leje mjedisore për disa subjekte me zgjedhje: U shqyrtuan vendimmarrjet në komisioneve: nr. 7, datë 07.02.2020; nr. 64, datë 23.12.2020; nr. 45, datë 24.08.2020; nr. 5, datë 28.01.2021; nr. 8, datë 15.02.2021; nr. 06, datë 01.02.2022.

Nga VNM e audituar me zgjedhje u konstatuan:

**Viti 2020**

Në relacionin e mbledhjes nr. 64, datë 23.12.2020, Komisioni i Shqyrtimit të Aplikimeve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis janë

**Subjekti B**, Referuar kërkesës së subjektit “BH.S” Shpk me nr. AN031220200003 dhe datë aplikimi 03/12/2020 në lidhje me procedurën paraprake të VNM-së për projektin “Dallgëthyes (pistë) dhe stacion shërbimi” Qerret, Kavajë. Miratuar me Komisionin nr. 64 Tiranë, më: 23.12.2020

Në aplikimin për pajisjen me VNM në dokumentacionin e paraqitur është theksuar “*Vepra është ndërtuar, punimet e ndërtimit janë përfunduar. Mënyra e ndërtimit: shtimi i materialeve inerteve, betoni i shtresës së sipërme të dallgëthyeses, pastrimi i veprës dhe rehabilitim*”.



Miratimi i VNM pasi ka mbaruar vepra si është cilësuar edhe në raportin teknik të paraqitur vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 10440 Nenin 6 “Përkufizime”, pika 2. Ku përcaktohet: (“Zhvillues” është personi ose autoriteti publik që kërkon miratim për të zhvilluar një projekt privat apo publik.)

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor i Përgjithshëm, J.M P/Sektorit Juridik dhe Marrëdhënieve Ligjore, E.M P/Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, B.T P/Sektorit të Lejeve Mjedisore, L.GJ P/Sektorit të Monitorimit, J.C, E.SH, E.Z Specialiste në Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

**Subjekti A.S**, I është drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Lënda: “Aplikim për Deklaratë Mjedisore”. Referuar shkresës së AKM me nr. 3105, datë 20.06.2019 “Njoftim për vazhdim procedure të VNM të thelluar” dhe në bazë të VKM nr. 686, datë 29.07.2015, paraqet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit aplikimin për Deklaratë mjedisore, projekti “Shfrytëzimi mineralit “Gur Gëlqeror, në objektin Shashicë”, Kaninë Vlorë.

Në dokumentacionin e paraqitur në format “PDF” nga Sektorit i “Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM” (pasi nuk mund të aksesoni në sistemin “e-leje”) u konstatua se:

Subjekti “A.S” ka paraqitur dëgjuesën me publikun për vend ndodhjen e instalimit mbajtur në 13.11.2018 (jo konform modelit të përcaktuar dhe pa pjesëmarrje publiku të dokumentuar me nënshkrime të rregulla nga ana vizuale). Megjithëse AKM me shkresë nr. 3105, datë 20.06.2019 “Njoftim për vazhdim procedure të VNM të thelluar” në qëndrimin e saj ka kërkuar plotësimin e informacionit me Konsultimin me publikun në bazë të VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, duke njoftuar AKM paraprakisht.

Nga AKM me Vendimin nr. 7, datë 07.02.2020 ka miratuar Deklaratën mjedisore, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” si dhe VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K, Drejtor i Përgjithshëm, F.K Drejtor i Drejtorisë Vlerësimit Mjedisor, E.M P/Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, A.F Specialiste Sektorit Lejeve Mjedisore, J.C, O.M Specialiste në Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, L.GJ P/Sektorit të Përgjegjësi Mjedisore, E.H Juriste.

**Subjekti “G-G”**, Referuar kërkesës së subjektit “G-G” me nr. AN260720200002 dhe datë aplikimi 27.07.2020 në lidhje me lëshimin e Deklaratës Mjedisore për projektin “Karrierë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe linjë fraksionimi”, Fshati Mirakë, pranë Tunelit, Polis, Librazhd, Elbasan.

Në shqyrtimin e dokumentacionit nga sistemi “e- leje” administrohet edhe shkresa e AKZM datë 28.01.2020 Lënda: “Dhënie mendimi”: *Për tu shprehur për Aplikimin me nr. AN260720200002 me aktivitetin “Gurore, miniera sipërfaqësore dhe nxjerrje e torfës”, me zhvillues G-G dhe aplikues G-G, na ridërgoni koordinatat e sakta.*

AKM me Vendimin nr. 45, datë 26.08.2020, vendosi Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për Zhvilluesin Personi juridik: “G-G” sh.p.k.

Në Vendim e AKM është shprehur: *Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura: Pas shqyrtimit të koordinatave të paraqitura rezultoi se sipërfaqja ku subjekti ‘G’ sh.p.k ka si qellim të projektit “Shfrytëzim i gurit gëlqeror në sipërfaqe, me karriere” në Librazhd, ndodhet jashtë, në kufi të zonës së mbrojtur RNM Kuturman. Subjekti të respektojë koordinatat e paraqitura në aplikim dhe të mos cenojë zonën e mbrojtur.*

Në dokumentacionin e administruar në sistemin “e-leje” nuk ka shkresë nga AKZM në shqyrtim të pozicionimit të karrierës në lidhje Zonën e Mbrojtur çka përbën kusht për shqyrtimin dhe dhënien e lejes mjedisore veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” si dhe VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave,



të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K, Drejtor i Përgjithshëm, F.K Drejtor i Drejtorisë Vlerësimit Mjedisore, E.M P/Spektori të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, B.T P/Spektorit të Lejeve Mjedisore, J.C, E.SH, E.Z Specialiste në Sektori të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, B.K P/Spektori Përgjegjësive Mjedisore, J.M P/Spektorit Juridik dhe Marrëdhënieve Ligjore.

### **Viti 2021**

**Subjekti B-94**, Referuar kërkesës së subjektit “B-94 me nr. AN0140120210007 dhe datë aplikimi 14.01.2021 në lidhje me procedurën paraprake të VNM-së për projektin “Industri nxjerrëse minerali” fshati Udënisht, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

Komisioni i aprovimit me nr. 8 Vendimi “Mbi aplikimin Shfrytëzimi i mineralit Krom” nga subjekti “B. - 94” sh.p.k. Referuar raportit teknik dhe koordinatave të paraqitura nga vetë subjekti, kjo sipërfaqe ndodhet në zonën e mbrojtur “Liqeni i Pogradecit”, shpallur me VKM-në Nr. 80, datë 18.02.1999, “Peizazh i Mbrojtur Tokësor/Ujor”, Zonë UNESCO dhe Zonë me Përparësi për Zhvillimin e Turizmit. Komisioni është shprehur negativisht për zhvillimin e këtij aktiviteti. Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: E.K Drejtor i Përgjithshëm, J.M P/Spektorit Juridik dhe Marrëdhënieve Ligjore, E.MP/Spektori të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, O.DH (pa firmë) P/Spektori të Lejeve Mjedisore, L.GJ P/Spektorit të Monitorimit, J.C, (pa firmë) E.SH, E.Z Specialiste në Sektori të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

### **Viti 2022**

**Subjekti “G.B”**, Referuar kërkesës së subjektit “G,B” me nr. AN120820210004 dhe datë aplikimi 13.08.2021 në lidhje me lëshimin e Deklaratës Mjedisore për projektin “Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike” (Ndërtim HEC “guri i bardhë 1 dhe 2). Vend ndodhja Rrjedhja e përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), Fshati Guri i Bardhë , Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos Dibër.

- Në shqyrtimin e dokumentacionit nga sistemi “e- leje”, administrohet edhe shkresa e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Dibër referuar Aplikimit në sistemin “e-leje” AN300320200002, nga subjekti “G.B” për “VNM Paraprake” me nr. Prot. 104/1, datë 21.04.2020 Lënda: “*Mendim për fillimin e procedurës VNM e thelluar*”. Në pikën 7 “Raporti i Konsultimit me Publikun” theksohet: Mendimi Negativ, Bashkia Klos na e ka sjellë bashkë me një kopje të petitionit të një pjesë të banorëve që kundërshtojnë këtë projekt.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në sistemin “e-leje” konstatojmë se sipas Aplikimit AN120820210004 komisioni nr. 06, datë 03.02.2022 ka miratuar “Deklarata Mjedisore” për projektin “Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike” (Ndërtim HEC “guri i bardhë 1 dhe 2) subjektit “G.B”.

- Nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura janë vendosur kushte në lidhje me afërsinë e Objektivit me Zonën e Mbrojtur.

- Nga Agjencia Rajonale e Mjedisit ka mendim pozitiv në lidhje me praktikën.

*Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:*

*Konsultimi me publikun, u krye në datë n 03.08.2021, ora 12:00. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, nga Nj.Q.V. Xibër, nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.*

- Në historikun e aplikimit pasqyruar në sistem konstatohet se në datë 07.09.2021 nga Njësia e Qeverisjes Vendore Klos është marrë “Aprovim automatik në heshtje” nga kërkesa e dërguar po në datë 31.08.2021



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Nga sa me lart kemi një aprovim në heshtje dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit nuk është e dokumentuar qëndrimi i banorëve që kanë marrë pjesë në peticionin kundër objektit, si dhe nuk ka sqarime apo korespondencë me NjQV Klos mbi peticionin e banorëve për të cilin është shprehur në shkresën e datë s 21.04.2020.

Veprim në kundërshtim me me ligjin nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” si dhe VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni: A.D Drejtor i Përgjithshëm, J.M P/Sektorit Juridik dhe Marrëdhënieve Ligjore, E.M P/Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, A.D P/Sektorit të Lejeve Mjedisore, E.K P/Sektorit të Monitorimit, O.N (LZ), J.T, E.Z, E.S Specialiste në Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

*Ankesat administruar në Agjenci Kombëtare të Mjedisit.*

Për periudhën objekt auditimi, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit janë dokumentuar 39 ankesa ose kërkim informacioni në lidhje me veprimtarinë dhe ndikimin në mjedis të subjekteve zhvilluese, për të cilat AKM-ja rast pas rasti i ka shqyrtuar e dhënë përgjigje.

*Për sa më lart më hollësisht është mbajtur Projektraporti i Auditimit nisur me nr. 562/7, datë 22.11.2023, për të cilin në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë paraqitur observacione me shkresën nr. 10750, datë 20.12.2023 marrës KLSH me nr. 562/10, datë 21.12.2023; nr. 562/12, datë 22.12.2023; nr. 562/14, datë 22.12.2023; nr. 9757/1, datë 22.12.2023, marrës KLSH, me nr. 562/15, datë 22.12.2023; nga nëpunësit: A.D, E.K, E.M, B.T, J.M, O.K, E.SH, E.Z.*

**- Në lidhje me pretendimi se:** Për VNM e aprovuara për subjektet “B”, “Alko Stoun”, “G-G”, “B-94”, “G,B”, AKM është Autoriteti përgjegjës për licencimin. Në zbatim të Ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011 pikës 10, të neni 6, “Autoriteti përgjegjës për licencimin” është institucioni publik që, brenda funksioneve dhe kompetencave të caktuara në ligj, është përgjegjës për miratimin ose jo të një lejeje/licence të caktuar për projektet që janë subjekt i këtij ligji.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë për pjesën e shkeljeve të konstatuar është përshkruar hollësisht në pjesën e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Nga komisionet e shqyrtimit të aplikimeve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ka miratime të VNM në shkelje procedurave ligjore.
<b>Situata:</b>	<p><b>Në 1 raste</b> kemi miratim të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis <b>Subjekti B</b> me Komisionin nr. 64 Tiranë, më 23.12.2020 për projektin “Dallgëthyese (pistë) dhe stacion shërbimi” Qerret, Kavajë. Miratimi i VNM pasi ka mbaruar vepra si është cilësuar edhe në raportin teknik të paraqitur vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 10440 Nenin 6 “Përkufizime”, pika 2.</p> <p><b>Në 2 raste</b></p> <p>- <b>Subjekti A.S</b> nga AKM me Vendimin nr. 7, datë 07.02.2020 ka miratuar Deklaratën mjedisore, me dokumentacion për dëgjesën me publikun në vend ndodhjen e instalimit mbajtur në 13.11.2018 jo konform modelit të përcaktuar dhe pa pjesëmarrje publiku të dokumentuar me nënshkrime të rregulla nga ana vizuale. Megjithëse AKM me shkresë nr. 3105, datë 20.06.2019 “Njoftim për vazhdim procedure të VNM të thelluar” në qëndrimin e saj ka kërkuar plotësimin e informacionit me Konsultimin me publikun.</p> <p>- <b>Subjekti “G.B”,</b> komisioni nr. 06, datë 03.02.2022 ka miratuar “Deklarata Mjedisore” për projektin “Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike” (Ndërtim HEC “guri i bardhë 1 dhe 2) subjektit “G.B”.</p>



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	<p>- Nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura janë vendosur kushte në lidhje me afërsinë e Objektivit me Zonën e Mbrojtur.</p> <p>- Në historikun e aplikimit pasqyruar në sistem konstatohet se në datë 07.09.2021 nga Njësia e Qeverisjes Vendore Klos është marrë “Aprovim automatik në heshtje” nga kërkesa e dërguar po në datë 31.08.2021. Nga Agjencia Rajonale e Mjedisit nuk është e dokumentuar qëndrimi i banorëve që kanë marrë pjesë në peticionin kundër objektivit, si dhe nuk ka sqarime apo korespondencë me NjQV Klos mbi peticionin e banorëve për të cilin është shprehur në shkresën e datë s 21.04.2020.</p> <p>Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” si dhe VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, si dhe VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.</p> <p><b>Në 1 rast</b> me Vendimin nr. 45, datë 26.08.2020, vendosi Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për Zhvilluesin Personi juridik: <b>“G-G” sh.p.k.</b> Në dokumentacionin e administruar në sistemin “e-leje” nuk ka shkresë nga AKZM në shqyrtim të pozicionimit të karrierës në lidhje Zonën e Mbrojtur çka përbën kusht për shqyrtimin dhe dhënien e lejes mjedisore veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” si dhe VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”; VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.; si dhe VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Miratimi i Vendimeve të Ndikimit në Mjedis në kundërshtim me rregullat, bën që të mos merren masa nga subjektet zhvillues në mbrojtjen e mjedisit.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i legjislacionit në miratimin e VNM nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa të kryerje inspektimeve në subjekte, B, A.S, G,B dhe G-G, për vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedis.

**2.5. Mbi auditimin e procedurave të kryerjes së inspektimeve dhe marrjen e masave për ndotësit e mjedisit.**

Për periudhën objekt auditimi në përbërje të Drejtorisë së Inspektimit dhe Kontrollit që funksionon sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 23, datë 03. 02. 2020, është Sektori i Inspektimit Kontrollit Mjedisor me 19 punonjës si dhe Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) me 8 punonjës;



Fusha e veprimtarisë së Drejtorisë së Inspektimit Kontrollit (DIK) është:

- Sigurimi i kontrollit shtetëror, i mbrojtjes së mjedisit dhe ujërave sipas legjislacionit në fuqi;
- Sigurimi i zbatueshmërisë të kushteve e lejeve të mjedisit, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ligjit “Për lejet e mjedisit”;
- Përputhshmëria e kushteve të lejes me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- Hetimin e zonave të ndotura si dhe çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

**Spektori i Inspektimit Mjedisor** si pjesë e Drejtorisë së Inspektimit Kontrollit me ristrukturimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka filluar aktivitetin nga data 01.07.2020. Aktivitetin e zhvillon mbështetur në ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr. 52/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

Te gjitha Inspektimet janë kryer on-line. Autorizimet janë lëshuar konform ligjit për inspektimet dhe procedura e inspektimit e ndjekur dhe zbatuar nga grupet e inspektimit të Sektorit Inspektimit Mjedisor ka qenë përgjithësisht e rregullt.

Programi i inspektimeve për periudhën Gusht-Dhjetor 2020, është paraqitur në formatin PDF dhe pa numër protokollit. Në dokumentacionin e administruar për auditim janë paraqitur edhe Planet mujore për Inspektim nga ky sektor vetëm për muajin Shtator.

Për periudhën Gusht –Dhjetor 2020 si më sipër janë planifikuar gjithsej 345 inspektime, nga të cilat janë kryer vetëm 80 Inspektime përkatësisht në muajin Gusht janë kryer 56 inspektime, në muajin Shtator janë kryer 13 inspektime, në muajin Tetor është kryer 1 inspektim, në muajin Nëntor është kryer 1 inspektim dhe në muajin Dhjetor janë kryer 9 inspektim. Në asnjë rast nuk ka analizë risku, në përzgjedhjen e veprimtarive apo subjekteve për inspektim. Në këto inspektime kanë marrë pjesë 13 inspektorë dhe janë inspektuar subjekte me veprimtari: Thertore, Prodhim betoni, Gurore, Rritje intensive e kafshëve, Rritje intensive e peshqve dhe Nxjerrje jashtë përdorimi te produkteve te skaduara.

Me shkresën nr. 26, datë 06.01.2021 Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka kërkuar miratimin nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit programin e inspektimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2021, program i Miratuar. Në dokumentacionin e administruar për auditim janë paraqitur edhe Planet mujore për Inspektim nga ky sektor vetëm për Muajt Janar-Shkurt, Maj –Qershor, dhe Gusht - Nëntor.

Për periudhën Janar –Dhjetor 2021 si më sipër janë planifikuar gjithsej 442 inspektime, nga të cilat janë kryer vetëm 184 Inspektime në 8 muaj përkatësisht në muajin Janar janë kryer 3 inspektime, në muajin Shkurt janë kryer 33 inspektime, në muajin Maj janë kryer 28 inspektime, në muajin Qershor janë kryer 21 inspektime, në muajin Gusht janë kryer 29 inspektime, në muajin Shtator janë kryer 26 inspektime, në muajin Tetor janë kryer 28 inspektime dhe në muajin Nëntor janë kryer 16 inspektime. Në asnjë rast nuk ka analizë risku, në përzgjedhjen e veprimtarive apo subjekteve për inspektim. Nga 184 inspektime gjithsej janë aplikuar 10 Dënim Administrativ me “Gjobë”, vlera e gjobave është 3,600,000 lekë dhe 25 Dënim Administrativ me “Paralajmërim”. Në këto inspektime kanë marrë pjesë 17 inspektorë dhe janë inspektuar subjekte me veprimtari: Thertore, Prodhim betoni, Gurore, Rritje intensive e kafshëve dhe Nxjerrje jashtë përdorimi te produkteve te skaduara.

Me shkresën nr. 599, datë 24.01.2022 Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka kërkuar miratimin nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit programin e inspektimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2021, program i Miratuar me nr. 599/2, datë 24.01.2022. Në dokumentacionin e administruar për auditim janë paraqitur edhe Planet mujore për Inspektim nga ky sektor vetëm për Muajt Shkurt - Dhjetor.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Për periudhën Janar –Dhjetor 2022 si më sipër janë planifikuar gjithsej 497 inspektime, nga të cilat janë kryer 499 Inspektime në 11 muaj përkatësisht në muajin Shkurt janë kryer 48 inspektime, në muajin Mars janë kryer 79 inspektime, në muajin Prill janë kryer 32 inspektime, në muajin Maj janë kryer 63 inspektime, në muajin Qershor janë kryer 68 inspektime, në muajin Korrik janë kryer 33 inspektime, në muajin Gusht janë kryer 17 inspektime, në muajin Shtator janë kryer 75 inspektime, në muajin Tetor janë kryer 38 inspektime, në muajin Nëntor janë kryer 18 inspektime, dhe në muajin Dhjetor janë kryer 28 inspektime. Në asnjë rast nuk ka analizë rrishtu, në përzgjedhjen e veprimtarive apo subjekteve për inspektim. Nga 499 inspektime gjithsej janë aplikuar 21 Dënim Administrativ me “Gjobë”, vlera e gjobave është 8,000,000 lekë dhe 3 Dënim Administrativ me “Pezullim” .

Në këto inspektime kanë marrë pjesë 18 inspektorë si dhe me Urdhër nr. 25, datë 07.02.2022 kanë marrë pjesë inspektorët e sektorit të Inspektimit Mjedisor dhe janë inspektuar subjekte me veprimtari: Gurore, Thertore, Prodhim betoni, Skrap, Miniera dhe Nxjerrje jashtë përdorimi te produkteve te skaduara.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm.

Ngarkon me përgjegjësi Kejdi Ahmetaj Përgjegjës Sektori i Inspektimit Mjedisor; D.SDrejtor Drejtorja e Inspektim Kontrollit; E.K Drejtor i Përgjithshëm dhe A.D Drejtor i Përgjithshëm.

Për periudhën objekt auditimi u përzgjedhën 73 dosje nga ku konkludua se procedura e inspektimit është përgjithësisht e rregullt. Grupet e inspektimit, për çdo inspektim të kryer i janë referuar ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr. 52/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar.

Nga shqyrtimi i akteve të inspektimit dhe nga verifikimi i dokumentacionit që kanë paraqitur subjektet e inspektuara, rezulton se janë të rregullta dhe korrespondojnë me aktet e procesverbalet e inspektimit, te pasqyruar nga grupi i inspektimit, si dhe ka lënë detyra konkrete për përmirësimin e situatës në subjekte.

Nga auditimi i inspektimeve në subjekte me aktivitet në “Prodhim betoni”, “Gurorë”, “Rritje intensive e kafshëve”, “Rritje intensive e peshqve” dhe “Miniera” u konstatuan:

**“E” shpk NIPT: K3.....2W**

Autorizim Inspektimi me nr. AKM-DQ-2020-000009 - 1 Datë : 12.08.2020; Proces –verbali i inspektimit datë 25.08.2020; Inspektorët I.B, A.G, H.B.

Objekti i inspektimit: Informacion i detyrueshëm periodik.

Adresa e Objekti: Fshati Samaticë, lagjja "Qendër ", Kutalli, Berat.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar shkeljet cituara në proces-verbalin datë 25.08.2020: Gjetjet e konstatuara në procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjeve:

1. Neni: 29, ligji: Nr. 10448 , date 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" . Pika: b, ii). Subjekti nuk ka vaska dekantimi për ujera teknologjike dhe nuk kryen procesin e trajtimit te këtyre ujerave para shkarkimi ne burimin ujore pritës.

2. Neni: 23, ligji: nr. 9115, date 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisore te ujerave te ndotura", Pika: c. Subjekti nuk ka vaska dekantimi për ujera teknologjike dhe nuk kryen procesin e trajtimit të këtyre ujerave para shkarkimit ne burimin ujore pritës.

Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe në mbështetje të ligjit nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar, date 14.07.2011, nenit 29, Pika 1, germa b/ii, ligjit nr. 9115 "Për trajtimin mjedisore te ujerave te ndotura", date 24.07.2003, nenit 24 pika 1, b)



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi "Agjencia Kombëtare të Mjedisit"**

klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative dënime administrativ kryesor: me Gjobë : 300000 Lekë dhe Gjobë : 500000 Lekë.

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2020-000009 - 5 Datë : 28/09/2020 është përcaktuar: Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore.

Aplikimi i dënimit kryesor me gjobe sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datë s 25.08.2020 dhe marrja e Vendimit datë 28.09.2020 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ me Gjobe në 2 raste nuk mbështetet në dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës të Inspektimit.

Në dokumentacionin bashkëlidhur praktikës së inspektimit kompania E ka paraqitur një kontratë bashkëpunimi me kompaninë "E.K" për grumbullimin e mbetjeve dhe transportimin e mbetjeve në vend depozitimi final.

- Grupi i inspektimit në dokumentacionin e inspektuar nuk ka paraqitur pajisjen të subjekt "E.K" me Licencë III. 2. B, si dhe paraqitja Regjistrave për menaxhimin e mbetjeve nuk është në përputhje me kërkesat ligjore.

Veprime në kundërshtim me nenin 21, pikat 9, 10, dhe nenit 57, të ligjit nr. 10463, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", datë 22.09.2011 i ndryshuar, si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).

Për sa më lart nga inspektorët përgjegjës I.B, A.G, H.B, nuk është vepruar me Masat Administrative të përcaktuara në ligjin nr. 10463, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", datë 22.09.2011 i ndryshuar neni 62 "Kundërvajtjet dhe sanksionet. Pikat 9, 10 dhe 57, në vendosjen e gjobës nga 300,000 mijë lekë në 1,000,000 lekë.

**Subjektit: "A.C" shpk NIPT: K0.....1W** Nxjerrje minerali nëntokësor

Autorizimi për inspektim: Nr. AKM-DQ-2021-000164 – 1, datë : 27.10.2021, procesverbali i inspektimit datë 03.11.2021; Inspektorët I.B, J.P, J.T

Objekti i inspektimit: Zbatim i kushteve të lejes mjedisore; vendndodhja: Batër Krastë, Martanesh, Bulqizë.

**Subjektit: "11H" shpk NIPT: K0.....1W**

Autorizimi për inspektim: Nr. AKM-DQ-2021-000166 – 1, datë : 12.11.2021, procesverbali i inspektimit datë 03.11.2021; Inspektorët I.B, J.P, J.T

Objekti i inspektimit: Zbatim i kushteve të lejes mjedisore; vendndodhja: Batër-Krastë, Martanesh, Bulqizë.

Në vendimet e inspektimit në të dy rastet Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

*Nga inspektimi në terren operatori me leje mjedisore me PN-7420-10-2018, PN-8534-05-2019 i lihet detyra të vendos rreperat për përcaktimin e zonës së ushtrimit të aktivitetit sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore. Operatorit i lihet detyra që të vendos tabelat sinjalizuese dhe informuese në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit. Operatori i lihet detyra dhe të marri masa që të gjithë dokumentacionin mjedisor ta mbaje në vendndodhjen ku ushtron aktivitetin. Operatorit i lihet detyra që raportin e vetëmonitorimit dhe raportin vjetor, të kryhen sipas kushteve të shkruara dhe të miratuara, për secilin nga parametrat e përcaktuara në lejen mjedisore dhe raportet mbi zbatimin e kushteve, të raportojë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit brenda afateve të përcaktuara në lejen mjedisore përkatëse.*

Nga subjektet e inspektuar ka përgjigje shpresore për masat e mara në eliminimin e shkeljeve të konstatuara, këto përgjigje janë të administruara në dosjen elektronike të inspektimit, administruar për auditim. Nga AKM nuk ka një planifikim për të kryer Inspektime për verifikim e konstatimeve dhe detyrave të lëna nga inspektimet.





**Subjektit: “G.D.F” NIPT: L8.....2M**

Autorizim Inspektimi me Nr. AKM-DQ-2021-000162 - 1 Datë : 27/10/2021; Proces –verbali i inspektimit datë 04.11.2021; Inspektorët P.M dhe O.T.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kushteve te lejes mjedisore; Adresa e Objekti: Autostrada Tirane - Durrës, nr. Pasurie 345/41, 345/43, 345/47,345/49, Zona Kadastrale 3852, Durrës.

Përshkrim i objektit të inspektimit.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar :

- Subjekti nuk disponon licencë III. 2. B për transportin e mbetjeve te parrezikshme te gjeneruara nga zhvillimi i aktivitetit.

- Nuk ka paraqitur dokumentet e transferimit te mbetjeve te parrezikshme te kërkuara nga ana e autoritetit kompetent.

- Nuk ka paraqitur kontrate me subjekte te licencuara për trajtimin, transferimin dhe asgjësimin e mbetjeve te parrezikshme te gjeneruara nga procesi i trajtimit, ngjyrosjes dhe pigmentimit te tekstileve dhe fibrave te përpunuara gjate zhvillimit te aktivitetit për te cilat nuk bën trajtim ne vendndodhje referuar tabelës 8.1.2 te kushtit 8. 2. Subjekti nuk ka paraqitur regjistër për sasinë e mbetjeve te gjeneruara nga instalimi dhe nuk ka raportuar ne AKM.

Në proces verbal është cilësuar:

Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe në mbështetje të ligjit nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, date 9/22/2011, nenit 62, pikat 6, 9 dhe 57; ligjit nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar., date 7/14/2011, nenit 29, Pika 1, germa b/ii , klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobë: 500,000 lekë; Gjobë: 300,000 lekë; Gjobë: 1,000,000 lekë; Gjobë: 300,000 lekë;

Për shkeljet dhe gjetjet e konstatuara ne procesverbalin e inspektimit, operatori ka paraqitur shpjegimet dhe kontestimet e tij ne Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me shkresën me nr. prot 5213/1, date 22.11.2021. Në kontestime ka paraqitur (Kopje) “Kontratë evadimi mbetje të rrezikshme” me subjektin “M-T” lidhur në datë 04.01.2021 me afat deri 31.12.2021 subjekt i pajisur me Licencë III. 2. B. Dokumenti për transferimin e mbetjeve për vetëm një sasi prej 450 kg, pa e dokumentuar sasinë e prodhuar sipas procesit teknologjik, por vetëm me deklaram. Nuk ka dokumentacion sqarues për arsyet e mos paraqitjes të këtij dokumentacioni në momentin e inspektimit.

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2021-000162 - 5 Datë : 24/11/2021 është përcaktuar: Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Aplikimi i dënimit kryesor me gjobe sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datë s 04.11.2021 dhe marrja e Vendimit datë 24.11.2021 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ me Gjobe në 4 raste nuk mbështetet dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës, P.M dhe O.T c’ka i ngarkon me përgjegjësi për mos veprim në mbështetje të ligjit nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, date 9/22/2011, nenit 62, pikat 6, 9 dhe 57; ligjit nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar., date 7/14/2011, nenit 29.

**Subjektit: 4 A-M NIPT: K 9.....6 L Inerte**

Autorizim Inspektimi me Nr. AKM-DQ-2022-000256 – 1; datë : 27/05/2022; Proces –verbali i inspektimit datë 30.06.2022; Inspektorët O.T dhe S.H.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kushteve te lejes mjedisore; Adresa e Objekti: Te ura e Matit, Fshati Pllan, Komuna Zejmen, Qarku Lezhë.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar :

-Nuk është realizuar projekti i kanalizimeve perimetrike,

-Nuk është funksionale dhe të sistemuara gropat e dekantimit për trajtimin e ujerave teknologjik që gjenerohen nga impianti i franksionimit te inerteve.



-Nuk janë mbyllur depozitat me argjinate sipas specifikimeve ne kushtin 3 te lejes mjedisore qe disponon.

Në proces verbal është cilësuar:

Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe në mbështetje të ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, date 7/14/2011 , neni 29, Pika1, germa b, ii , parashikohet dënim administrativ, Gjobe:= 300,000 lekë

Per shkeljet dhe gjetjet e konstatuara ne procesverbalin e inspektimit, operatori ka paraqitur shpjegimet dhe kontestimet e tij ne Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me shkresën me nr. prot 342/1, date 06.07.2022.

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000256 – 5, datë 14.07.2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ dhe është cilësuar *“Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive”*.

Për sa më lart Drejtoria e Inspektimit Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar përmbushjen e detyrave të lëna në inspektimin e cituar më lart. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë nga inspektorët përgjegjës, O.T dhe S.H, c’ka i ngarkon me përgjegjësi për mos veprim në mbështetje të ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, date 7/14/2011 , neni 29.

#### **Subjektit: “B.V2013” NIPT: L3.....1V Inerte**

Autorizim Inspektimi me Nr. AKM-DQ-2022-000196 - 1; datë : 05.05.2022; Proces –verbali i inspektimit datë 12.05.2022; Inspektorët P.M, J.T.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kushteve te lejes mjedisore; Adresa e Objekti: Lagjja "11 Janari ", ish Poligoni i Bonifikimit, Vlorë.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar shkelje të Pika: 1, germa b/ii, në nenin: 29 të ligjit nr. 10448, date 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar:

- Nuk ka ndërtuar vaske dekantimi për sistemimin dhe grumbullimin e ujerave qe gjenerohen nga procesi i prodhimit te produkteve te betonit dhe larja e betonierëve.

- Subjekti nuk ka paraqitur planin e përputhshmërisë.

- Subjekti nuk na paraqiti kontrate me subjekte te licencuara për trajtimin dhe evadimin e gomave të përdorura të gjeneruara nga mjetet qe disponon për zhvillimin e aktivitetit për të cilat nuk bën trajtim ne vendndodhje.

- Subjekti nuk na paraqiti kontrate me subjekte te licencuara për trajtimin dhe evadimin e vajrave të përdorura të gjeneruara nga mjetet që disponon për zhvillimin e aktivitetit për te cilat nuk bën trajtim ne vendndodhje.

- Subjekti nuk na paraqiti planin e çmontim/rehabilitimit.

- Subjekti nuk ka vendosur sinjalistikën siguroese dhe informuese për te shmangur incidentet/aksidentet ne vendndodhjen e instalimit në kundërshtim me pikën 1të nenit nr. 48 të ligjit nr. 10433, date 16.06.2011 "Për Inspektim në Republikën e Shqipërisë".

Nga Inspektorët në proces verbalin e datë 12.05.2022 nuk është konstatuar shkelja e mos pagesës së tarifës jashtë afatit të përcaktuar në VKM nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”, pasi në dosjen digjitale të inspektimit administrohet kopje e mandat arkëtimi i tarifës që mban datë 10.05.2022. Në VKM nr. 417, datë 25.06.2014 afati i pagesës është 3-Mujori i parë i vitit.

*Në proces verbal është cilësuar:*

Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe në mbështetje të ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, date 7/14/2011 , neni 29, Pika1, germa b, ii , parashikohet dënim administrativ, Gjobe: “300,000 lekë” dhe “Paralajmërim”

*Në vendimin Përfundimtar të Inspektimit*

Dënimi Administrativ: “Paralajmërim”



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Për sa më lart Drejtoria e Inspektim Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar përmbushjen e detyrave të lëna në inspektimin e cituar më lart. Nuk ka dokumentacion për argumentimin e mos aplikimit të Gjobës së propozuar në Proces-Verbal datë 12.05.2022, dhe marrjen e Masës Administrative “paralajmërim”. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, date 7/14/2011 , neni 29, Pika1 c’ka i ngarkon me përgjegjësi Inspektorët P.M, J.T.

**“C.L” NIPT: L7.....4C Rritje shpendësh**

Autorizim Inspektimi me Nr. AKM-DQ-2022-000610 - 1 Datë : 28/10/2022; Proces –verbali i inspektimit datë 16.11.2022; Inspektorët O.T dhe S.H.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kushteve te lejes mjedisore; Adresa e Objekti: Berdice e Madhe, truall me numër pasurie 506/17, zona kadastrale 1157,Bërdicë, Shkodër.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar :

- nuk paraqiti pagesën e tarifës vjetore
- nuk paraqiti raportin e vetëmonitorimit te plote
- nuk ka planin e menaxhimit te mbetjeve sipas kushtit 8, pasi nuk përcakton, menaxhimin e mbetjeve qe subjekti gjeneron gjate ushtrimit te aktivitetit/kontratit me subjekte te licencuara për menaxhimin e tyre.

Në proces verbal është cilësuar:

Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe në mbështetje të ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, neni 29, Pika1, germa b, ii , parashikohet dënim administrativ, Gjobe:= 300,000 lekë.

Për shkeljet dhe gjetjet e konstatuara ne procesverbalin e inspektimit, operatori ka paraqitur shpjegimet dhe kontestimet e tij ne Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me shkresën me nr. prot 327, date 12.12.2022. Shoqëruar me Deklaratën e subjektit për mbetjet; Plani i Menaxhimit të mbetjeve si dhe Raport i vetëmonitorimit i plotë. Në dosjen digjitale nuk ka sqarime pse nuk u paraqitën gjatë inspektimit, nuk ka dokumentacion për administrimin ose largimin e mbetjeve, shkarkimin e ujërave sipërfaqësore, si dhe nuk ka dokumentacion për pagesën e tarifës.

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000610 - 5 Datë : 14/12/2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ dhe është cilësuar *“Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive”*.

Për sa më lart Drejtoria e Inspektim Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar përmbushjen e detyrave të lëna në inspektimin e cituar më lart. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë nga inspektorët përgjegjës, O.T dhe S.H c’ka i ngarkon me përgjegjësi për mos veprim në mbështetje të ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, date 7/14/2011 , neni 29.

**“D.B” NIPT: K9.....2R Rritje shpendësh**

Autorizim Inspektimi me Nr. AKM-DQ-2022-000614 - 1 Datë : 01/11/2022; Proces –verbali i inspektimit datë 23.11.2022; Inspektorët O.T dhe S.H.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kushteve te lejes mjedisore; Adresa e Objekti: Lagjja “18 Tetori“, Rruga “ Antipatrea “, godine tre katesh nr. 22, kati pare, zona kadastrale nr. 3682, me numër pasurie 1/490, Ura Vajguore, Berat.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar :

- nuk ka kryer plotësisht analizat e te gjithë komponentëve sipas tabelës 7.2.3 te kushtit 7 te lejes mjedisore.
- nuk ka kryer plotësisht analizat e te gjithë komponentëve sipas tabelës 7.3.2 dhe tabelës 7.3.4 te kushtit 7 te lejes mjedisore.

Në proces verbal është cilësuar:



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe në mbështetje të ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, neni 29, Pika1, germa b, ii , parashikohet dënim administrativ, Gjobe:= 300,000 lekë

Për shkeljet dhe gjetjet e konstatuara ne procesverbalin e inspektimit, operatori ka paraqitur shpjegimet dhe kontestimet e tij ne Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me shkresën me nr. Prot. 891, date 06.12.2022. Ku ka cituar raportin e Vetëmonitorimit për periudhën 08 Mars – 08 Shator 2022. Në dosjen digjitale nuk ka sqarime pse nuk u paraqitën në gjatë inspektimit, (në procesverbalin e inspektimit datë 23.11.2022 në dokumentet e marra citohet edhe Raporti i Vetëmonitorimit por nuk citohet periudha).

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000614 - 5 Datë : 16/12/2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ dhe është cilësuar *“Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive”*.

Për sa më lart Drejtoria e Inspektimit Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar përmbushjen e detyrave të lëna në inspektimin e cituar më lart. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë nga inspektorët përgjegjës, c’ka i ngarkon me përgjegjësi O.T dhe S.H për mos veprim në mbështetje të ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, date 7/14/2011 , neni 29,.

**Subjektit : “P” NIPT: J6.....6G Peshk**

Autorizim Inspektimi me Nr. AKM-DQ-2022-000263 - 1 Datë : 27/05/2022; Proces –verbali i inspektimit datë 03.06.2022; Inspektorët O.T dhe S.H.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kushteve te lejes mjedisore; Adresa e Objekti: Portit Detar, Shëngjin, LEZHE.

Përshkrim i objektit të inspektimit.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar:

- :Mënyra e marrjes dhe analizimit te komponentit BOD si dhe dhënia e rezultatit brenda ditës nuk është sipas standardeve te akreditimit te laboratorit

- Subjekti nuk i ka dorëzuar pranë AKM regjistrat e transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme sipas VKM Nr. 229. date 23.04.2014.

Në proces verbal është cilësuar:

Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe në mbështetje të ligjit nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, date 9/22/2011, nenit 21, pikat 9 dhe 10, dhe 57; ligjit nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar., date 7/14/2011, neni 29, Pika 1, germa b/ii, klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobë: 300,000 lekë; Gjobë: 1,000,000 lekë;

Për shkeljet dhe gjetjet e konstatuara ne procesverbalin e inspektimit, operatori ka paraqitur shpjegimet dhe kontestimet e tij ne Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me shkresën me nr. prot 4131/1, date 17.06.2023. Në kontestime ka paraqitur (Kopje) “Kontratë evadimi mbetje jo të rrezikshme” me subjektin “E. E” (subjekt i pajisur me Licencë III. 2. B) me afat nga 08.02.2022 për 1 vit, si dhe dokumenti për transferimin e mbetjeve për Muajt Janar- Maj 2022 i cili nuk është në formën e kërkuar nga VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).

Nuk ka dokumentacion sqarues për arsyet e mos paraqitjes të këtij dokumentacioni në momentin e inspektimit.

Në listën e dokumentacionit të marrë gjatë inspektimit dhe pasqyruar në Proces-Verbalin datë 03.06.2022 është cilësuar edhe Kontrata shërbimi me subjektin “E.E” si dhe Regjistrat për menaxhimin e mbetjeve Janar-Maj 2022, ndërsa në pikën 7 “Gjetjet e konstatuara” të Proces-Verbalit datë 03.06.2022, përshkruhet si veprim në kundërshtim me kërkesat ligjore të cituara.



**Kontrulli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000263 - 5 Datë : 01/07/2022 është përcaktuar: Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore.

Aplikimi i dënimit kryesor me gjobe sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datë s 04.11.2021 dhe marrja e Vendimit datë 01.07.2022 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ me Gjobe në 2 raste nuk mbështetet në dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës të Inspektimit O.T dhe S.H.

*Për sa më lart më hollësisht është mbajtur Projektraporti i Auditimit nisur me nr. 562/7, datë 22.11.2023, për të cilin në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë paraqitur observacione me shkresën nr. 9757/1, datë 22.12.2023, marrës KLSH, me nr. 562/15, datë 22.12.2023; O.T, , P.M, J.T.*

**- Në lidhje me pretendimi se:** në inspektimin e subjektit “B.V” pagesa e leje mjedisore mund të bëhet brenda vitit kalendarik se edhe vendosja e masës administrative “Paralajmërim” në inspektimin e subjektit është masë kryesore.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë për pjesën e shkeljeve të konstatuar pasi: procesverbali i inspektimit mban datë 12.05.2022 ndërsa është 1 vit më vonë VKM nr. 462, datë 26.07.2023 për një ndryshim të VKM 417, datë 25.06.2014. për pjesën e shkeljeve të konstatuar është përshkruar hollësisht në pjesën e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**- Në lidhje me pretendimi se:** në inspektimin e subjektit “G.D.F” është zbatuar legjislacioni për inspektimin dhe është vperuar pas pandemisë

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë pasi për pjesën e shkeljeve të konstatuar është përshkruar hollësisht në pjesën e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**- Në lidhje me pretendimi se:** Ashtu sikurse është cituar nga grupi i auditimit, subjekti i inspektuar ka plotësuar dokumentacionin dhe ka paraqitur komentet, faktet dhe kontestimet përkatëse për secilën gjetje të kryer nga inspektorët, brenda afateve ligjore të parashikuara në ligjin për inspektimin dhe legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen e mjedisit dhe lejet e mjedisit. Vendimi përfundimtar, bazohet në parimet e ligjit të inspektimit, gjithashtu inspektorët/et që kryejnë inspektimin janë të pavarur në vendimmarrje.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë për pjesën e shkeljeve të konstatuar është përshkruar hollësisht në pjesën e projektraportit.

**- Në lidhje me pretendimi se:** Dëshirojmë t’ju bëjmë me dije se togfjalëshi “Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive” është i gjeneruar nga vet sistemi i e-inspektimit në momentin që nuk lihen komente nga ana e grupit të inspektimit.

Drejtoria e Inspektimit Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar përmbushjen e detyrave të lëna në inspektimin e cituar më lart. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë.

Procedimi administrativ i këtij inspektimi është kryer në respektim të legjislacionit në fuqi dhe pas kalimit të afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë për pjesën e shkeljeve të konstatuar është përshkruar hollësisht në pjesën e projektraportit.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Në kryerjen e dokumentimit on-line të inspekteimeve ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative.
<b>Situata:</b>	- Proces-verbali i inspektimit datë 25.08.2020; Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. 5, datë 28/09/2020 në subjektin “E” shpk NIPT: K3.....2W.



Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Grupi i inspektimit në dokumentacionin e inspektuar nuk ka paraqitur pajisjen të subjekt “E.K” me Licencë III. 2. B, si dhe paraqitja Regjistrave për menaxhimin e mbetjeve nuk është në përputhje me kërkesat ligjore. Për këtë nuk është vepruar me Masat Administrative të përcaktuara në ligjin nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar neni 62 “Kundërvajtjet dhe sanksionet. Pikat 9, 10 dhe 57.

- procesverbali i inspektimit datë 03.11.2021 në **Subjektin: "A.C" shpk NIPT: K0.....1W**, dhe procesverbali i inspektimit datë 03.11.2021 në **Subjektin: "11H" shpk NIPT: K0.....1W**. Vendimet e inspektimit në të dy rastet korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive.

- Proces –verbali i inspektimit datë 04.11.2021 në **Subjektin: “G.D.F” NIPT: L8.....2M** Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative e klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobë: 500,000 lekë; Gjobë: 300,000 lekë; Gjobë: 1,000,000 lekë; Gjobë: 300,000 lekë. Aplikimi i dënimit kryesor me gjobe sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datë s 04.11.2021 dhe marrja e Vendimit datë 24.11.2021 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ me Gjobe në 4 raste nuk mbështetet dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës. Veprime në kundërshtim me të ligjit nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, date 9/22/2011, neni 62, pikat 6, 9 dhe 57; ligjit nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar., date 7/14/2011, neni 29, Pika 1, germa b/ii.

- Proces –verbali i inspektimit datë 30.06.2022, në **Subjektin: 4 A-M NIPT: K9.....6L**. Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit datë 14.07.2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ dhe është cilësuar “*Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive*”.

Për sa më lart Drejtoria e Inspektim Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar përmbushjen e detyrave të lëna në inspektimin e cituar më lart. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë.

- Proces–verbali i inspektimit datë 12.05.2022 në **Subjektin: “B.V2013” NIPT: L3.....1V**. Nga Inspektorët nuk është konstatuar shkelja e mos pagesës së tarifës jashtë afatit në datë 10.05.2022. Nuk ka dokumentacion për argumentimin e mos aplikimit të Gjobës së propozuar në Proces-Verbal datë 12.05.2022, dhe marrjen e Masës Administrative “paralajmërim”. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, date 7/14/2011 , neni 29, Pika1, germa b, ii, VKM nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”.

- Proces–verbali i inspektimit datë 16.11.2022 në subjektin **“C.L” NIPT: L7.....4C**. Nuk ka dokumentacion për mos aplikimit të Gjobës për shkeljen e konstatuar. Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit datë 14/12/2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ ... *Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive*”. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, date 7/14/2011, neni 29, Pika1.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	<p>- Proces-verbali i inspektimit datë 23.11.2022 në subjektin <b>D.B” NIPT: K9.....2R</b>. Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobë: 300,000 lekë. Aplikimi i dënimit kryesor me gjobe sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datë s 23.11.2022 dhe marrja e Vendimit datë 16/12/2022 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448 "Për Lejen e Mjedisit", i ndryshuar, date 7/14/2011, neni 29, Pika 1, germa b, ii.</p> <p>- Proces-verbali i inspektimit datë 03.06.2022 në <b>Subjektin “P” NIPT: J6.....6G</b>. Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe në mbështetje të ligjit nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, date 9/22/2011, nenit 21, pikat 9 dhe 10, dhe 57; ligjit nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar., date 7/14/2011, neni 29, Pika 1, germa b/ii, klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobë: 300,000 lekë; Gjobë: 1,000,000 lekë;</p> <p>Aplikimi i dënimit kryesor me gjobe sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datë s 04.11.2021 dhe marrja e Vendimit datë 01.07.2022 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ me Gjobe në 2 raste nuk mbështetet në dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës të Inspektimit.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>ligji nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", date 7/14/2011 i ndryshuar, neni 29, Pika 1, ligjin nr.10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar, neni 21, pikat 9, 10, dhe neni 57, si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).</p> <p>Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Mos aplikimi i dënimeve administrative në rastin e konstatimit të shkeljeve mjedisore si dhe mos kryerja e inspektimeve në subjektet problematike dhe me risk në ndotjen e mjedisit ndikon në mos parandalimin e ndotjes së mjedisit nga subjektet zhvillues e të pajisur me leje mjedisore.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mos zbatimi i legjislacionit Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E lartë.</p>
<b>Rekomandime:</b>	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektimit Kontrollit të marrë masa të planifikojë Inspektime për verifikim e konstatimeve dhe detyrave të lëna nga inspektimet në subjektet e inspektuara si dhe subjektet: “E” shpk NIPT: K3.....2W, "A.C" shpk NIPT: K0.....1W, "11H" shpk NIPT: K0.....1W, “G.D.F” NIPT: L8.....2M, 4 A-M NIPT: K9.....6L, “B.V2013” NIPT: L3.....1V, “C.L” NIPT: L7.....4C, D.B” NIPT: K9.....2R dhe “P” NIPT: J6.....6G.</p>

**Spektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore** si pjesë e Drejtorisë së Inspektimit Kontrollit me ristrukturimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka filluar aktivitetin nga data 01.07.2020. Aktivitetin e zhvillon mbështetur në ligjin nr. 111/2012 “ Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore ”, i ndryshuar si dhe ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e



Shqipërisë”. Te gjitha Inspektimet janë të kryera janë dokumentuar on-line. Autorizimet janë lëshuar konform ligjit për inspektimet dhe procedura e inspektimit e ndjekur dhe zbatuar nga grupet e inspektimit të Sektorit të Ujërave ka qenë përgjithësisht e rregullt.

Me shkresën nr. 3893, datë 22.07.2020 Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka kërkuar miratimin nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit programin e inspektimeve për periudhën Gusht-Dhjetor 2020, program i Miratuar me nr. 5467, datë 30.07.2020. Në dokumentacioni i administruar për auditim janë paraqitur edhe Planet mujore për Inspektim nga ky sektor vetëm për Muajt Gusht dhe Shtator. Për periudhën Gusht –Dhjetor 2020 si më sipër janë planifikuar gjithsej 115 inspektime, nga të cilat janë kryer vetëm 30 Inspektime përkatësisht në muajin Gusht janë kryer 12 inspektime dhe në Muajin Shtator janë kryer 18 inspektime. Në asnjë rast nuk ka analizë risku, në përzgjedhjen e veprimtarive apo subjekteve për inspektim. Nga 30 inspektime gjithsej nuk ka aplikim të asnjë mase administrative.

Në këto inspektime kanë marrë pjesë 4 inspektorë dhe janë inspektuar subjekte me veprimtari: 11- në imbotilim uji, 4- në prodhim pijesh, 6- në përpunim inerte dhe prodhim betoni, 4- në përpunim mish, qumësht dhe 5- në industri.

Me shkresën nr. 26, datë 06.01.2021 Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka kërkuar miratimin nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit programin e inspektimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2021, program i Miratuar. Në dokumentacioni i administruar për auditim janë paraqitur edhe Planet mujore për Inspektim nga ky sektor vetëm për Muajt Qershor –Korrik dhe Nëntor - Dhjetor.

Për periudhën Janar –Dhjetor 2021 si më sipër janë planifikuar gjithsej 276 inspektime, nga të cilat janë kryer vetëm 63 Inspektime në 4 muaj përkatësisht në muajin Qershor janë kryer 11 inspektime, në Muajin Korrik janë kryer 12 inspektime, në Muajin nëntor janë kryer 21 inspektime dhe në Muajin Dhjetor janë kryer 19 inspektime. Në asnjë rast nuk ka analizë risku, në përzgjedhjen e veprimtarive apo subjekteve për inspektim. Nga 63 inspektime gjithsej janë aplikuar 52 Dënim Administrativ me “Gjobë”, vlera e gjobave është 3,300,000 lekë dhe 2 Dënim Administrativ me “Paralajmërim”, në 7 subjekte përkatësisht: Subjektet “A.C”, “INC s.p.a.”, “D.E”, “A.I”, “B.E2018”, N” dhe “T.B”.

Në këto inspektime kanë marrë pjesë 6 inspektorë dhe janë inspektuar subjekte me veprimtari: 5- në imbotilim uji, 8- në përpunim mish, peshk, qumësht, 16- në përpunim inerte dhe prodhim betoni 19- në prodhim hidroenergji (HEC), 12- në industri, 2- në shërbime (Resort) dhe 1- në akuakulturë.

Me shkresën nr. 599, datë 24.01.2022 Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka kërkuar miratimin nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit programin e inspektimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2022, program i Miratuar me nr. 599/1, datë 24.01.2022. Në dokumentacioni i administruar për auditim janë paraqitur edhe Planet mujore për Inspektim nga ky sektor vetëm për Muajt Qershor, Korrik, Gusht, Shtator dhe Nëntor.

Për periudhën Janar –Dhjetor 2022 si më sipër janë planifikuar gjithsej 276 inspektime, nga të cilat janë kryer vetëm 93 Inspektime në 5 muaj përkatësisht në muajin Qershor janë kryer 25 inspektime, në Muajin Korrik janë kryer 26 inspektime, në Muajin Gusht janë kryer 7 inspektime në Muajin Shtator janë kryer 13 inspektime dhe në Muajin Nëntor janë kryer 22 inspektime. Në asnjë rast nuk ka analizë risku, në përzgjedhjen e veprimtarive apo subjekteve për inspektim. Nga 93 inspektime gjithsej janë aplikuar 1 Dënim Administrativ me “Paralajmërim” i vendosur në subjektin “U.K.K”.

Në këto inspektime kanë marrë pjesë 6 inspektorë dhe janë inspektuar subjekte me veprimtari: 30- në imbotilim uji, 8- në akuakulturë, 22- në përpunim inerte dhe prodhim betoni, 10- në trajtim i ujërave të zeza, 11- në ujëra kurative termale, 3- në prodhim pijesh, 4- në përpunim qumësht, mish dhe 5- në industri, shërbime.





**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm.

Ngarkon me përgjegjësi K.B Përgjegjës Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave); D.S Drejtor Drejtorja e Inspektim Kontrollit; E.K Drejtor i Përgjithshëm dhe A.D Drejtor i Përgjithshëm.

Për periudhën objekt auditimi u përzgjedhën 48 dosje nga ku konkludua se procedura e inspektimit është përgjithësisht e rregullt. Grupet e inspektimit, për çdo inspektim të kryer i referohet ligjit nr. 111/2012 “ Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore ” i ndryshuar dhe ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Nga shqyrtimi i akteve të inspektimit dhe nga verifikimi i dokumentacionit që kanë paraqitur subjektet e inspektuara, rezultoi se janë të rregullta dhe korrespondojnë me aktet e procesverbalet e inspektimit, të pasqyruar nga grupi i inspektimit, si dhe ka lënë detyra konkrete për përmirësimin e situatës në subjekte.

Nga auditimi i inspektimeve në subjekte me aktivitet në “Ujëra termale”, “Aquaculturë” dhe “Prodhim” u konstatuan:

**“E” shpk NIPT: K3.....2W Prodhim**

Autorizim Inspektimi me nr. AKM-DQ-2021-000016 - 1 Datë : 01/06/2021; Proces –verbali i inspektimit datë 08.06.2021; Inspektorët A.C dhe A.T.

Objekti i inspektimit: Kontrolli i zbatimit të kërkesave ligjore për përdorimin e burimit ujor. Adresa e Objekti: Fshati Samatice, lagjja " Qendër ", Kutalli, Berat.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar: Subjekti kryen monitorimin e cilësisë, sasisë së prodhimit të ujërave të përdorura industriale dhe shkarkimeve në mjedis ujor sipërfaqësor apo nëntokësor pas trajtimit dhe matjet e kryen në studio QMM vetëmonitorimi me NIPT K9.....6A dhe e ka dorëzuar në AKM në datë 04/02/2021 nr. 563 prot . Subjekti është i pajisur me Leje për Përdorim të Burimit Ujore miratuar me nr. 09 datë 01/12/2020 nga KBU Seman . Subjekti zbaton kushtet e lejes. Subjekti kryen trajtimin parësor të shkarkimeve të lëngëta. Subjekti ka sistem analizimesh brenda territorit të veprimtarisë.

Në dokumentacionin bashkëlidhur praktikës së inspektimit është dhe Raporti i Vetëmonitorimit për periudhën 29 Korrik deri 28 Janar 2021 dërguar në AKM me nr. 563, datë 04.02.2021. Në pikën 5 të raportit cilësohet se Kompania E ka një kontratë bashkëpunimi me kompaninë “E.K” për grumbullimin e mbetjeve dhe transportimin e mbetjeve në vend depozitimi final.

*Në këtë subjekt ka një inspektim sipas Proces-Verbalit të inspektimit 25.08.2020 nga Sektori i Inspektimit të Çështjeve Mjedisore janë konstatuar kundërvajtje administrative dhe në mbështetje të ligjit nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar., date 14.07.2011, nenit 29, Pika 1, germa b/ii, ligjit nr. 9115 "Për trajtimin mjedisore të ujërave të ndotura", date 24.07.2003 , nenit 24 pika 1, b) klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative dënim administrativ kryesor: me Gjobë : 300000 Lekë dhe Gjobë : 500000 Lekë.*

*Nga Grupi i Inspektimit nuk është trajtuar shkelja dhe nuk ka vepruar në përputhje me legjisllacionin si më poshtë:*

Grupi i inspektimit në dokumentacionin e inspektuar nuk ka paraqitur “Kontratë evadimi mbetje jo të rrezikshme” me subjekt të pajisur me Licencë III. 2. B, si dhe nuk referohen apo paraqiten Regjistrat për menaxhimin e mbetjeve.

Veprime në kundërshtim me nenin 21, pikat 9, 10, dhe nenit 57, të ligjit nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar, si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).



Për sa më lart nuk është vepruar me Masat Administrative të përcaktuara në ligjin nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar nën 62 “Kundërvajtjet dhe sanksionet. Pikat 9, 10 dhe 57, në vendosjen e gjobës nga 300,000 mijë lekë në 1,000,000 lekë, c’ka ngarkon me përgjegjësi Inspektorët A.C dhe A.T.

**B.B NIPT: K3.....4J Ujra Termale**

Autorizim Inspektimi me Nr. AKM-DQ-2022-000599 – 2, datë : 08/11/2022; Proces –verbali i inspektimit datë 08.11.2022; Inspektorët A.C dhe A.S.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kërkesave ligjore të përdorimit të burimeve ujore; Adresa e Objekti: Rruga Kuqan-Cërrik, Fshati Shirgjan, Elbasan.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar:

Referuar listës së verifikimit për burimet natyrore ujore, pika 9, Subjekti ka bërë aplikimin më datë 01.09.2022, pranë Baseni Ujor Shkumbin dhe Baseni Ujor Seman, për rinovimin e lejes së përdorimit burimit ujor nëntokësor.

-Leje përdorimi i Burimit Ujor me nr. 192, datë 25.03.2022 (Miratuar me Vendimin të Këshillit Basenit Ujor Shkumbin me nr. 3, datë 17.03.2022) për subjektin “B2020”, periudha e vlefshmërisë është 16.10.2022

Në proces verbal nuk është cilësuar mbarimi i afatit të lejes së përdorimit të basenit ujor por vetëm aplikimi për rinovim të lejes, dhe nuk theksohet që hyrja në fuqi e lejes së përdorimit bëhet “Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve”

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000599 - 5 Datë : 08/11/2022 është përcaktuar: 1. Dënim administrativ kryesor: *Nuk ka*; 2. Dënim administrativ plotësues: *Nuk ka*. 3. Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive: *Nuk ka*.

Për sa më lart nga grupi i inspektimit nuk janë përcaktuar shkeljet e konstatuara të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, në nenin 48 “Menaxhimi i burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermal” dhe klasifikohen si kundërvajtje administrative që në mbështetje e nenit 97, Pika7, parashikohet dënim administrativ, Gjore: nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë c’ka ngarkon me përgjegjësi Inspektorët A.C dhe A.S.

Për sa më lart Drejtoria e Inspektimit Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar rinovimin e lejes. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë.

**D.T NIPT: L0....50 Ujëra Termale**

Autorizim Inspektimi me AKM-DQ-2022-000602 – 1, datë: 28/10/2022; Proces –verbali i inspektimit datë 09.11.2022; Inspektorët A.C dhe A.S.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kërkesave ligjore të përdorimit të burimeve ujore; Adresa e Objekti: Fshati Cikallesh, rruga Tregan-Cikallesh, Tregan, Elbasan.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar:

Referuar listës së verifikimit për burimet natyrore ujore, pika 9, Subjekti ka bërë aplikimin më datë 16.11.2022, pranë Baseni Ujor Shkumbin dhe Baseni Ujor Seman, për rinovimin e lejes së përdorimit burimit ujor nëntokësor.

-Leje përdorimi i Burimit Ujor me nr. 53/2, datë 16.10.2017 (Miratuar me Vendimin të Këshillit Basenit Ujor Shkumbin me nr. 47, datë 10.10.2017) për subjektin “D.T”, periudha e vlefshmërisë është 5 vjet (deri më 16.10.2022)

Në proces verbal nuk është cilësuar mbarimi i afatit të lejes së përdorimit të basenit ujor por vetëm aplikimi për rinovim të lejes, dhe nuk theksohet që hyrja në fuqi e lejes së përdorimit bëhet “Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve”

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000602 - 5 Datë : 09/11/2022 është përcaktuar: 1. Dënim administrativ kryesor: *Nuk ka*; 2. Dënim administrativ plotësues: *Nuk ka*. 3. Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive: *Nuk ka*.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Për sa më lart nga grupi i inspektimit nuk janë përcaktuar shkeljet e konstatuara të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, në nenin 48 “Menaxhimi i burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermal” dhe klasifikohen si kundërvajtje administrative që në mbështetje e nenit 97, Pika7, parashikohet dënim administrativ, Gjore:nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë c’ka ngarkon me përgjegjësi Inspektorët A.C dhe A.S.

Për sa më lart Drejtoria e Inspektimit Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar rinovimin e lejes. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë.

**GJ.L NIPT: K8.....2J Ujra Termale**

Autorizim Inspektimi me Nr. AKM-DQ-2022-000605 - 1 Datë : 28/10/2022; Proces –verbali i inspektimit datë 11.11.2022; Inspektorët A.C dhe A.S.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kërkesave ligjore të përdorimit të burimeve ujore; Adresa e Objekti: Fshati Tregan, Elbasan.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar:

Referuar listës së verifikimit për burimet natyrore ujore, pika 9, Subjekti ka bërë aplikimin më datë 15.11.2022, pranë Baseni Ujor Shkumbin, për rinovimin e lejes së përdorimit burimin ujqor nëntokësor.

-Leje përdorimi i Burimit Ujqor me nr. 54/2, datë 16.10.2017 (Miratuar me Vendimin të Këshillit Basenit Ujqor Shkumbin me nr. 48, datë 10.10.2017) për subjektin “GJ.L”, periudha e vlefshmërisë është 5 vjet (deri më 16.10.2022)

Në proces verbal nuk është cilësuar mbarimi i afatit të lejes së përdorimit të basenit ujqor por vetëm aplikimi për rinovim të lejes, dhe nuk theksohet që hyrja në fuqi e lejes së përdorimit bëhet “Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve”

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000605 - 5 Datë : 11/11/2022 është përcaktuar: 1. Dënim administrativ kryesor: *Nuk ka*; 2. Dënim administrativ plotësues: *Nuk ka*. 3. Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive: *Nuk ka*.

Për sa më lart nga grupi i inspektimit nuk janë përcaktuar shkeljet e konstatuara të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, në nenin 48 “Menaxhimi i burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermal” dhe klasifikohen si kundërvajtje administrative që në mbështetje e nenit 97, Pika7, parashikohet dënim administrativ, Gjore: nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë c’ka ngarkon me përgjegjësi Inspektorët A.C dhe A.S.

Për sa më lart Drejtoria e Inspektimit Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar rinovimin e lejes. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë.

**“K.A.A” NIPT: L4.....1A A**

Autorizim Inspektimi me nr. AKM-DQ-2022-000234 - 1 Datë : 30/05/2022; Proces –verbali i inspektimit datë 08.06.2022; Inspektorët A.T, B.B.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kërkesave ligjore të përdorimit të burimeve ujore.; Adresa e Objekti: Njësia Administrative Vau-Dejës Bashkia Vau-Dejës.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar:

Referuar listës së verifikimit për burimet natyrore ujore, pika 9, Subjekti ka bërë aplikimin më datë 25.10.2021, pranë Baseni Drin-Bunë, për rinovimin e lejes së përdorim ujqor.

-Leje përdorimi i Burimit Ujqor me nr. 179/6, datë 20.04.2017 (Miratuar me Vendimin të Këshillit Basenit Ujqor Drin-Bunë me nr. 6, datë 10.04.2017) për subjektin “K.A.A”, periudha e vlefshmërisë është 5 vjet (deri më 09.04.2022)

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000234 - 5 Datë : 08/06/2022 është përcaktuar: 1. Dënim administrativ kryesor: *Nuk ka*; 2. Dënim administrativ plotësues: *Nuk ka*. 3. Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive: *Nuk ka*.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Për sa më lart nga grupi i inspektimit nuk janë përcaktuar shkeljet e konstatuara të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, në nenin 48 “Menaxhimi i burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermal” dhe klasifikohen si kundërvajtje administrative që në mbështetje e nenit 97, Pika7, parashikohet dënim administrativ, Gjore: nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë c’ka ngarkon me përgjegjësi Inspektorët A.T, B.B.

Për sa më lart Drejtoria e Inspektimit Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar rinovimin e lejes. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë.  
**“N” NIPT: J9.....5J A**

Autorizim Inspektimi me nr. AKM-DQ-2022-000236 - 1 Datë : 30/05/2022; Proces –verbali i inspektimit datë 10.06.2022; Inspektorët A.T, B.B.

Objekti i inspektimit: Zbatimi i kërkesave ligjore të përdorimit të burimeve ujore.; Adresa e Objekti: Njësia Administrative Vau-Dejës rruga: Sarajet e Hotit, Bashkia Vau-Dejës.

Në momentin e inspektimit janë konstatuar:

Referuar listës së verifikimit për burimet natyrore ujore, pika 9, Subjekti ka bërë aplikimin më datë 10.04.2022, pranë Baseni Drin-Bunë, për rinovimin e lejes së përdorim uxor.

-Leje përdorimi i Burimit Uxor me nr. 179/4, datë 20.04.2017 (Miratuar me Vendimin të Këshillit Basenit Uxor Drin-Bunë me nr. 4, datë 10.04.2017) për subjektin “N”, periudha e vlefshmërisë është 5 vjet (deri më 09.04.2022).

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000236 - 5 Datë : 10/06/2022 është përcaktuar: 1. Dënim administrativ kryesor: *Nuk ka*; 2. Dënim administrativ plotësues: *Nuk ka*. 3. Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive: *Nuk ka*.

Për sa më lart nga grupi i inspektimit nuk janë përcaktuar shkeljet e konstatuara të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, në nenin 48 “Menaxhimi i burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermal” dhe klasifikohen si kundërvajtje administrative që në mbështetje e nenit 97, Pika7, parashikohet dënim administrativ, Gjore:nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë c’ka ngarkon me përgjegjësi Inspektorët A.T, B.B.

Për sa më lart Drejtoria e Inspektimit Kontrollit nuk ka planifikuar ri - inspektim në terren për të kontrolluar rinovimin e lejes. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë.

*Për sa më lart më hollësisht është mbajtur Projektraporti i auditimit nisur me nr. 562/7, datë 22.11.2023, për të cilin në fazën e hartimit të Raportit të auditimit, janë paraqitur observacione me shkresën nr. 9757/1, datë 22.12.2023, marrës KLSH, me nr. 562/15, datë 22.12.2023 nga E.K. A.C, A.T, A.S.*

**- Në lidhje me pretendimi se:** Në inspektimin e Subjektit; “E” në terren respektohen fushat e liste verifikimeve perkatese ne rsatin konkret Listë-Verifikimit të Burimeve Natyrore-Ujërave.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë për pjesën e shkeljeve të konstatuar është përshkruar hollësisht në pjesën e projektraportit.

**- Në lidhje me pretendimi se:** në inspektimet e subjekteve “B.B”, “D.T”, “G.J.L” subjektet kanë aplikuar për leje dhe nuk është përgjegjësia e tyre për mos pajisjen nga autoritetet.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë për pjesën e shkeljeve të konstatuar është përshkruar hollësisht në pjesën e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Në kryerjen e dokumentimin on-line të inspektimeve ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative.
<b>Situata:</b>	<b>Në 1 rast</b> - Proces –verbali i inspektimit datë 08.06.2021 në subjektin “E” shpk NIPT: K3.....2W. Grupi i inspektimit në dokumentacionin e inspektuar nuk



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	<p>ka paraqitur “Kontratë evadimi mbetje jo të rrezikshme” me subjekt të pajisur me Licencë III. 2. B, si dhe nuk referohen apo paraqiten Regjistrat për menaxhimin e mbetjeve. Duke mos vepruar me Masat Administrative të përcaktuara në ligjin nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar neni 62 “Kundërvajtjet dhe sanksionet. Pikat 9, 10 dhe 57, në vendosjen e gjobës nga 300,000 mijë lekë në 1,000,000 lekë, si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).</p> <p><b>Në 5 raste</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Proces–verbali i inspektimit datë 08.11.2022 në subjektin <b>B.B</b></li><li>- Proces–verbali i inspektimit datë 09.11.2022 në subjektin <b>D.T</b></li><li>- Proces–verbali i inspektimit datë 11.11.2022 në subjektin <b>G.J.L</b></li><li>- Proces–verbali i inspektimit datë 08.06.2022 në subjektin <b>K.A.A</b></li><li>- Proces –verbali i inspektimit datë 10.06.2022 në subjektin <b>N</b></li></ul> <p>Në proces verbalet e inspektimit nuk është cilësuar mbarimi i afatit të lejes së përdorimit të basenit ujqor por vetëm aplikimi për rinovim të lejes, dhe nuk theksohet që hyrja në fuqi e lejes së përdorimit bëhet “Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve”.</p> <p>Për sa më lart nga grupet e inspektimit nuk janë përcaktuar shkeljet e konstatuara të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, në nenin 48 “Menaxhimi i burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermal” dhe klasifikohen si kundërvajtje administrative që në mbështetje e nenit 97, Pika 7, parashikohet dënim administrativ, Gjore: nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, ligjin nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar, VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).</p> <p>Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr.13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Mos aplikimi i dënimeve administrative në rastin e konstatimit të shkeljeve mjedisore si dhe mos kryerja e inspektimeve në subjektet problematike dhe me risk në ndotjen e mjedisit ndikon në mos parandalimin e ndotjes së mjedisit nga subjektet zhvillues e të pajisur me leje mjedisore.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mos zbatimi i legjislacionit Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E lartë</p>
<b>Rekomandime:</b>	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektimit Kontrollit të marrë masa të planifikojë Inspektime për verifikim e konstatimeve dhe detyrave të lëna nga inspektimet në subjektet e inspektuara si dhe në subjektet: B.B, D.T, G.J.L, K.A.A dhe N, për verifikimin e pajisjes me leje përdorimi të basenit ujqor dhe aplikimin e kundërvajtjes administrative “gjobe”.</p>



### ***Analizat e kryera nga laboratorit***

Për periudhën objekt auditimi u shqyrtuan rezultatet e analizimit të testeve sipas dokumentacionit administruar në AKM dhe inspektimet e kryera regjistruar në site e-investimet në lidhje me subjektet e testuar. Nga auditimi i rezultateve të testimit laboratorik kërkuar nga Drejtoritë Rajonale ose nga Institucione të tjera dhe kryerja e Inspektimeve në këto subjekte pas rezultatit të testimit për periudhën objekt auditimi u konstatua se:

1. Fabrika e Përpunimit të peshkut “P” J68319506G, Shëngjin, Lezhë. Kërkesa e ardhur nga Komisariati Lezhë. Matjet e bëra në datë 28/05/2020.

Raport Analizë Nr. 4 – Gjendje e keqe.

Raport Analizë Nr. 5 – Gjendje e keqe.

Raport Analizë Nr. 6 – Lënda Pezull, NKO, NBO5 dhe produktet e naftës mbi normë .P-Total brenda normës.

Raport Analizë Nr. 7 – Lënda Pezull, NKO, NBO5 dhe produktet e naftës mbi normë. P-Total brenda normës.

*Inspektuar më 28.09.2020 dhe marre mase administrative me vlere 300,000 Lekë, Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK dhe nuk ka nuk ka sqarim shkresor për indicjen e inspektimit.*

2. Landfilli Bushat, Lezhë, Kërkesa e ardhur nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë-Shkodër – Kukës. Matjet e bëra me date 30.09.2020.

Raport Analizë Nr. 20, 21 kampionet e dorëzuara nuk janë transportuar në përputhje me Standardi ISO 5667-3:2018.

Pjesa 3: Konservimi dhe transporti i mostrave të ujit.

*Nuk ka kërkesë për ri testim a ri marrje mostrash.*

3. Terraston –Berat, L93401001F Berat, Kuçovë. Kërkesa e ardhur Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit . Matjet e bëra në datë 17.12.2020

Raport Analizë Nr. 30 – Parametrat e monitoruar janë mbi normë konduktiviteti dhe lënda Pezull parametrat e tjerë janë në vlera të ulëta ose në kufirin e limitit të deduktimit..

*Inspektuar datë 07.12.2021 dhe marre mase administrative me vlere 300000 Lekë. Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK dhe nuk ka nuk ka sqarim shkresor për indicjen e inspektimit.*

4. L.F, Fushë Arrëz Pukë. Kërkesë e ardhur nga Prokuroria, Pukë. Matjet e bëra në datë 16.09.2020.

Raport Analizë Nr. 16 – Përmbajtje e larte është vlerësuar për praninë e nitrateve duke e klasifikuar në klasën e V-Gjendje e keqe.

Gjithashtu është vlerësuar mbi normë nevoja biokimike për oksigjen, dhe prani e lëndëve pezull.

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

5. TH.A, Korçë K1412800IJ, Korçë, Kërkesë e ardhur nga AKM. Matjet e bëra në datë 01.12.2020 Raport Analizë Nr..27 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin pritës shkakton një ndotje të lartë duke kapërcyer disa herë vlerat limite të lejuara.

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

6. SH.B K33724014P, Drenovë, Korçë. Kërkesë e ardhur nga AKM. Matjet e bëra në datë 26.01.2021.

Raport Analizë Nr. 07 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin pritës shkakton një ndotje të lartë duke kapërcyer disa herë vlerat limite të lejuara

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

7. E.B, Mollaj L13710005O Mollaj, Korçë. Kërkesë e ardhur nga AKM. Matur me datë 26.01.2021.

Raport Analizë Nr. 06 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin pritës shkakton një ndotje të lartë duke kapërcyer disa herë vlerat limite të lejuara.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

- Inspektuar nga Inspektorati mjedisit datë 02.07.2019 rezultuar pa masë  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*
8. M.A, Vau Dejës, K36924001T, Vau Dejës, Shkodër. Kërkesë e ardhur nga AKM. Matjet e bëra datë 25.02.2021  
Raport Analizë Nr. 14 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin pritës shkakton një ndotje të lartë duke kapërcyer disa herë vlerat limite të lejuara  
Inspektuar nga Inspektorati mjedisit datë 12.08.2020 rezultuar pa mase  
Inspektuar nga Inspektorati mjedisit datë 25.07.2023 rezultuar pa mase  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi nga sektori i Inspektimit të Burimeve (Ujërave).*
9. M, Kavajë, J62903838K, Kavajë Kërkesë e ardhur nga AKM. Matur në datë 25.05.2021  
Raport Analizë Nr. 24 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin pritës shkakton një ndotje të lartë duke kapërcyer disa herë vlerat limite të lejuara  
Inspektuar nga (ISHMPUT TR), datë 20.03.2019 Paralajmërim për fillim e procedurës për pajisje me leje mjedisi.  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*
10. K.M, Kavaë, L52616801N, Kavajë. Kërkesë ardhur nga AKM. Matur në datë 25.05.2021.  
Raport Analizë Nr..25 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin pritës shkakton një ndotje të lartë duke kapërcyer disa herë vlerat limite të lejuara  
Inspektuar ISHMPUT FR, ne date, 29/10/2019, Pa mase  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*
11. C-C, Tiranë, Tiranë. Kërkesë ardhur nga AKM. Matur në datë 02.06.2021.  
Raport Analizë Nr. 29 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin pritës shkakton një ndotje të lartë duke kapërcyer disa herë vlerat limite të lejuara.  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*
12. V, Uznovë, Berat. Kërkesë ardhur nga AKM. Matur në datë 14.06.2021  
Raport Analizë Nr..32 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin pritës shkakton një ndotje të lartë duke kapërcyer disa herë vlerat limite të lejuara  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*
13. DH.D, Polican. Kërkesë ardhur nga AKM. Matur në datë 14.06.2021.  
Raport Analizë Nr..31 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin pritës shkakton një ndotje të lartë duke kapërcyer disa herë vlerat limite të lejuara  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*
14. C.G, K36308474S, Bulqizë. Kërkesë ardhur nga AKM. Matur në datë 13.07.2021.  
Raport Analizë Nr..39 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin ka impakt negative pasi disa prej parametrave janë përtej normës së lejuar.  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*
15. G , J81503013L, Bulqizë. Kërkesë ardhur nga AKM. Matur në datë 13.07.2021  
Raport Analizë Nr. 37,38 shkarkimi i ujërave teknologjikë të subjektit në mjedisin ka impakt negative pasi disa prej parametrave janë përtej normës së lejuar.  
Inspektuar ISHMPUT DR, datë 01/10/2019 rezultuar Pa mase.  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*
16. K.M, Fshati Babunje, Divjake. Kërkesë ardhur nga Komisariati i Policisë, Divjake.  
Matur në datë 07.01.2022.  
Raport Analiza Nr. Serial 01 – Ne analizën e kryer vlerësohet prani e larte e lendeve organike duke i klasifikuar ujerat ne cilësi te keqe për parametrat e analizuar.  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*
17. R.K, Lushnje. Kërkesë ardhur nga Komisariati i Policisë Lushnje. Matur në datë 25.03.2022.



Raport analize Nr. 05 – vlerësohet përmbajtje e larte e lendeve organike duke i klasifikuar ujerat ne cilësi eutrofike për parametrat e analizuar.

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

18. Ujë deti – dy kampione, Shëngjin. Kërkesë ardhur nga ARM Lezhe. Matur në datë 22.05.2022.

Raport analize Nr. 08 – është vlerësuar prani e larte e lendeve pezull, te gjithë parametrat e tjerë brenda normës duke vlerësuar se nuk ka ndotje.

19. A.M, Shkodër. Kërkesë ardhur nga AKM. Matur në datë 09.06.2022

Raport analize Nr. 14 – është vlerësuar se shkarkimet teknologjike te subjektit shkaktojnë ndotje te larte ne mjediset pritëse duke kapërcyer disa here normat e lejuara.

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

20. Kanali pranë Lungomares, Vlorë. Task – Forca për sezonin turistik 2022. Matur në datë 27.07.2022

Raport analize Nr. 32 – ndotje e larte organike ne mjedisin pritës si pasoje e shkarkimeve urbane  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

21. Kanali pranë Shkollës së Marinës, Vlorë. Task – Forca për sezonin turistik 2022. Matur në datë 27.07.2022.

Raport analize Nr. 33 - ndotje e larte organike ne mjedisin pritës si pasoje e shkarkimeve urbane  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

22. Hidrovori, Vlore. Task – Forca për sezonin turistik 2022. Matur në datë 27.07.2022.

Raport analize Nr. 34 - ndotje e larte organike ne mjedisin pritës si pasoje e shkarkimeve urbane.  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

23. Kanal pranë Hotel Koral, Radhimë, Vlorë. Task – Forca për sezonin turistik 2022. Matur në datë 27.07.2022

Raport analize Nr. 35 - ndotje e larte organike ne mjedisin pritës si pasoje e shkarkimeve urbane  
*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

24. Kanali pranë Lungomares, Vlorë. Task – Forca për sezonin turistik 2022. Matur në datë 20.08.2022.

Raport analize Nr. 43 – ndotje e larte organike, amonjakut dhe fosforit duke u klasifikuar ne cilësi te keqe.

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

25. Kanali qe derdhet pranë Portit te Vjetër, Vlorë. Task – Forca për sezonin turistik 2022. Matur në datë 20.08.2022

Raport analize Nr. 44 – ndotje e larte organike, amoniakut dhe fosforit duke u klasifikuar ne cilësi te keqe – Klasa V

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

26. Kanali qe derdhet pranë Shëtitores, Sarandë. Task – Forca për sezonin turistik 2022. Matur në datë 20.08.2022.

Raport analize Nr. 45 – ndotje e larte organike, amoniakut dhe fosforit duke u klasifikuar ne cilesi te keqe – Klasa V

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

27. Hidrovor, Tale Lezhë. Task – Forca për sezonin turistik 2022. Matur në datë 23.08.2022

Raport analize Nr. 46 – ndotje e larte organike duke i klasifikuar ujerat ne cilësi jo te mire.

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

28. Hidrovori, Balldren, Lezhë. Task – Forca për sezonin turistik 2022. Matur në datë 02.09.2022.

Raport analize Nr.47 – ndotje e larte organike dhe përmbajtje amoniaku duke I klasifikuar ujerat ne cilësi te keqe me një impakt te larte te shkarkimeve organike.

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

29. NETTUNNO, Allprenaj, Lushnjë. Kërkesë ardhur nga ARM Fier. Matur në datë 20.09.2022.





Raport analize nr.49 – ndotje e larte organike ne terrenin pritës duke patur impakt negativ nga shkarkimi i ujerave teknologjike.

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

30. R, M02108011F, Laprakë, Tiranë. Matur në datë 30.09.2022.

Raport analize Nr. 50 – operatori shkakton ndotje te larte ne mjedis nga ujerat teknologjik qe shkarkon.

*Inspektuar nga AKM sipas DQ – 2022- 000554 -1, date, 29.09.2022 me mase 300 000 dhe pezullim aktiviteti*

31. SH.B, L64624001K, Korçë. Kërkesë ardhur nga ARM Berat, Elbasan, Korçë. Matur në datë 21.10.2022

Raport analize Nr. 57 – NKO dhe NBO5 si dhe lendet pezull janë vlerësuar mbi normën e lejuar, yndyrat dhe fosfori total janë nën normë.

Inspektuar nga ISHMPUT Korçë, datë 25/03/2019

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

32. A.O, K33724019J, Bilisht, Korçë. Kërkesë ardhur nga ARM Berat, Elbasan, Korçë. Matur në datë 21.10.2022

Raport analize Nr.58 – NKO dhe NBO5, lendet pezull dhe fosfori total janë vlerësuar mbi normën e lejuar, është vlerësuar prani e yndyrave por brenda normës.

Inspektuar pa mase në datë 26.10.2021

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

33. Kanali Shën e Premte, Divjakë. Kërkesë ardhur nga ARM Fier. Matur në datë 01.11.2022 Raport analize Nr. 67 – vlerësohet prani e larte e lendeve organike duke I klasifikuar ujerat ne cilësi te keqe për parametrat e analizuar.

*Nuk ka dokumentacion për informimin e DIK për indicjen inspektimi.*

Nga 33 analiza të kryera nga laboratorit i analizimit të mostrave, për periudhën objekt auditimi nga të cilat: 5 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga institucionet e tjera (Polici, Prokurori), 19 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga AKM apo Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, si dhe 9 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga Taks-Forcë për sezonin turistik 2022.

Nuk ka një bazë të dhënash për historikun e rezultateve të analizimit për subjektet në të cilët janë marrë mostrat.

Në asnjë rast nuk ka informim për Drejtorinë e Inspektimit e Kontrollit mbi rezultatet e analizimit si për ato që kanë rezultuar me shkelje të normave të lejuara për mjedisin edhe për ato që kanë rezultuar brenda normave të lejuara.

Inspektimet e kryera në këto subjekte janë sipas planifikimit të DIK, dhe në asnjë rast nuk kanë lidhje me rezultatet e analizimit të mostrave të ardhura në laborator apo të marra nga vetë specialistët e laboratorit.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448 “Për Lejet e Mjedisit”, date 7/14/2011 i ndryshuar; ligjin nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar; ligjin nr.10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar; Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ngarkohen me përgjegjësi E.K Drejtor, A.D Drejtor, dhe N.P Drejtor i drejtorisë së Kërkimit dhe Dijes Mjedisore.

*Për sa më lart më hollësisht është mbajtur Projektraporti i Auditimit nisur me nr. 562/7, datë 22.11.2023, për të cilin në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë paraqitur observacione në rrugë elektronike dhe me shkresën nr. 9757/1, datë 22.12.2023, marrës KLSH, me nr. 562/15, datë 22.12.2023; nga nëpunësit: A.D, E.K. N.P.*

**- Në lidhje me pretendimi se:** Ne baze te rezultateve te testeve te dala nga mostrimi ne vend ne disa pika te caktuara mostra te marra nga specialistet e AKM –se , subjektet kane qene pjese e inspektiveve të bëra nga DIK sipas planeve te miratuara apo ex officio ne rastet qe ka pasur ankesa apo kërkesa nga institucione te tjera ligj zbatuese.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë për pjesën e shkeljeve të konstatuar është përshkruar hollësisht në pjesën e projektraportit.

**- Në lidhje me pretendimi se:** Raport analizat dhe informacioni i dërgohen institucionit që kërkon mbështetje teknike për kampionim dhe analizim. Të gjitha gjetjet dhe problematikat janë dërguar me shkresë për Dijeni Titullarit të Institucionit. Grupit Ndërinstitucional të Punës, Task-Forcë Drejtoria e Inspektim Kontrollit është pjesë e grupeve të punës dhe në zbatim të urdhrat AKM nuk ka pasur detyrim për raportim në DIK.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë për pjesën e shkeljeve të konstatuar është përshkruar hollësisht në pjesën e projektraportit.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Nuk ka inspektime të kryera me indicje nga rezultatet negative laboratorike për mostrat e marra në instalimet e subjekteve që ndotin mjedisin.
<b>Situata:</b>	<p>Nga 33 analiza të kryera nga laboratorit i analizimit të mostrave, për periudhën objekt auditimi nga të cilat: 5 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga institucionet e tjera (Polici, Prokurori), 19 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga AKM apo Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, si dhe 9 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga Taks-Forcë për sezonin turistik 2022.</p> <p>Nuk ka një bazë të dhënash për historikun e rezultateve të analizimit për subjektet në të cilët janë marrë mostrat.</p> <p>Në asnjë rast nuk ka informim për Drejtorinë e Inspektimit e Kontrollit mbi rezultatet e analizimit si për ato që kanë rezultuar me shkelje të normave të lejuara për mjedisin edhe për ato që kanë rezultuar brenda normave të lejuara.</p> <p>Inspektimet e kryera në këto subjekte janë sipas planifikimit të DIK, dhe në asnjë rast nuk kanë lidhje me rezultatet e analizimit të mostrave të ardhura në laborator apo të marra nga vetë specialistët e laboratorit.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10448 “Për Lejet e Mjedisit”, datë 7/14/2011 i ndryshuar; ligjin nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar; ligjin nr.10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar; Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nga mos koordinimi dhe shkëmbimi i informacioneve mbi ndotësit e mjedisit midis Drejtorive në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, nuk janë marrë masat për ndëshkimin e ndotësve mjedisore.
<b>Shkaku:</b>	Mos mbajtja e një baze të dhënash mbi rezultatet e analizimit të mostrave nga Laboratori i AKM si dhe mos koordinimi dhe shkëmbimi i informacioneve mbi ndotësit e mjedisit midis Drejtorive në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të marrë masa:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Të përcaktojë mënyrën shkresore për shkëmbim informacionesh midis drejtorive të AKM. Informacione këto për të përcaktuar riskun e inspektimeve dhe marrjen e masave për ndotësit e mjedisit.</li><li>-Të hartojë një bazë të dhënash të aksesueshëm mbi historikun e rezultateve të analizimit për subjektet në të cilët merren mostrat për analizim nga Drejtoria e Regjistrave Mjedisore e Inovacionit dhe Analizave Laboratorike.</li></ul>

<b>Titulli i Gjetjes</b>	Nuk është mbuluar gjithë vitit me planifikim të inspektimeve si dhe nuk ka dokumentacion mbi vlerësimin e riskut në planifikim.
--------------------------	---



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë paraqitur planë mujore inspektimi nga <b>Spektori i Inspektimit të Mjedisit</b>:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Për periudhën Gusht-Dhjetor 2020, vetëm për muajin Shtator.</li><li>- Për periudhën Janar – Dhjetor 2021 vetëm për 8 muaj, vetëm për Muajt Janar-Shkurt, Maj –Qershor, dhe Gusht - Nëntor.</li><li>- Për periudhën Janar – Dhjetor 2022, për 11 muaj, Shkurt – Dhjetor.</li></ul> <p><b>Nga Spektori i Inspektimit të Ujërave</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Për periudhën Gusht-Dhjetor 2020, vetëm për 2 Muajt Gusht dhe Shtator.</li><li>- Për periudhën Janar – Dhjetor 2021, vetëm për 4 Muajt Qershor –Korrik dhe Nëntor - Dhjetor.</li><li>- Për periudhën Janar – Dhjetor 2022, vetëm për 5 Muajt Qershor, Korrik, Gusht, Shtator dhe Nëntor.</li></ul> <p>Në asnjë rast nuk ka analizë risku, në përzgjedhjen e veprimtarive apo subjekteve për inspektim dhe në asnjë rast nuk ka planifikim të kontroleve për rekomandimet e lëna për përmirësimin e situatës mjedisore në rastet e konstatimit të shkeljeve.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit”.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos kryerja e inspektimeve në subjektet problematike dhe me risk në ndotjen e mjedisit duke mos parandaluar ndotjen e mjedisit nga subjektet zhvillues e të pajisur me leje mjedisore.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i legjislacionit Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektim Kontrollit të marrë masa: <ul style="list-style-type: none"><li>- Në planet vjetore të planifikoje edhe inspektimet për verifikimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e situatës mjedisore në rastet e konstatimit të shkeljeve.</li><li>- Në bazë të vlerësimit të riskut dhe përcaktimit të subjektet me risk të lartë me ndikim në mjedis. të hartojë Planin Strategjik të Inspektimeve dhe në përputhje e zbatim të tij të hartojë e të miratojë Planet Vjetore e Mujore të Inspektimeve.</li></ul>

**2.6. Analizimi i apelimeve, marrja e vendimeve, aplikimi dhe ndjekja e sanksioneve të vendosura.**

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i Apelimeve sipas bazës së të dhënave administruar në AKM
- Dosjet e Vendimeve të Apelimeve

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar mbi analizimin e apelimeve, marrja e vendimeve, aplikimi dhe ndjekja e sanksioneve të vendosura. konstatohet që:*

*Spektori Ankimimeve, Apelim, Ekzekutim, Trajtim i Penaliteteve operon pranë Agjencisë Kombëtare e Mjedisit që prej korrikut të vitit 2020, sektori është krijuar dhe funksionon në*



mbështetje të VKM-së Nr. 568, datë 17.7.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” e ndryshuar me VKM- në Nr. 186, datë 25.03.2021. Sektori i Ankimime përbëhet nga pesë nëpunës civil (përgjegjësi i sektorit dhe katër inspektor), të cilët asistojnë. Gjatë viteve 2020-2021 nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve janë shqyrtuar 46 ankime administrative. Ndërkohë, për vitin 2022 Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve ka administruar 18 ankime administrative.

***-Për vitin 2020 janë përzgjedhur 2 dosje për shqyrtim***

**ANKUESI:** Subjekti “K.I” me Nr. AKM-FR-2020-00007-5 datë, 25.09.2020 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë i është vendosur masë administrative gjobë 2.000.000 lekë.

**OBJEKTI:** Kundërshtim I Procesverbalit të Inspektimit Nr. AKM-FR-2020-00007-2 datë 05.09.2020 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë komunikuar ankuesit me anë të shkresës Nr.1362 prot, datë 08.09.2020.

Inspektoret Shtetëror të autorizuar për të kryer inspektimin. znj. M.H, z.A.XH, z.I.M.

- Inspektoret e AKM-se konstatojnë se nga subjekti “K.I” sha ka shkelje të nenit 39 të Ligjit Nr. 110/2012 datë 15.11.2020 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (i ndryshuar). Për këtë gjë në piken 7 jepet komenti me këtë përmbajtje: *“Nga vëzhgimi me sy të lire si dhe veprimet e tjera procedurale rezultoi se subjekti nuk respekton urdhërimet e ligjit dhe posaçërisht rrjedhjen minimale ekologjike. Për këtë qëllim ju kërkua skema grafike e marrjes së ujit nga burimi si dhe pika e shkarkimit të rrjedhës minimale ekologjike. Ky dokumentacion do të na ndihmonte ndër të tjera për të dale në një vendim sa më të drejtë”*.

Masa administrative është vendosur si rezultat I gjetjeve të pasqyruara në procesverbalin e inspektimit Nr. AKM-FR-2020-00007-2 datë 05.09.2020, në të cilën shprehet se nga inspektimi konstatohet se subjekti “ K.I” ka shkelje të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore”. Vërehet se në procesverbalin e inspektimit inspektorët cilësojnë se nga sa është parë me sy të lirë, nuk është respektuar rrjedha minimale ekologjike.

- Subjekti K.I Sha me shkresën Nr 1123 prot, datë 29.10.2020 ka kërkuar ti shfuqizohet vendimi përfundimtar i inspektimit ,shkresën e ka paraqitur pranë AKM-së, ku ka kundërshtuar procesverbalin e inspektimit Nr. Nr. AKM-FR-2020-00007-5 datë, 25.09.2020 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë me anë të shkresës Nr. 1362 Prot, datë 30.09.2020.

Komisioni i AKM-së pasi ka shqyrtuar ankimimin administrativ referuar analizave dhe fakteve të pretenduara ka vendosur të shfuqizojë masën administrative të marrë, ne mbështetje të pikës 4 nenit 137, Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i AKM-së konstaton se rrjedha minimale ekologjike nuk mund të konstatohet me sy të lirë, por me matje specifike nga ekspert të fushës, vetëm kur janë përpara faktit që nuk ka fare rrjedh uji mund të bëhet konstatimi me sy të lirë dhe në këtë rast fakti konstatohet me foto, pas këtij konstatimi komisioni ka vendosur të shfuqizojë masën administrative gjobë 2,000,000 lekë. *Nga ana e AKM nuk është sugjeruar inspektim specifik me mjete matëse të pretendimit të inspektorëve nga konstatimi me sy të lirë të rrjedhjes minimale ekologjike.*

Komisioni: E.K, D.S, E.M, M.P, A.K.

**ANKUESI:** Subjekti “A.K” me Nr. AKM-TR-2020-000087-1 datë 12.11.2020 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit i është vendosur masë administrative me vlerë 300.000 lekë. Subjekti është gjobitur ne shkelje “Për Lejet e Mjedisit”: Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve te lejes përkatës te mjedisit ti tipave A, ose B nga operatori një instalimi.

**OBJEKTI:** Shfuqizim i aktit administrativ “Vendimit Përfundimtar të Inspektimit AKM-TR-2020-000087-2. datë 02.09.2021 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tirane ,Durrës, Dibër i marrë



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

në bazë të procesverbalit të Inspektimit të AKM-TR-2020-000087-2. Inspektoret Shtetëror të autorizuar për të kryer inspektimin: -z. B.C, z. J.ZH dhe z. A.K.

-Dënim administrativ plotësues: Pezullim i pjesshëm i subjektit. Pezullim i kaldajës deri në marrjen e masave për eliminimin e emërtimeve të dukshëm, gazrat dhe aromave të pakëndshme në ajër.

- Duke ju referuar ankimi të subjektit me Nr. 20113 prot, datë 07.12.2020, protokolluar pranë AKM-së me Nr. 6058/1 prot, datë 24.12.2020, është kërkuar shfuqizimi i Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. AK-TR-2020-000087-5, datë 01.12.2020 të vendosur nga inspektorët e Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tirane, Durrës, Dibër për shkelje të nenit 29 pika 1/b,ii të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar. Vendimi është marrë në bazë të gjetjeve të reflektuara në Procesverbalin e Inspektimit Nr. AK-TR-2020-000087-5 datë 12.11.2020 për mosrespektimin e kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse, pasi rezultoi se kaldaja emeton tymra të dukshëm, gazra dhe aroma të pakëndshme në ajër.

Komisioni konstaton se subjekti ka dorëzuar monitorimet 6-mujore dhe vjetore pranë AKM-së. Referuar raporteve të monitorimeve (raporte që u janë vënë në dispozicion edhe inspektorëve gjatë inspektimit, sikurse përmendet në procesverbalin e inspektimit Nr. AK-TR-2020-000087-2 datë 12.11.2020, konkretisht në rubrikën Dokumentet e mia përmenden, Leja e Mjedisit, Raport Vetmonitorimi 6-mujor, Raport Vjetor I monitorimit, pagesa e Tarifës Vjetore (89 flete gjithsej), rezulton se shkarkimet e gazta janë brenda normave të lejuara.

Subjekti “A.K” akuzon inspektorët shtetëror për shkelje të rregullave dhe papërgjegjshmëri gjatë inspektimit.

Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsytimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vendosi: Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë.

*Komisioni. Nga ana e AKM nuk është sugjeruar inspektim specifik me mjete matëse të pretendimit të inspektorëve nga konstatimi.*

Komisioni: E.K, D.S, E.M, M.P, A.K.

***Për vitin 2021 janë përzgjedhur 4 dosje për shqyrtim***

**ANKUESI:** Shoqëria “R” sh.p.k e regjistruar pranë QKB-së, me numër NIPT-t J8.....7E.

**OBJEKTI:** Shfuqizim i aktit administrativ “Vendimit Përfundimtar të Inspektimit AKM-TR-2021-000082-5. datë 16.08.2021 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, i marrë në bazë të procesverbalit të Inspektimit të AKM-TR-2021-000082-5.

-Inspektoret shtetëror të autorizuar: z. B.C dhe z. I.A.

Subjekti R Shpk me NIPT J8.....7E, leja e mjedisit me PN-9530-03-2015 (nuk është e ngarkuar në QKB) me Vendim Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-TR-2021-000082-5, Datë 16.08.2021, ka marrë masë administrative gjobe në vlerën 1.500.000 lekë për shkelje të kërkesave ligjore të nenit 62, pika 7 te Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2021 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, sipas të cilit:

*“Çdo person , që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme, që nuk është në përputhje me dokumentin e transferimit të mbetjes, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji ,dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ”.*

-Sipas pikës 22 të Listë Verifikimit në lidhje me kushtin 8, “Menaxhim i Mbetjeve” subjekti : “ nuk vuri në dispozicion dokumentacion e transferimit të mbetjeve, kontratat me operator të specializuar, nuk ka përcaktuar me qartësi në tabelën 8.1.2 emërimin në kode të mbetjeve që gjeneron”.

Me shkresën Nr.4297 Prot, datë 13.09.2021 ka paraqitur ankim administrativ kundër Vendimit Përfundimtar në të cilin subjekti sqaron se duke qenë se hartimi i dokumenteve të transferimit të



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

mbetjeve nuk bëhet nga vetë subjekti por nga operatori “F2006” me të cilin kanë lidhur kontratë për largimin e mbetjeve që gjenerohen (kontrata është bashkëlidhur ankimit) dhe nga inspektorët nuk është lexuar si duhet formulari i transferimit ( gjithashtu i bashkëngjitur).Gjatë hetimit administrativ përfaqësuesi i subjektit me Autorizim Nr. 316/1 prot, datë 01.11.2021 znj D.K ka depozituar dhe Regjistrin për Menaxhimin e Mbetjeve 2021 (i administruar në subjekt).Nga verifikimet me Sektorin e Monitorimit pranë AKM-së, sqarohet se subjekti duke qenë se nuk është i pajisur me Kod Unik nuk ka dorëzuar pranë kësaj drejtorie regjistrat e transferimit të mbetjeve. Nga kontrolli i regjistrave të dorëzuara nga subjektet e pajisur me këtë kod unik për të kryer transferimin e mbetjeve, nuk rezulton që të ketë deklaruar kompani se ka transferuar mbetjet e këtij subjekti për periudhën 1-15 maj 2021.

Sa më sipër përgjegjësia për të raportuar për regjistrat e transferimit të mbetjeve i takon subjektit “F2006” me të cilin subjekti R shpk ka lidhur kontratë,si subjekt i pajisur me kodin unik.

Për arsyet e përmendura më sipër, subjekti përfundimisht kërkon shfuqizimin e Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-TR-2021-000082-5, datë 16.08.2021.

Referuar Procesverbalit të Inspektimit, bashkëlidhur shpjegimet, janë dorëzuar dokumentet e mëposhtme:

- Kontratën e mbetjeve dhe pastrimit të gropës septike me operatorin “F 2006” shpk
- Formularët e transfertave të mbetjeve
- Faturën e pastrimit të gropës septike

Komisioni pasi shqyrtoj ankimimin administrativ të subjektit referuar fakteve të përmendura, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendosi: Shfuqizimin e gjobës masë administrative 1.5000.000 lekë.

Komisioni: E.K, D.S, E.M, M.P, A.K.

**ANKUESI:** Subjekti “A.G.O” sha me Nr. AKM-FR-2021-000129-5 datë 02.09.2021 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër i është vendosur masë administrative me vlerë 1,000,000 lekë. Subjekti është gjobitur për Kundërvajtjet Administrative për: Mos përmbushje dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A,B nga operatori i një instalimi si dhe për lejet e mjedisit të tipit A.

**OBJEKTI:** Shfuqizim i aktit administrativ “Vendimit Përfundimtar të Inspektimit AKM-FR-2021-000129-5. datë 02.09.2021 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, i marrë në bazë të procesverbalit të Inspektimit të AKM-FR-2021-000129-2.

-Inspektoret Shtetëror te autorizuar për te kryer inspektimin z. D.V dhe z. A.H.

- Masa administrative është vendosur për mosrespektimin e kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore konkretisht nga gjetjet e reflektuara në Listë Verifikim.

Subjekti nuk ka marrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e pikës 1.5.10 ku citohet: të sigurohet që sipërfaqet ku janë instaluar depozitat të jenë të papërshkrueshme dhe rezistent ndaj materialit të ruajtur brenda tyre; dhe pikës 1.015.22 ku citohet të jenë marrë të gjitha masat që argjinatura e depozitave të jetë brenda kushteve dhe standardeve teknike.

Argjinatura rrethuese ishte e hapur në një anë të sajë.

Gjatë inspektimit në terren u evidentuan gjurmë hidrokarbure në tokë në vendndodhjen e instalimit.

- Me shkresën Nr .4590 Prot, datë 30.09.2021 subjekti ka paraqitur ankim ndaj Vendimit Përfundimtar të Inspektimit me pretendimin se:

I gjithë aktiviteti ka qenë ekzistues dhe mbas transferimit të tij tek subjekti “A.G.O” sha, ky i fundit ka realizuar një plan përmirësimi dhe në këtë plan nuk është përfshirë asnjë operacion për përmirësimin e argjinaturave. Ky plan përmirësimi është pajisur me leje nga Ministria e Mjedisit pa kontestime për kushtet e argjinaturës ekzistuese.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Në lidhje me gjurmët e hidrokarbureve të evidentuara në tokë në vendndodhjen e instalimit, subjekti shprehet se janë normale për një aktivitet rafinerie dhe për këtë arsye e gjithë sipërfaqja është e shtruar me asfalt beton, dhe nuk përbën burim ndotje të ujërave nëntokësore pasi nuk është rrjedhë e vazhdueshme.

Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendosi:

Shfuqizimin e masës administrative gjobe në vlerën 1,000,000 lekë.

*Nga komisioni nuk është dokumentuar dhe arsyetuar me dokumentacion i gjithë aktiviteti mbas transferimit të tij tek subjekti “A.G.O” realizimin e plan përmirësimi edhe për argjinaturave. Zbatimin e lejes nga Ministria e Mjedisit për kushtet e argjinaturës ekzistuese.*

Komisioni: E.K, D.S, E.M, M.P, A.K.

**ANKUESI:** Subjekti “G.A.C” Shpk me nr NIPT L8.....21 nuk disponon leje (nga QKB-ja, leje mjedisit të tipit C me PN-9351-09-2019 dhe titull instalimi “Industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve) me Vendim Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-TR-2021-000195-5 datë 06.10.2021, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën 1.500.000 lekë për shkelje të kërkesave ligjore të nenit 62, pika 6 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2021.

**OBJEKTI:** Shfuqizim i aktit administrativ “Vendimit Përfundimtar të Inspektimit AKM-TR-2021-000195-2. datë 06.10.2021 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, i marrë në bazë të procesverbalit të Inspektimit të AKM-TR-2021-000195-1.

Inspektoret Shtetëror të autorizuar për të kryer inspektimin: -z.I.A dhe z.B.D.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit në mbështetje të Ligjit Nr 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe subjekti është gjobitur me masën gjobë prej 1,500,000 lekë.

- Masa administrative është vendosur pasi në momentin e kontrollit subjekti nuk paraqiti asnjë dokument transferimi sipas VKM 229, datë 23.04.2014 për evadimin e mbetjeve tip “Metal”.

Me shkresën Nr. 5033 Prot , datë 20.10.2021 subjekti ka paraqitur ankimin administrativ kundër Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, në të cilin subjekti pretendon se nuk ka kapacitet për tu klasifikuar për leje mjedisi të tipit B pasi operon vetëm me 4 ura për riparim makinash. Ndërkohë përse i përket shkeljes së konstatuar nga inspektorët subjekti shpjegon se kontrata e transferimit e mbetjeve të ngurta metalike ka ekzistuar prej vitesh (bashkëlidhur kontrata). Nga verifikimet subjekti para ndryshimeve të Ligjit Nr. 10448/20211 me Ligjin 52/2020, subjekti G.A.C nuk klasifikohet si subjekt që duhet të pajiset me leje të tipit B, pasi referuar shtojcës së këtij ligji , industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve, konkretisht riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike duhet të kenë kapacitet të barabartë me 5 ura ose më shumë se kaq, për tu pajisur me Lejet e Mjedisit të tipit B. Mbështetur në VKM Nr.568 “Për krijim, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” paragrafi 2, në përgjegjësitë funksionale të AKM-së përfshihet inspektimi dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore të kushteve mjedisore të subjekteve të pajisur me leje mjedisore.

- Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendosi:

Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,500,000 lekë.

*- Nga komisioni nuk është arsyetuar dalja e subjektit për inspektim kur nuk ka kushtet për pajisje me leje mjedisore.*

Komisioni: E.K, D.S, E.M, M.P, A.K.

**ANKUESI:** Subjekti “K.K.A” me nr. NIPT K7.....2V me Vendim Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-TR-2021-000027-5 datë 14.07.2021, ka marrë masë administrative gjobë në vlerën



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

500.000 lekë për shkelje të kërkesave ligjore të nenit 29, pika 1.b.ii të Ligjit Nr. 10448, “Për Lejet e Mjedisit, i ndryshuar.

OBJEKTI: Shfuqizim i aktit administrativ “Vendimit Përfundimtar të Inspektimit AKM-TR-000027-5 datë 14.07.2021 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, i marrë në bazë të procesverbalit të Inspektimit të AKM-TR-2021-000027-2.

Inspektoret Shtetëror të autorizuar për të kryer inspektimin: znj. F.M dhe z.I.A.

- Gjatë shqyrtimit të ankimit të subjektit “K.K.A” me NIPT K7.....2V dhe leje mjedisi me PN-1177-11-2015, administrator i subjektit sqaron se duke qenë se aktiviteti i tij është prekur nga pandemia ka bërë kërkesë në QKB për ndryshim të aktivitetit. Me ndryshimet e bëra dhe zvogëlimin e aktivitetit ka dërguar edhe kërkesën për revokim të lejes së mjedisit në QKB dhe për një vlerësim të gabuar nga ana e tij ka menduar se vet sistemi e anulonte lejen pas kërkesës në QKB. Për këtë arsye nuk ka dorëzuar Raportin Vjetor dhe Raportin Periodik të vetë monitorimit.

- Pas inspektimit nga trupa inspektuese dhe shkeljeve në Procesverbalin e Inspektimit Nr. AKM-TR-2021-000027-2 datë 14.06.2021, subjekti me shkresën nr. 3033 Pro, datë 02.07.2021 i është drejtuar AKM-së me kërkesën për revokim të Lejes Mjedisore.

Nga analiza e fakteve të përmendura nga të dyja palët arsyeton se gjatë marrjes së masës administrative nga grupi i inspektimit nuk është marrë parasysh pika 2 e nenit 6 të ligjit nr 10433 datë 16.06.2011 për “Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” I cili citon se: *2-Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet të marrë Inspektori ,në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë seksion apo merr atë masë që është më e domosdoshme dhe e përshtatmë për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës që cenon më pak të drejta apo interesat e ligjshëm të subjektit të inspektimit.*

- Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendosi: Shfuqizimin e masë administrative gjobë në vlerën 500,000 lekë.

***Për vitin 2022 janë përzgjedhur 5 dosje për shqyrtim.***

**ANKUESI:** K shpk, NIPT L0.....1C me objekt aktiviteti: “ Nxjerrje, shfrytëzim, përpunim dhe transport i mineraleve” Me Leje Mjedisi Tipi B me PN-5755-09-2017.

OBJEKTI: Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr.AKM-DQ-2022-000512-5, datë 24.10.2022 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për masën administrative gjobë në vlerën 500.000 lekë.

Inspektoret shtetëror të autorizuar për të kryer inspektimin z.XH.H dhe z.H.B.

- Subjekti ka ankimuar Vendimin Përfundimtar të Inspektimit AKM-DQ-2022-000512-5, datë 24.10.2022 të inspektorëve të inspektimit mjedisor të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për masën administrative gjobë në vlerën 500,000 lekë për shkelje të kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 61, germa a/b dhe c) të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

Subjekti i ka bashkëlidhur ankimit administrativ dokumente shtesë si më poshtë:

- Vendim Nr. 2586, datë 04.04.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

CD me dokumentacion.

- Referuar Procesverbalit të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000512-2, datë 27.09.2022: “Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve:

- Neni 48 i Ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” “Operatori ka mospërputhje në lidhje me koordinatat e lejes mjedisore dhe gjendjes faktike ne terren”.

- Neni 62, pika 61 i Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, “Operatori ka depozituar mbetje sterile jashtë zonës së sipërfaqes së shfrytëzimit”.





**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

- Neni 29, i Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar “Operatori nuk dispononte regjistrin e mbetjeve sterile dhe dorëzuar në institucionet përkatëse”.

Bazuar në gjetjet e reflektuara në Procesverbalin e Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000512-2, datë 27.09.2022 ndaj subjektit “K” shpk, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000512-5 datë 24.10.2022 është vendosur masa administrative gjorbë në vlerën 500.000 lekë, për shkelje të kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 61, germa a/b/c e Ligjit Nr. 10468, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” si dhe Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

- Me ankimin administrativ regjistruar pranë AKM-së me Nr. 9054 Prot., datë 16.11.2022, subjekti paraqet këto pretendime:

1. Së pari, në lidhje me detyrën e parë për t’u plotësuar që është lënë nga inspektorët, subjekti sqaron se koordinatat e lejes mjedisore që disponon janë në përputhje me lejen minerare të shfrytëzimit. Përsa i përket aktivitetit minerar, subjekti pretendon se zhvillohet plotësisht brenda koordinatave të lejes së shfrytëzimit e si rrjedhojë edhe asaj mjedisore. Përgjithësisht nga kjo bën vetëm pjesë e daljes së galerisë, e cila është jashtë sipërfaqes së shfrytëzimit të lejes minerare, por ndodhet në brendësi të territorit të një leje tjetër minerare shfrytëzimi ku marrëdhënia midis shoqërive dhe e drejta për këtë aktivitet është e rregulluar me vendim gjykate. Ky ndryshim i cili ka ardhur për efekt zbatimi të projektit të shfrytëzimit, është deklaruar në institucionet përkatëse të lejeve të shfrytëzimit dhe është miratuar me Vendim Gjykate të formës së prerë. Subjekti pretendon se ky vendim gjykate i jep të drejtën e zhvillimit të aktivitetit në territorin e shoqërisë tjetër. Gjithashtu sqaron subjekti gjendja faktike e aktivitetit në dalje të galerisë dhe depozitimit të mineralit dhe sterililit është e pamundur që ky aktivitet dhe kjo sipërfaqe të futet në lejen minerare të shfrytëzimit e për rrjedhojë as në lejen mjedisore edhe për faktin se ky lloj aktiviteti nuk është pjesë e listës së aktiviteteve që duhet të pajisen me leje mjedisi në zbatim të Ligjit 52/2020, që do të thotë që për këtë pjesë nuk mund të pajisen as me leje mjedisi të veçantë.

2. Së dyti, në lidhje me shkeljen e dytë të konstatuar në lidhje me mbetjet sterile të dala nga procesi i shfrytëzimit, subjekti sqaron se mbetjet sterile janë depozituar brenda territorit të lejuar me vendim gjykate, territori i cili është në dalje të galerisë i përket një shoqërie tjetër të licensuar me leje minerare shfrytëzimi dhe leje mjedisore, por brenda së cilës pretendon subjekti i është dhënë e drejta e depozitimit të mineralit dhe sterililit. Përsa i përket akt-marrëveshjes që citohet nga inspektorët, objekti i kësaj akt-marrëveshje ajo nuk ka si objekt menaxhimin e integruar të mbetjeve në kuptim të nenit 21 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Kjo akt-marrëveshje është nënshkruar për depozitimin e mbetjeve sterile sic dalin nga galeria. Subjekti me të cilin është lidhur akt-marrëveshja, ka leje shfrytëzimi dhe leje mjedisore për aktivitetin e tij, ku në përgjegjësi të tij janë edhe menaxhimi i sterileve të galerisë tonë. Ky subjekt nuk është një operator që merret me menaxhimin e mbetjeve pasi referuar edhe në nenin 4 “Përgjithësisht”, germa e), pika IV, e Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, mbetjet sterile të aktivitetit minerar nuk konsiderohen mbetje, si të tilla nuk janë objekt i këtij ligji dhe as objekt i operatorëve të licensuar për menaxhimin e tyre.

3. Së treti, gjetja e konstatuar në pikën 3 në lidhje me regjistrin e mbetjeve, subjekti pretendon se regjistri i mbetjeve sterile është pjesë e raportit vjetor dhe e raporteve 6-mujore të raportimit të zbatimit të kushteve të lejes mjedisore, si shtojca IV, raporte të cilat janë dorëzuar pranë AKM-së. Gjithashtu, pranë AKM-së është dorëzuar edhe Regjistri i Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (bashkëngjitur ankimit administrativ në format CD). Për këtë lloj aktiviteti nuk parashikohet në asnjë ligj, akt nënligjor, udhëzim apo kusht leje së mjedisit që të mbahet në një regjistër të veçantë si dhe të dorëzohet veçmas në AKM. Nëse Kushti Nr. 12 dhe 12.2 nuk do të ishte zbatuar nga ana jonë, vazhdon subjekti, AKM pas dorëzimit të raporteve 6-mujore dhe vjetore, do të kishte kthyer përgjigje zyrtare në lidhje me mosplotësimin e këtij kushti.



- Komisioni, pasi analizoi procedurën e inspektimit, aspektet procedurale të pretendimeve vlerëson se:

Referuar shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave në një afat kohor të arsyeshëm:

Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës Vendimin e gjykatës s nr.2586 datë 04.04.2011 të Rrethit Gjyqësor Tirane e cila ka vendosur: *1. Pranimin e kërkesë padisë, 2. Detyrimin e të paditurve “ACR” Shpk, dhe METE të lejojnë paditësin shoqëria “K” Shpk të pajisur me leje minerare shfrytëzimi nr. 1483 datë 21.07.2010 në objektin “galeria 44” zona D, të kalojë në galerinë fushore “B” më gjatë si 128 m lineare duke filluar nga hyrja e galerisë për transportin e mineralit dhe te sterilin në galerinë 44, me gjatë si 224 m, sipas planimetrisë së aktit të aktit të ekspertimit. Rrugë n automobilistike nga hyrja e galerisë fushore B deri ne dalje të rrugës nga kufiri i fushës minerare të subjektit ACR për në rrugën nacionale (1500m) sheshin e depozitimit të mineralit dhe sterilin në sipërfaqe 500m2 në dalje të galerisë B.*

Vendim i cili ka marrë formë të prerë më datë 21.03.2012 nga Gjykata e Apelit Tiranë e cila ka vendosur: *“Lënien më fuqi të vendimit të shkallës së parë”*.

Referuar vendimit të gjykatës e përcaktuar se subjekti “K” ka të drejtë të kalojë nëpërmjet servitutit të kalimit, në koordinatat e lejes së shfrytëzimit të subjektit “ACR” duke qënë se referuar nenit 277 të KC *“Pronari që nuk ka dalje në rrugën publike dhe nuk mund ta sigurojë atë përveç se me shpenzime të mëdha e me vështirësi, ka të drejtë të ketë rrugë kalimi nga toka fqinje, për përdorimin e përshtatshëm të pronës së vet”*, subjekti e ka të domosdoshme kalimin nëpërmjet këtij territori për të bërë të mundur shfrytëzimin e galerisë 44 zona D.

Si rrjedhojë, subjekti “K” bën vetë me kalimin nëpërmjet koordinatave të shfrytëzimit të subjektit “ACR”, shfrytëzimin e galerisë e bën në koordinatat e përcaktuara në lejen minerare dhe atë mjedisore.

*Të marrë masa ku mbetjet sterile të dala nga procesi i shfrytëzimit të dërgohen në një instalim të përshtatshëm për trajtimin përfundimtar të tyre, referuar nenit 21 pika 5 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar pika 1: Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vet ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacioni trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar. Personat fizik a juridik të licensuar, që grumbullojnë ose transportojnë mbetje, dorëzojnë mbetjet e grumbulluara ose të transportuara në impjante trajtimi të përshtatshme që plotësojnë kërkesat e këtij ligji, nga verifikimi në sistemin e QKB-së, operatori me të cilin ka lidhur akt-marrëveshje shoqëria K shpk për dërgimin e mbetjeve sterile rezulton e pa pajisur me leje apo licensa përkatëse për trajtimin e tyre.*

Subjekti ka lidhur një marrëveshje më datë 05.08.2022 me subjektin “M.I” me objekt “Depozitimi i sterilin të dalë nga aktiviteti nëntokësor i zhvilluar nga subjekti “K”, referuar dhe vendimit të gjykatës (argumentuar në paragrafin më lart).

Duke qënë se ligji nr. 10463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në nenin 4 “përjashtime” germa e) pika IV, mbetjet sterile të aktivitetit minerar nuk konsiderohen mbetje dhe si të tilla nuk janë objekt i këtij ligji dhe as objekt i operatorëve ekonomik të licensuar për menaxhimin e tyre.

Gjithashtu referuar dhe relatimit të përfaqësuesit të subjektit, nuk është detyrim i subjektit për të ruajtur dokumentet e transferimit pasi nuk kryhen transferime sipas VKM-së 229 datë 23.4.2014 për mbetjet.

*Të dorëzojë regjistrin e sasive të mbetjeve çdo 6 muaj pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit sipas Kushtit 12, dokumentet dhe raportimet, pika 12.2: “Subjekti duhet të mbajë regjistër për sasitë e mbetjeve të gjeneruar, rikuperuar dhe magazinuara, si dhe të raportoj çdo 6 muaj pranë AKM-së në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi se ka apo nuk ka format raportimi, duhet ti drejtoheni institucionit kompetent i cili ka vendosur këtë kusht për mënyrën se si duhet ky format.”*



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Informacioni dhe regjistri i mbetjeve sterile janë pjesë e raportit vjetor dhe e raporteve periodike të zbatimit të kushteve të lejes së mjedisit, (raporti periodik i protokolluar në AKM me nr.6281 prot datë 12.08.2022) tek shtojca IV “menaxhimi i mbetjeve” sqarohet se mbetjet sterile të gjeneruar gjatë ushtrimit të aktivitetit depozitohen në vendin e përcaktuar me vendim gjykate të formës së prerë.

Në AKM është dorëzuar dhe regjistri i shkarkimeve dhe transferimit të ndotësve, protokolluar në AKM me nr.2512 prot., datë 29.03.2022.

Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsytimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendosi:

-Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 500,000 lekë.

**ANKUESI:** U.K.L sh.a, NIPT J6.....1M, me objekt aktiviteti: *“Shërbim i Ujit të pijshëm konsumatorëve dhe shitja e tij”, me Leje Mjedisit Tipi B me PN-1153-04-2022.”*

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-LE-2022-000070-5, datë 04.11.2022 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës për masën administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë.

Inspektorët shtetëror të autorizuar znj.J.SH, znj.B.L dhe znj E.B.

Subjekti ka ankimuar Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-LE-2022-000070-5, datë 04.11.2022 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës për masën administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë me shkresën Nr. 88 prot., datë 22.11.2022, e administruar pranë AKM-së me Nr. 9519 Prot, datë 25.11.2022.

Inspektimi ka që në me objekt: “Zbatueshmëri e kushteve të lejes së mjedisore PN-0471-06-2021 dhe Urdhër Nr. 217 datë 07.10.2022 ‘Për përcaktimin e rregullave për kryerjen e procedurave të inspektimit gjatë muajit tetor 2022’”. Subjekti nuk është njoftuar për inspektimin.

Referuar Procesverbalit të Inspektimit Nr. AKM-LE-2022-000070-2, datë 18.10.2022, Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në: Nenin 29, pika 1, germa b/ii të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar. Komente: *“Subjekti nuk i paraqiti grupit të punës dokumentet si më poshtë: Monitorim i shkarkimeve në ajër, ujëra dhe ujëra sipërfaqësor. Propozimin për regjistrin e shkarkimit të ndotjes. Programin e monitorimit të zhurmës. Programin e menaxhimit të mjedisit. Programin e menaxhimit të riskut. Asnjë raport 6 mujor vetmonitorimi.”*

Bazuar në gjetjet e reflektuara në Procesverbalin e Inspektimit Nr. AKM-LE-2022-000070-2 18.10.2022 ndaj subjektit “U.K.L sha”, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-LE-2022-000070-5, datë 04.11.2022 është vendosur masa administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë, për shkelje të kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 29, pika 1, germa b/ii e Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar.

- Në Ankimin Administrativ Nr. 88 prot., datë 22.11.2022 administruar pranë AKM-së me shkresën Nr. 9519 prot, datë 25.11.2022, subjekti paraqet këto pretendime:

Së pari, në shkresën përcjellëse për të paraqitur kontestimet ndaj Procesverbalit të Inspektimit Nr.AKM-LE-2022-000070-2, datë 18.10.2022, i është lënë afat kohor subjektit deri më datë 04.11.2022 për të paraqitur pranë ARM Shkodër, Lezhë, Kukës kontestimet për inspektimin e kryer. U.K.Lsh.a me shkresën Nr. 65 prot, datë 04.11.2022 ka dorëzuar pranë ARM Shkodër, Lezhë, Kukës gjithë dokumentacionin dhe kontestimet e hartuara, gjithashtu më datë 02.11.2022 është dorëzuar edhe pranë AKM-së gjithë dokumentacioni ligjor konfirmuar kjo me shkresën Nr. 8663 Prot., datë 02.11.2022. Gjithashtu, me shkresën e regjistruar pranë AKM-së me Nr. 8680 Prot., datë 03.11.2022 është dorëzuar pranë AKM-së gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor: Masat e ndërmarra përpara vendosjes në funksionim të instalimit, Plani i menaxhimit të mbetjeve, Operimi dhe Infrastruktura; Programi i Menaxhimit të Riskut; Dokumenti i vlerësimit të riskut; Plani i Përputhshmërisë; Dokumentimi dhe raportimi; Programi i monitorimit të zhurmës;



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Programi i Menaxhimit të Mjedisit; Incidentet dhe veprimet gjatë emergjencave; Politika dhe Plani i Parandalimit të aksidenteve; çmontim, rehabilitim dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve. Por, ndërkohë më datë 04.11.2022 subjekti është njohur me shkresën e ARM Shkodër, Lezhë, Kukës Nr. 1156/1 Prot., datë 04.11.2022 përcjellja e Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nëpërmjet të cilit ishte vendosur masë administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë, për shkelje të kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 29, pika 1, germa b/ii e Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar. Sa më sipër, subjekti pretendon se nuk është respektuar neni 45, pika 4 e Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”: *“Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu, informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit të inspektimit janë pjesë e dosjes.”*

Sa më sipër, me ankimin administrativ Nr. 9519 prot, datë 25.11.2022 dhe gjatë seancë dëgjimore shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Lezhë” sh.a kërkon përfundimisht shfuqizimin e Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-LE-2022-000070-5 datë 04.11.2022, të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës dhe pranimin e ankimit të tij administrativ.

Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsytimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendosi:

Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 500,000 lekë.

**ANKUESI:** R.P, NIPT J8.....4C, objekti i aktivitetit:“ Bar, restorant, birrari, hoteleri-turizëm import-eksport të mallrave të ndryshme industriale, bujqësore, ushqimore etj”.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. 976-3, datë 19.08.2022 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tiranë, Durrës, Dibër, për masën administrative gjobë në vlerën 1.000.000 lekë.

Inspektoret Shtetëror të autorizuar z.I.A dhe z.I.N.

Subjekti ka ankimuar Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. 976-3, datë 19.08.2022 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tiranë, Durrës, Dibër, për masën administrative gjobë në vlerën 1.000.000 lekë me shkresën protokolluar pranë AKM-së me Nr. 10/1 prot, datë 02.09.2022 administruar pranë AKM-së me shkresën Nr. 7394 prot, datë 21.09.2022. (Ankimi i paraqitur brenda afatit pasi Vendimi Përfundimtar mban datën 12.08.2022).

Subjekti nuk ka bashkëlidhur ankimit administrativ dokumentet shtesë.

- Në Ankimin Administrativ protokolluar pranë AKM-së me Nr. 7195 prot, datë 14.09.2022, subjekti paraqet këto pretendime:

Së pari, inspektorët kanë vendosur dënim administrativ kryesor për dy shkelje ligjore të parashikuara si vijon:

a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime dhe

b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar. Pra janë dhënë dy dënime kryesore nga 1 milion lekë për mostrajtimin mjedisor të ujërave të përdorura në vlerën maksimale në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, si dhe për mosdorëzim të mbetjeve të vajit ushqimor të përdorur tek një shoqëri e licencuar.



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

Së dyti, sqarohet se Shoqëria P.R ka rrjet kanalizimesh i cili është parë konkretisht edhe nga inspektorët gjatë inspektimit dhe se ky sistem kanalizimesh është i lidhur me U.K.K, sipas edhe faturës së ujësjellësit që i kemi vënë në dispozicion ARM Tiranë.

Së treti, lidhur me mbetjet sqarohet se kemi një kontratë të lidhur me subjektin “P.S” shpk, e cila bën tërheqjen e mbetjeve si dhe shërbime të tjera sipas rastit. Po ashtu, në bazë të Vërtetimit të Bashkisë Kavajë, shoqëria H shpk paguan edhe tarifë pastrimi vjetore për shërbimet e ofruara nga organi vendor, i cili ka kontratat përkatëse me subjekte të trajtimit të mbetjeve.

- Së katerti, në lidhje me vajrat, subjekti sqaron se ka një kontratë me subjekt të licencuar në trajtimin e vajrave shoqërinë “O.A”, e cila bën tërheqjen e vajrave të djegur ushqimor.

I gjithë dokumentacioni i cituar më sipër, subjekti pretendon se ja ka vënë në dispozicion ARM Tiranë e cila është njohur me to por nuk i ka marrë parasysh.

Nga ana e organit administrativ për më tepër nuk ka asnjë shpjegim të situatës faktike apo shpjegim konkret mbi rrethanat e faktit, bazueshmërinë e tij në ligj, vlerësim të provave të pretenduara etj.

- Më datë 03.10.2022 subjekti paraqiti në e-mail zyrtar [info@akm.gov.al](mailto:info@akm.gov.al) informacion shtesë për Komisionin e Ankimit në të cilin ka dërguar: aktet e tërheqjes së vajit ushqimor dhe kontratë sipërmarrje për realizim puseve për para trajtimin e ujërave të shkarkimit.

Subjekti përfundimisht kërkon shfuqizimin e Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. 976-3, datë 19.08.2022 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tiranë, Durrës, Dibër dhe pranimin e ankimit administrativ.

-Komisioni, pasi analizoi procedurën e inspektimit, aspektet procedurale dhe materiale të pretendimeve vlerëson se:

Në lidhje me pretendimin se janë vendosur dy masa administrative kryesore, grupi i inspektimit ka iniciuar inspektimin jashtë programi me objekt zbatueshmërinë e dispozitave ligjore të ligjit Nr.9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” dhe ligjit Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar.

- Përsa i përket gjetjeve të konstatuara për mungesën e kontratave me subjekte të licencuar, duke qenë se ligji për këto lloj kontratash nuk parashikon në mënyrë eksplicite një formë të caktuar për vlefshmërinë e tyre, mbetet të provohet vlefshmëria e kësaj kontrate nëpërmjet paraqitjes nga ana e subjektit të dokumenteve shoqëruese si fatura dhe dokumente transferimi të cilat rrjedhin në zbatim të objektit të lidhjes së kontratës që nga data e nënshkrimit të saj.

Referuar dokumentacionit të paraqitur së bashku me ankimin, vlerësohet se subjekti nuk ka paraqitur dokumente vërtetuese për zbatimin e objektit të lidhjes së kontratës “Tërheqjen e vajit të përdorur”, sipas formatit tip për dokumentet e transferimit në zbatim të ligjit Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar dhe pikës 7 të nenit 21, por konstatohet se dokumentet e paraqitura janë në formatin Word, çka rrjedhimisht sjell pavlefshmërinë e aktit.

- Referuar kontratës së shërbimit të lidhur me shoqërinë “E.A” Sh.a me objekt “Realizimi nga ana e sipërmarrësit në favor të investitorit të pusëtës dekantuese”, më datë 02.06.2022 e paraqitur në dokumente shtesë për komisionin e ankimit, bie në kundërshtim me relatimin e subjektit në komisionin e ankimit më datë 29.09.2022 ku citon se “nuk kanë gropë dekantimi, por janë të lidhur me kanalizimet e Kavajës”, çka sjell pavlefshmërinë e kontratës së paraqitur dhe dokumentit të transferimit për llumrat nga gropa septike (dokument i cili nuk përmbush kushtet formale të dokumentit të transferimit referuar pikës 7 të nenit 21 të ligjit nr. 10 463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar).

Gjithashtu, grupi i inspektimit referuar nenit 41 të ligjit nr. 10 433 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” kanë vërtetuar me foto/video (pjesë e procedurës së inspektimit dhe dosjes së komisionit), se në momentin e inspektimit shoqëria kryente shkarkime të pakontrolluara në mjedisin ujor pritës.



Në konkluzion, duke qenë se janë konstatuar dhe faktuar dy gjetje të ndryshme në kundërshtim me ligjet e sipërcituara, Komisioni në zbatim të pikës 2 të nenit 6 “Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, inspektori, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë sanksion apo merr atë masë që është domosdoshme dhe e përshatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës dhe që cenon më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të subjektit të inspektimit” të nenit 6 “Parimi i proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit” të ligjit nr. 10433 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, vendosi ndryshimin e vendimit për masat administrative, duke lënë në fuqi masën administrative për shkeljen e dispozitës ligjore nenit 6, germa i/ii/iii dhe nenit 23, germa ç të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotur”, dhe dënim administrativ plotësues “Pezullim i pjesshëm i përkohshëm i aktiviteteve që gjenerojnë mbetje”.

Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendosi:

-Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1.000.000 lekë.

Komisioni. Ka në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar konkretisht:

a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.

b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar.

Argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë. Mban përgjegjësi Komisioni: A.D, D.S, N.N, K.M, A.K.

**ANKUESI:** Shoqëria “F” shpk, NIPT J6.....8V, me objekt aktiviteti: “Prodhim i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jo metalike për fraksionizmin e materialeve inerte”, me Leje Mjedisore Tipi B, PN-9688-12-2019.

**OBJEKTI:**Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022, datë 12.08.2022 të Drejtorisë Qendrore të AKM-së për masën administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë.

-Inspektoret shtetëror të autorizuar z.XH.H dhe z.H.B.

- Referuar Procesverbalit të Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000343-1: “Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve: - Neni 29, pika 1, germa b/ii e Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar. Komente: “Operatori ka mospërputhje me koordinatat e lejes mjedisore dhe gjendjen faktike në terren pasi ka sipërfaqe të cilat janë jashtë koordinatave, imipanti i fraksionimit, një pjesë e bunkerit, disa transportier si dhe një sasi e lëndës së parë janë jashtë kësaj zone, po ashtu operatori nuk ka kryer rrethimin e perimetrit me bimë autoktone dhe raportuar në institucionet shtetërore”.

Bazuar në gjetjet e reflektuara në Procesverbalin e Inspektimit Nr. AKM-DQ-2022-000343-2, datë 14.07.2022 ndaj subjektit “F” shpk në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr AKM-DQ-2022, datë 12.08.2022 është vendosur masa administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë, për shkelje të kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 29, pika 1, germa b/ii e Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar.

- Komisioni, pasi analizoi procedurën e inspektimit, aspektet procedurale dhe materiale të pretendimeve vlerëson se:

Përsa i përket gjetjes së inspektorëve në lidhje me mospërputhjen e koordinatave të lejes mjedisore që subjekti disponon, kjo referuar verifikimeve nga sistemi ASIG Geoportal, konstatohet se nga



verifikimi në faqen zyrtare të ASIG, azhornimi i fundit për ortofotot është bërë në vitin 2015. Subjekti F shpk është pajisur me lejen mjedisore objekt inspektimi në vitin 2019.

Nisur nga ky fakt, si dhe nga fakti që grupi i inspektimit nuk ka vërtetuar me foto/video referuar nenit 41 të ligjit nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, gjendjen faktike që vërtetojnë konstatimet e kryera në terren, për daljen jashtë koordinatave, verifikimi i koordinatave nga sistemi ASIG nuk mund të merret në konsideratë duke qenë se pasqyron një gjendje terreni përpara momentit të inspektimit.

-Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendosi: Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 300,000 lekë.

**ANKUESI:** P.S shpk, NIPT L8.....8U, objekti i aktivitetit: “ Hapje dhe menaxhim baresh, restorantesh, hotelesh, fast-food etj. Shërbime turistike.”

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. 975-3, datë 12.08.2022 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tiranë, Durrës, Dibër, për dy masa administrative gjobë në vlerën 1.000.000 lekë secila.

-Inspektoret shtetëror të autorizuar z.H.K, z. I.A, z.I.N.

Referuar gjetjeve të pasqyruara në Procesverbalin e Inspektimit Nr. 975-2 datë 27.07.2022 gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 23 të Ligjit Nr. 9115 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” si dhe nenin 62 të Ligjit Nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Në rubrikën “Këshillime”: “*Subjekti të lidhë dhe të paraqesë kontratat dhe dokumentet e transferimit të mbetjeve urbane teknologjike. Të ndërpresë menjëherë veprimet e vetmenaxhimit të mbetjeve urbane, ujërave të zeza dhe ato teknologjike*”.

Referuar gjetjeve të pasqyruara në Procesverbalin e Inspektimit Nr. 975-2 datë 27.07.2022 në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. 975-3 datë 12.08.2022, ndaj subjektit “P.S” shpk, është vendosur masa administrative gjobë në vlerën 1.000.000 lekë, për shkelje të kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 6, gërma i/ii/iii dhe nenit 23, gërma ç të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotur”, si edhe masë administrative gjobë në vlerën 1.000.000 lekë, për shkelje të kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 21 pika 1 dhe pika 2 si edhe nenit 62, pika 3 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” si edhe Dënim Administrativ Plotësues: “Pezullim i pjesshëm i përkohshëm i aktiviteteve që gjenerojnë mbetje, Korrigjim i shkeljeve të konstatuara dhe eliminim i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm”.

Në Ankimin Administrativ protokolluar pranë AKM-së me Nr. 6873 prot, datë 02.09.2022, subjekti paraqet këto pretendime:

Së pari, inspektorët kanë vendosur dënim administrativ kryesor për dy shkelje ligjore të parashikuara si vijon:

a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.

b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar. Pra janë dhënë dy dënime kryesore nga 1 milion lekë për mostrajtimin mjedisor të ujërave të përdorura në vlerën maksimale në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, si dhe për mosdorëzim të mbetjeve të vajit ushqimor të përdorur tek një shoqëri e licencuar.

Së dyti, inspektimi ka qenë i programuar, por ndërkohë subjekti nuk është njoftuar për inspektimin me njoftim paraprak të Autorizimit të Inspektimit.



Së treti, referuar pikës 22 të Listë-Verifikimit cilësohet nga inspektorët se subjekti nuk disponon leje mjedisore ndërkohë që aktiviteti që ushtron subjekti nuk përfshihet në shtojcën e aktiviteteve që duhet të pajisen me leje mjedisore.

Së katërti, subjektit i është lënë afat 15 ditë kohë nga njoftimi i Procesverbalit të Inspektimit për të paraqitur dokumente provues lidhur me gjetjet e konstatuara, konkretisht lidhur me depozitimin e mbetjeve urbane, largimin e ujërave të ndotur të patrajtuar me shoqëri të licensuar, si dhe dorëzimin e vajit ushqimor një shoqërie të licensuar. Për arsye objektive shoqëria nuk ka mundur ti paraqes këto brenda afatit të lënë nga inspektorët por i ka bashkëlidhur ankimit administrativ: Kontratë Shërbimi Nr. 1, datë 05.06.2022, me objekt grumbullimin, tërheqjen, transportin e vajit ushqimor të përdorur, si mbetje jo të rrezikshme, e lidhur me shoqërinë “O.A” shpk. O.A 2. Kontratë shërbimi datë 27.07.2022 me objekt “Evadimin e mbetjeve të gropave septike dhe mbetjeve urbane” lidhur me shoqërinë “A.P” shpk. Shoqëria A.P” 3. Vërtetim me Nr. 669/1, datë 29.09.2020 nga Bashkia Durrës që subjekti depoziton mbetje urbane të gjeneruara nga aktiviteti në vendin e përcaktuar nga Bashkia.

Subjekti përfundimisht kërkon shfuqizimin e Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. 975-3, datë 12.08.2022 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tiranë, Durrës, Dibër dhe pranimin e ankimit administrativ.

Në konkluzion, duke qenë se janë konstatuar dhe faktuar dy gjetje të ndryshme në kundërshtim me ligjet e sipërcituara, Komisioni në zbatim të pikës 2 “*Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, inspektori, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë sanksion apo merr atë masë që është domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës dhe që cenon më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të subjektit të inspektimit*” të nenit 6 “*Parimi i proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit*” të ligjit nr. 10433 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*” vendosi ndryshimin e vendimit për masat administrative, dukë lënë në fuqi masën administrative për shkeljen e dispozitës ligjore nenit 6, germa i/ii/iii dhe nenit 23, germa ç të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “*Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotur*”, dhe dënim administrativ plotësues “*Pezullim i pjesshëm i përkohshëm i aktiviteteve që gjenerojnë mbetje*”.

Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendosi: Shfuqizimin e masës administrative gjorbë në vlerën 1,000,000 lekë.*

Komisioni ka marrë në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar konkretisht:

- a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “*Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur*” të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.
- b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*” i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licensuar.

Argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur Shfuqizimin e masës administrative gjorbë në vlerën 1,000,000 lekë, mban përgjegjësi Komisioni: A.D, D.S, N.N, K.M, A.K.

*Për sa më lart më hollësisht është mbajtur Projektraporti i Auditimit nisur me nr. 562/7, datë 22.11.2023, për të cilin në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë paraqitur observacione me shkresën nr. 562/8, datë 20.12.2023; nr. 9757/1, datë 22.12.2023, marrës KLSH, me nr. 562/15, datë 22.12.2023; nga nëpunësit: A.D, E.K, D.S, A.K, M.P.*

**- Në lidhje me pretendimi se:** Marrja e vendimit mbi ankimin e paraqitur nga subjekti “K.I”, “A.K”, “R.P”, “P.S” Komisioni i Ankimit nuk ka kompetencë për të sugjeruar inspektim specifik me mjete matëse pasi një inspektim i tillë do të cilësohej si “*Ri inspektim*” ose “*Inspektim jashtë programi*” që sipas ligjit “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, janë të përcaktuara





**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

*përgjashtimisht rastet kur mund të ndodhin, masat administrative të jetë në përputhje me shkeljet dhe e përshtatëshme për arritjen e qëllimit të inspektimit.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** *në lidhje me observacionin nuk merret në konsideratë. Në shqyrtimin në themel nuk është zbatuar neni 10 i Rregullores nr. 1526/1 prot., datë 06.04.2021 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për “Procedurën e shqyrtimit të ankimeve administrative” pasi nuk ka të dokumentuar kërkimin e dokumentacion apo të dhëna në mbështetje të pretendimeve të inspektorëve.*

<b>Titulli i Gjetjes</b>	<b>Apelimet e</b>
<b>Situata:</b>	<p>1.Subjekti “K.I” me Nr. AKM-FR-2020-00007-5 datë, 25.09.2020 i është vendosur masë administrative gjobë 2.000.000 lekë. Nga konstatimi në shkelje të nenit 39 të Ligjit Nr. 110/2012 datë 15.11.2020 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (i ndryshuar). Komisioni i AKM-së pasi ka shqyrtuar ankimimin administrativ referuar analizave dhe fakteve të pretenduara ka vendosur të shfuqizojë masën administrative të marrë, ne mbështetje të pikës 4 nenit 137, Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.</p> <p>2.Subjekti “A.K” me Nr. AKM-TR-2020-000087-1 datë 12.11.2020 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit i është vendosur masë administrative me vlerë 300.000 lekë. Subjekti është gjobitur ne shkelje “Për Lejet e Mjedisit”, për mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve te lejes përkatës te mjedisit ti tipave A, ose B nga operatori në një instalimi. të vendosur nga inspektorët e Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tirane, për shkelje të nenit 29 pika 1/b,ii të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar. Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendosi: Shfuqizimin e masë administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë.</p> <p>3. R.P, objekti i aktivitetit:“ Bar, restorant, berrari, hoteleri-turizëm import-eksport të mallrave të ndryshme industriale, bujqësore, ushqimore etj”.</p> <p>Komisioni. Ka në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar konkretisht:</p> <p>a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.</p> <p>b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar.</p> <p>Argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë.</p> <p>4. P.S shpk, objekti i aktivitetit: “ Hapje dhe menaxhim baresh, restorantesh, hotelesh, fast-food etj. Shërbime turistike.”</p> <p>Komisioni. Ka marrë në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar konkretisht</p> <p>a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.</p> <p>b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar.</p>



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

	Argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur Shfuqizimin e masës administrative gjorbë në vlerën 1,000,000 lekë.
<b>Kriteri:</b>	Ligji Nr. 110/2012 datë 15.11.2020 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (i ndryshuar); Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”; Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur”; Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar dhe pikës 4 nenit 137, Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos aplikimi i sanksioneve në subjektet problematike dhe me risk në ndotjen e mjedisit duke mos parandaluar ndotjen e mjedisit nga subjektet zhvillues e të pajisur me leje mjedisore.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i legjislacionit Për inspektimin dhe mbrotjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandime:</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Sektori i Ankimimeve, (Apelimi, Ekzekutimi dhe Trajtimi i Penaliteteve) në rastet e ndryshimeve të vendimeve të analizojë vendosjen e masave administrative të pa mbështetura ligjërisht duke propozuar edhe masa administrative për personat përgjegjës.

## **2.7. Të tjera gjate auditimit, indicet e ankesa të administruara në KLSH.**

Në lidhje me ankesat administruar në KLSH u shqyrtuan: Ankesat se bashku me dokumentacionin shoqëruar, si dhe dokumentacioni i administruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

### **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:**

#### **I. Ankesa me Nr.prot 990 datë 27.10.2022 protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit**

Në ankesë theksohet se Drejtori i Përgjithshëm ka rekrutuar në mënyrë jo ligjore 2 punonjëse, të cilat i ka ngritur në përgjegjësi jo në përputhje me ligjin konkretisht znj. M.P dhe përgjegjësja e sektorit të ankimimeve dhe znj.N.N.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në AKM mbi *procedurat e rekrutimit të punonjësve* rezultoi:

**I.1)**Departamenti i Administratës Publike ka hapur shpalljen për “Lëvizje paralele”, “Ngritje në detyrë”, “Pranim nga jashtë shërbimit civil” në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese për pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit të Impaktit dhe Licencimit” në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”-kategoria III-a.

Procedura e aplikimit është në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga znj.M.P.

Me shkresën Nr 4389 prot ,datë 14.07.2022,bazuar në nenin 26, të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunës civil “, i ndryshuar, si dhe Kreun III, të Vendimit Nr. 242,datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vende të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, i ndryshuar emërohet nëpunës civil në këtë pozicion znj. M.P.

-Znj.M.P aktualisht është në pozicionin, Drejtor në Drejtorinë e Lejeve Mjedisore dhe VNM, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kategoria e pagës II-b, emëruar me shkresën Nr, 2184/1 prot, datë 31.03.2023.

**I.2)** Departamenti i Administratës Publike ka hapur shpalljen për “Lëvizje paralele”, “Ngritje në detyrë”, “Pranim nga jashtë shërbimit civil” në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Ankimimeve (Apelimi Ekzekutim dhe Trajtimi i Penaliteteve),në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit”, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.



Me shkresën Nr. 4412 prot ,datë 14.07.2022, bazuar në nenin 26, të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunës civil “, i ndryshuar, si dhe Kreun III, të Vendimit Nr. 242,datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vende të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, i ndryshuar emërohet nëpunës civil në këtë pozicion znj. N.N.

Procedura e aplikimit është në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga znj.N.N.

-Znj.N.N aktualisht është në pozicionin, Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Financës dhe Buxhetit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kategoria e pagës III-a/1, emëruar me shkresën Nr. 2231/1 prot, datë 31.03.2023.

Nga dokumentacioni i administruar dhe i audituar u konstatua se në emërimin dhe ngritjen në detyre nga ristrukturimi i Institucionit për të dy rastet është vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**II. Në ankesën e subjektit “E.T.H.H shpk” protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me Nr 854 prot, datë 04.10.2023,** kërkohet Shfuqizimi i aktit administrativ Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-BR-2023-000077-5, datë 19.09.2023, të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë, për masën administrative “Paralajmërim”, pasi është vepruar në kundërshtim me ligjin.

Nga dokumentacioni i administruar dhe audituar rezultoi:

Subjekti i ka bashkëlidhur ankimit administrativ këto dokumente shitesë:

- Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-BR-2023-000077-5, datë 19.09.2023, të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë.

- Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, Nr. 2566, datë 24.09.2021.

Objekti i inspektimit për E.TH.H : *“Në trajtim të ankesës së ardhur nga AMBU me Nr. 1111 Prot., datë 13.07.2023 ‘Informacion i përditësuar për HEC-et që prodhojnë energji elektrike duke përdorur në mënyrë të jashtëligjshme burimet ujore’, deleguar për trajtim nga AKM, protokolluar pranë ARM Berat, Elbasan, Korçë me Nr. 746 Prot., datë 31.07.2023”*.

Njoftim paraprak i autorizimit të inspektimit është kryer me shkresën Nr. 782 Prot., datë 02.08.2023 të ARM Berat, Elbasan, Korçë.

Procesverbali i Inspektimit Nr. AKM-BR-2023-000077-2, si dhe Lista e Verifikimit Nr. AKM-BR-2023-000077-2/1 janë gjeneruar në datë 31.08.2023 dhe i janë njoftuar subjektit me shkresën Nr. 782/2 Prot., datë 31.08.2023 të ARM Berat, Elbasan, Korçë.

Vendimi Përfundimtar i Inspektimit Nr. AKM-BR-2023-000077-5, është gjeneruar në datë 19.09.2023 dhe i është njoftuar subjektit me shkresën Nr. 782/4 Prot., datë 19.09.2023 të ARM Berat, Elbasan, Korçë.

Referuar gjetjeve të pasqyruara në Procesverbalin e Inspektimit Nr. AKM-BR-2023-000077-2 datë 31.08.2023 cilësohet se *“Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve: Nenin 41, pika 1/a/c të Ligjit Nr. 111.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i ndryshuar”*.

Komente: *Nga inspektimi i kryer për trajtim të ankesës të ardhur nga AMBU me Nr. 1111 Prot., datë 13.07.2023 protokolluar pranë ARM Berat, Elbasan, Korçë me Nr. 746 Prot., datë 31.07.2023, në subjektin E.TH.H me aktivitet prodhim energjie HEC, Helmes 2, u konstatua se subjekti nuk është i pajisur me Leje Përdorim të Burimit Ujor, të lëshuar nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore. Subjekti ka kryer aplikimet për t’u pajisur me leje të përdorimit të burimit ujor por kërkesa i është refuzuar nga AMBU. Në kushtet e refuzimit të kërkesës subjekti i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë e cila me vendimin e saj Nr. 2566, datë 24.09.2021 ka vendosur :- pranimin e padisë si të bazuar në ligj dhe prova.- Shfuqizimin e Vendimit Nr. 51, datë 26.04.2021, Vendimin Nr. 52, datë 26.04.2021, Vendimin Nr. 53, datë 26.04.2021 të AMBU, - Detyrimin e palës së paditur AMBU të miratojë kërkesën e shoqërisë E.TH.H për leje përdorim burimi ujor për Hecet Kozel, Helmes 1, Helmes 2 duke respektuar sasishtet e përdorimit të ujit për furnizimin e popullsisë dhe nevojat për ujitje gjatë*



*afatit të koncesionit të përcaktuar në kontratën koncesionare Nr. 119 rep. Nr. 94 Kol, datë 12.01.2011. Gjithashtu pala paditëse ka kërkuar gjatë gjykimit edhe marrjen e masës së sigurimit të padisë por gjykata e ka rrëzuar kërkesën e palës paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Aktualisht çështja është në gjykim në gjykatën e Apelit dhe ende nuk ka një vendim të formës së prerë”.*

Referuar Listë-Verifikimit AKM-BR-2023-00077-2/1 datë 31.08.2023, janë reflektuar gjetjet si më poshtë:

Pika Nr. 3 “A është i pajisur me leje përdorim burimi ujor nga organet e menaxhimit të burimeve ujore?” : *“Subjekti nuk është i pajisur me leje për përdorim burimi ujor nga organet e menaxhimit të burimeve ujore”.*

Sa më sipër, referuar gjetjeve të pasqyruara në Procesverbalin e Inspektimit si edhe në Listë-Verifikim, ndaj subjektit “E.TH.H ”, me Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-BR-2023-000077-5, datë 19.09.2023 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë është vendosur masë administrative “Paralajmërim”.

Në Ankimin Administrativ Nr. 118, datë 02.10.2023, regjistruar pranë AKM-së me Nr. 8235 Prot., datë 04.10.2023, subjekti paraqet këto pretendime:

- Bazuar në pikën 1 të nenit 43 të Ligjit Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i ndryshuar parashikohet se: *“Dhënia e koncesioneve për përdorimin e burimeve ujore bëhet në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat dhe aktet nënligjore që përcaktojnë kërkesa dhe procedura për dhënie e koncesioneve., në interpretim të kësaj dispozite subjekti pretendon se aktiviteti i tij duhet të trajtohet sipas ligjit koncesionar edhe përsa i përket lejeve të burimit ujor.*

- Gjithashtu po në referencë të ligjit Nr. 111/2012 AMBU e ka të përcaktuar qartë se çfarë përgjegjësish ka, kjo sipas pikës 2 të nenit 43: *“Organi kontraktues i menaxhimit të burimeve ujore kombëtare mban regjistrin e koncesionit. Ky regjistër administrohet dhe ruhet nga organi përkatës kontraktues, sipas kërkesave të ligjit për arkivat”.*

- Sa më sipër, subjekti pretendon se përderisa është i pajisur me kontratë koncesionare me aktivitet 35 vjeçar aktiviteti i tij duhet të trajtohet me ligjin e koncesionit, dhe nuk është e nevojshme pajisja me leje përdorim burimi ujor, pasi është e shprehur qartë në ligj ku thuhet se: *“Organi kontraktues i menaxhimit të burimeve ujore kombëtare mban regjistrin e koncesionit. Ky regjistër administrohet dhe ruhet nga organi përkatës kontraktues, sipas kërkesave të ligjit për arkivat”.*

- Bazuar në germën c, të pikës 5 të Vendimit Nr. 416, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimit ujor”*: Në rastet e përdorimit të ujërave me koncesion, afati i përdorimit do të jetë në përputhje me afatet e koncesionit”. Referuar po këtij Vendimi Nr. 416, datë 13.05.2015, shprehet qartë se aktivitetet e ngjashme nuk kanë leje me afat kohor por respektohet legjislacioni koncesionar. Sa më sipër, pavarësisht se si sillet AMBU, VKM Nr. 416, datë 13.05.2015, shprehet qartë që subjekti duhet të trajtohet me ligjin koncesionar. Në zbatim të shkronjës ç) të pikës 27 të VKM-së Nr. 550/220 parashikohet se afati i vlefshmërisë së lejeve në rastet e përdorimit ujor për koncesion, do të jenë në përputhje me afatet e koncesionit, në rastin konkret 35 vjet. Ky argument, pretendon subjekti në ankimin administrative, gjen mbështetje edhe në praktikat e tjera të ndjekura nga Këshillat e Baseneve Ujore, në kërkesat e bëra nga koncesionet, ku pas miratimit në parim të lejes së përdorimit ujor, vijohet me miratimin e kërkesës me afat vlefshmërie sa afati i kontratës koncesionare.

- Së fundi subjekti thekson faktin se nuk ka asnjë kundërvajtje administrative duke vepruar gjithmonë me seriozitet dhe kjo vërtetohet edhe me dokumentacionin e dorëzuar grupit të inspektimit gjatë procedurës së inspektimit. AMBU-ja duke vazhduar shkeljet administrative dërgon shkresë për të inspektuar subjektin E.TH.H, duke qenë në dijeni të plotë të vendimit të



gjykatës administrative të shkallës së parë, Tiranë, vendim që e detyron atë si institucion të japë në afatin e koncesionit lejen e shfrytëzimit të burimeve të Kozelit.

Për sa më lart, subjekti E.TH.H kërkon konstatimin e pavlefshmërisë dhe shfuqizimin të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. AKM-BR-2023-000077-5, datë 19.09.2023 të inspektorëve të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë. Ankimimi i depozituar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve pranë AKM, në momentin e auditimit nuk është shqyrtuar ankimi pasi janë brenda afati ligjor të shqyrtimit.

#### IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

##### A MASA ORGANIZATIVE

**1- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimeve u konstatua se, në 3 raste në prokurimet e kryera nga Autoriteti Kontraktor konkretisht:

1. Urdhër Prokurimi Nr. 10, Datë 17.07.2020. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban”,
2. Urdhër Prokurimi Nr. 5, Datë 25.03.2021. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni lëvizës”,
3. Urdhër Prokurimi Nr. 134, datë 16.06.2022. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje reagentësh dhe materiale laborator”,  
- Njësia e Prokurimit, në hartimin e DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, “Kapaciteti teknik”, ka kërkuar: “Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, si dhe “Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, duke vepruar në kundërshtim me (VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 3 ç’fuqizuar) VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 4.

##### Në 1 rast

-Urdhër Prokurimi Nr. 09, Datë 05.05.2022 zhvillimi procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim projektimi i godinës së Agjencisë”. Në dosjen e paraqitur, nuk u gjet dokumentacion nga Njësia e Prokurimit, lidhur me sigurimin dhe hartimin e specifikimeve teknike/termat e referencës si dhe për përlllogaritjen e fondit për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë. Veprime në kundërshtim me ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, neni 124; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011, ” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 29-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1- Rekomandimi:** Njësia e Prokurimit të Autoritetit Kontraktor për çdo procedurë prokurimi të marrë masa që në hartimin e kriterëve të veçanta të plotësojnë Dokumentet Standarde të Tenderit në përputhje me rregullat e prokurimit publik për të mundësuar trajtim të barabartë dhe konkurrues midis konkurrentëve pjesëmarrës.

Në vijimësi

**2- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimeve me blerje të vogël u konstatua se:

- në 1 rast, prokurimi me vlerë të Vogël në vitin 2022 “Shërbim eksperti për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit”. Në dosjen e paraqitur, nuk u gjet dokumentacion i kërkuar sipas Ftesë Ofertës datë 16.03.2022 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, lidhur me sigurimin dhe hartimin e specifikimeve teknike/termat e



**Kontrolli i Lartë i Shtetit**  
**Raport Përfundimtar Auditimi “Agjencia Kombëtare të Mjedisit”**

referencës, si dhe dokumentacion për punësimin e 2 inxhinierëve me eksperiencë të diplomuar në fushat elektronike, elektrike (pasi fotokopjet e paraqitura nuk vërtetojnë punësimin dhe marrëdhëniet e punës me këta inxhinierë). Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021), Neni 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” pika 4. (Më hollësisht trajtuar në, faqet 29-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1- Rekomandimi:** Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël në ç’do procedurë prokurimi të marrë masa që të plotësojnë Dokumentet Standarde të Tenderit në përputhje me rregullat e prokurimit publik për të mundësuar pasqyrim të saktë të procedurës.

**Në vijimësi**

**3- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i komunikimit shkresor midis AKM dhe QKB u konstatua se: në regjistrin e lejeve ekzistojnë leje me format të vjetër, VNM/Deklarata Mjedisore si dhe subjekte të pajisur me leje mjedisore apo VNM pa raportuar asnjëherë konkretisht, 1274 Leje Mjedisore format i vjetër si dhe 590 VNM/Deklarata Mjedisore. Nga të cilat rezultojnë se subjekte disponues të këtyre lejeve mjedisore aktualisht janë me status pezulluar dhe jo aktiv në 271 raste që korrespondojnë me leje mjedisore format i vjetër si dhe 71 raste që korrespondojnë VNM/Deklarata Mjedisore. Mos azhurnimi dhe përditësimi i të dhënave të subjekteve pajisur me leje mjedisore është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 30 pika 1 dhe 2. (Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që të planifikojë kryerjen e inspektimeve në subjekte të konstatuar me leje mjedisore model i vjetër për të mundësuar evidentimin e veprimtarisë ose jo dhe për rastet me shkelje t’i kërkojë Ministrit të Turizmit dhe të Mjedisit për pezullim apo shfuqizimin e lejeve mjedisore.

**Deri në 31.03.2024**

**3.2- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit të marrë masa që të unifikojë bazën e të dhënave mbi Lejet Mjedisore mbi të cilën operojnë Drejtori e Sektorë të AKM, duke mundësuar edhe përditësimin unik të saj.

**Deri në 31.05.2024**

**4- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në 13 raste për të njëjtin instalim nga i njëjti subjekt ka dy apo më shumë leje mjedisore (PN) të lëshuar në vite, megjithëse është aprovuar Leja Mjedisore e re, në asnjë rast nuk është revokuar Leja Mjedisore e vjetër, konkretisht:

Nr.	Emri Subjektit	NIPT	Vitet e Lejeve Mjedisore
1	P.G.T	K 3.....5S	2014-2022
2	A.W	K8.....2B	2013-2022
3	A.B.H	K3.....1E	2013-2016
4	A.G2015	L5.....0F	2012-2016
5	D	L2.....1A	2012-2018
6	A.B	J6.....0D	2011-2018
7	P.M	K6.....2B	2011-2018
8	A	K1.....1T	2011-2015-2018
9	T	K2.....1I	2011-2012 s’ka te re
10	B.T	J6.....1F	2011-2021
11	P.X	K1.....2O	2011-2013
12	M.P	K6.....0H	2011-2019
13	A.G.T	L1.....1C	2011-2022

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 8 “Kërkesat e përgjithshme për përdorimin e lejes së mjedisit të tipit A” pika 1 dhe 2 ; neni 20 “Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B” pika 1 dhe 2; si dhe neni 30 pika 1 dhe 2. (Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



**4.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të marrë masa që të kërkojë revokimin e lejeve model i vjetër nga subjektet “P.G.T” me NIPT, K 3.....5S; “A.W” me NIPT K8.....2B; “A.B.H” me NIPT K3.....1E; “A.G2015” me NIPT L5.....0F; “D” me NIPT L2.....1A; “A.B” me NIPT J6.....0D; “P.M” me NIPT K6.....2B; “A me NIPT K1.....1T; “T” me NIPT K2.....1I; “B.T” me NIPT J6.....1F; “P,X” me NIPT K1.....2O dhe “M.P” me NIPT K6.....0H.

**Deri në 31.03.2024**

**5- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në 15 raste nga komisioni i verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimit të lejeve mjedisore në AKM janë miratuar kërkesa në mungesë dokumentacioni të kërkuar ligjor.

- Në 1 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 25 i zhvilluar në datë 25.06.2020 u shqyrtua kërkesa e subjekti “A.K” nga AKM nuk ka sqarime të dokumentuara për mos zbatimin e afatit të lëshimit dhe publikimit të Lejes mjedisore të përcaktuar në Kreu III “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit B” .

- Në të 8 rastet nga komisionet janë miratuar Lejet Mjedisore për subjektet, por në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka të ngarkuar VNM. Konkretisht: Në mbledhjen e Komisionit nr. 8 i zhvilluar në datë 04.03.2021.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “N2010” LC 64161. Në mbledhjen e Komisionit nr. 3 i zhvilluar në datë 12.02.2021 janë shqyrtuar kërkesat e subjekteve “E”; “A.A” LC 9160 dhe “B.T”. Në mbledhjen e Komisionit nr. 8 i zhvilluar në datë 26.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E.R” LC 1275. Në mbledhjen e Komisionit nr. 48 i zhvilluar në datë 24.12.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “V.A.L.E.R” LC 3162. Në mbledhjen e Komisionit nr. 6 i zhvilluar në datë 11.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A”. Në mbledhjen e Komisionit nr. 2 i zhvilluar në datë 22.01.2020 u shqyrtuan kërkesa e subjektit “R.O” LC 6325. Në mbledhjen e Komisionit nr. 16 i zhvilluar në datë 27.04.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E.A”.

- Në 2 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 14 i zhvilluar në datë 10.04.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “Z.I” LC 8285 dhe në mbledhjen e Komisionit nr. 3 i zhvilluar në datë 12.02.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E.E” LC 7860 nga ku në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka kontratë për depozitimin e mbetjeve dhe ka kontratë për depozitim mbetjesh lidhur më 01.07.2021 me “Ndërkomunal Bushat” në adresën Bashkia Vau i Dejës Nj.A. Bushat, ndërkohe veprimtaria zhvillohet ne Durrës.

- Në 1 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 6 i zhvilluar në datë 11.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A” nga ku aplikimi është pranuar pa dokumentacionin për shkarkimin e ujërave teknologjike.

- Në 1 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 64 i zhvilluar në datë 24.05.2022 u shqyrtuan kërkesa e Subjekti “K.F” nga ku në dosjen e vënë në dispozicion për auditim (formatin PDF) nuk ka Formularin e dëgjimit në publik.

- Në 1 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 53 i zhvilluar në datë 06.05.2022 u shqyrtuan kërkesa e subjektit “P,X” ku nga dokumentacionin e paraqitur në PDF si dhe ngarkuara në sistem pagesa e tarifës është bërë në datë 15.04.2022 mbas datë s së aplikimit i cili mban datë n 17.03.2022.

- Në 1 rast, në mbledhjen e Komisionit nr. 48, i zhvilluar në datë 06.10.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A,C” LC 7088 nga ku miratim në heshtje pa akt-miratimi.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 4; nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 1040, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar; ligjin me nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” ; VKM nr. 575, datë 24.6.2015; VKM nr. 419, datë 25.06.2014; si dhe VKM nr. 538, datë 26.5.2009. (Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



**5.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të marrë masa që të kërkojë revokimin e lejet mjedisore të miratuar pa dokumentacionin e kërkuar ligjor për subjektet: “N2010”; “E”; “A.A”; “B.T”; “E.R”; “V.A.L.E. R“A”; “R.O”; “E.A”; “Z.I”; “E.E”; “K.F”; “P,X”; “A,C”.

**Deri në 31.03.2024**

**6- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Sektori i Monitorimit në Drejtorinë e Inspektimit dhe Kontrollit në AKM nuk ka bërë evidentimin e subjekteve të pajisur me leje mjedisore A dhe B në lidhje me likuidimin e tarifës vjetore të lejeve detyrë kjo funksionale e përcaktuar në rregulloren e AKM-së. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 417 datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit”, (ndryshuar me VKM-në nr. 462, datë 26.7.2023). (Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për të hartuar një bazë të dhënash unike ku të përcaktohen detyrimet e pagesës të tarifave vjetore të lejeve mjedisore nga subjektet që rezultojnë në Regjistrin Kombëtar të lejeve dhe licencave, në QKB me përditësimin nga arkëtimet.

**Deri në 31.05.2024**

**7- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- Nga verifikim i pajisjeve me Kod Unik Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit për 6 subjekte ka miratuar 13 kode unik, kemi miratime të Kodit Unik sa herë subjekti ka aplikuar për ndryshim të licencës, ndryshim Kodesh mbetjesh si dhe shtim të vendndodhjeve.

- Për periudhën objekt auditimi nuk ka patur një rakordim/ndërveprim të dokumentuar midis Drejtorive Teknike dhe Inspektoratit në AKM pasi: Regjistri i licencave nuk është i mirë organizuar; Regjistri Kombëtar i Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme nuk është i azhurnuar në kohë me raportimet e transfertave dhe regjistrimet e Kodit Unik nga subjekte të pajisur me licencë III.2.B.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në nenet 62 dhe 63; VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020), Pika 19; si dhe VKM nr. 371, datë 11.6.2014, “Për Miratimin e Rregullave për Dorëzimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe të Dokumentit të Dorëzimit të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 1032, datë 16.12.2020), Pika 25. (Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit ti kërkojë Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit për të marrë masa për revokimin e më shumë se një Kodi Unik për të 6 subjektet: “V.A.L.E. R“4 A-M”; “A.P”; “E.P”; “G.C”; “ELC”.

**7.2- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që: Regjistri Kombëtar i Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme të azhurnohet në kohen reale të transfertave të deklaruara për të patur shkëmbim informacioni shkresor midis Drejtorive Teknike dhe Inspektoratit në AKM.

**Deri në 31.03.2024**

**8- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në 4 raste ka miratime të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në shkelje të procedurave ligjore konkretisht:

- Në 1 raste kemi miratim të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis **Subjekti B** me Komisionin nr. 64 Tiranë, më 23.12.2020 për projektin “Dallgëthyesë (pistë) dhe stacion shërbimi” Qerret, Kavajë. Miratimi i VNM pasi ka mbaruar vepra si është cilësuar edhe në raportin teknik të paraqitur.

- Në 2 raste





- **Subjekti A.S** nga AKM me Vendimin nr. 7, datë 07.02.2020 ka miratuar Deklaratën mjedisore, me dokumentacion për dëgjuesën me publikun në vend ndodhjen e instalimit mbajtur në 13.11.2018 jo konform modelit të përcaktuar dhe pa pjesëmarrje publiku të dokumentuar me nënshkrime të rregulla nga ana vizuale. Megjithëse AKM me shkresë nr. 3105, datë 20.06.2019 “Njoftim për vazhdim procedure të VNM të thelluar” në qëndrimin e saj ka kërkuar plotësimin e informacionit me Konsultimin me publikun.

- **Subjekti “G.B”**, komisioni nr. 06, datë 03.02.2022 ka miratuar “Deklarata Mjedisore” për projektin “Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike” (Ndërtim HEC “guri i bardhë 1 dhe 2) subjektit “G.B”.

- Nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura janë vendosur kushte në lidhje me afërsinë e Objektivit me Zonën e Mbrojtur.

- Në historikun e aplikimit pasqyruar në sistem konstatohet se në datë 07.09.2021 nga Njësia e Qeverisjes Vendore Klos është marrë “Aprovim automatik në heshtje” nga kërkesa e dërguar po në datë 31.08.2021. Nga Agjencia Rajonale e Mjedisit nuk është e dokumentuar qëndrimi i banorëve që kanë marrë pjesë në peticionin kundër objektit, si dhe nuk ka sqarime apo korespondencë me NjQV Klos mbi peticionin e banorëve për të cilin është shprehur në shkresën e datë s 21.04.2020.

- **Në 1 rast** me Vendimin nr. 45, datë 26.08.2020, vendosi Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për Zhvilluesin Personi juridik: **“G-G” sh.p.k**. Në dokumentacionin e administruar në sistemin “e-leje” nuk ka shkresë nga AKZM në shqyrtim të pozicionimit të karrierës në lidhje Zonën e Mbrojtur çka përbën kusht për shqyrtimin dhe dhënien e lejes mjedisore

Veprime në kundërshtim me: Ligjin nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”; VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar.; si dhe VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 65-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që të planifikojë kryerjen e inspektimeve në subjekte, B, A.S, G,B dhe G-G, për vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedis.

**Deri në 31.03.2024**

**9- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se **në 9 raste** në kryerjen e inspektimeve referuar dokumentimin on-line ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative, konkretisht:

- Proces–verbali i inspektimit datë 25.08.2020; Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. 5, datë 28/09/2020 në subjektin **“E” shpk NIPT: K3.....2W**. Grupi i inspektimit në dokumentacionin e inspektuar nuk ka paraqitur pajisjen të subjekt “E.K” me Licencë III. 2. B, si dhe paraqitja Regjistrave për menaxhimin e mbetjeve nuk është në përputhje me kërkesat ligjore. Për këtë nuk është vepruar me Masat Administrative të përcaktuara në ligjin nr. 10463/2011.

- Procesverbali i inspektimit datë 03.11.2021 në **Subjektin: “A.C” shpk NIPT: K0.....1W**, dhe procesverbali i inspektimit datë 03.11.2021 në **Subjektin: “11H” shpk NIPT: K0.....1W**. Vendimet e inspektimit në të dy rastet korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm.

- Proces –verbali i inspektimit datë 04.11.2021 në **Subjektin: “G.D.F” NIPT: L8.....2M** Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative e klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobë: 500,000 lekë; Gjobë: 300,000 lekë; Gjobë: 1,000,000 lekë; Gjobë: 300,000 lekë. Aplikimi i dënimit kryesor me gjobe sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datë s 04.11.2021 dhe marrja e Vendimit datë 24.11.2021 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ me Gjobe në 4



raste nuk mbështetet dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës.

- Proces –verbali i inspektimit datë 30.06.2022, në **Subjektin: 4 A-M NIPT: K9.....6L**. Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit datë 14.07.2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ dhe është cilësuar “*Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive*”. Nuk është argumentuar mos aplikimi i Masës Administrative gjobë.

- Proces–verbali i inspektimit datë 12.05.2022 në **Subjektin: “B.V2013” NIPT: L3.....1V**. Nga Inspektorët nuk është konstatuar shkelja e mos pagesës së tarifës jashtë afatit në datë 10.05.2022. Nuk ka dokumentacion për argumentimin e mos aplikimit të Gjobjës së propozuar në Proces-Verbal datë 12.05.2022, dhe marrjen e Masës Administrative “paralajmërim”.

- Proces–verbali i inspektimit datë 16.11.2022 në subjektin **“C.L” NIPT: L7.....4C**. Nuk ka dokumentacion për mos aplikimit të Gjobjës për shkeljen e konstatuar. Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit datë 14/12/2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ “*.Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive*”.

- Proces–verbali i inspektimit datë 23.11.2022 në subjektin **D.B” NIPT: K9.....2R**. Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobjë: 300,000 lekë. Aplikimi i dënimit kryesor me gjobe sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datës 23.11.2022 dhe marrja e Vendimit datë 16/12/2022 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ.

- Proces–verbali i inspektimit datë 03.06.2022 në **Subjektin “P” NIPT: J6.....6G**. Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobjë: 300,000 lekë; Gjobjë: 1,000,000 lekë; Aplikimi i dënimit kryesor me gjobe sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datës 04.11.2021 dhe marrja e Vendimit datë 01.07.2022 për mos aplikimin e Dënimit Administrativ me Gjobe në 2 raste nuk mbështetet në dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës të Inspektimit.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", date 7/14/2011i ndryshuar, neni 29, Pika 1, ligjin nr.10463, “Për menaxhimin e integruar te mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar, nenin 21, pikat 9, 10, dhe nenit 57, si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm. (*Më hollësisht trajtuar në faqet 70-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektim Kontrollit të marrë masa për të analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për aplikimin e dënimeve administrative në Procesverbalet e Inspektimit dhe anulimin e tyre në Vendimet e marra, si dhe të planifikojë Inspektime për verifikim e konstatimeve dhe detyrave të lëna nga inspektimet në subjektet e inspektuara si dhe subjektet: “E” shpk NIPT: K3.....2W, "A.C" shpk NIPT: K0.....1W, "11H" shpk NIPT: K0.....1W, “G.D.F” NIPT: L8.....2M, 4 A-M NIPT: K9.....6L, “B.V2013” NIPT: L3.....1V, “C.L” NIPT: L7.....4C, D.B” NIPT: K9.....2R dhe “P” NIPT: J6.....6G.

**Deri në 31.03.2024**

**10- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në 6 raste në kryerjen e inspektimeve referuar dokumentimin on-line ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative, konkretisht:

**Në 1 rast,** Proces –verbali i inspektimit datë 08.06.2021 në subjektin **“E” shpk NIPT: K3.....2W**. Grupi i inspektimit në dokumentacionin e inspektuar nuk ka paraqitur “Kontratë



evadimi mbetje jo të rrezikshme” me subjekt të pajisur me Licencë III. 2. B, si dhe nuk referohen apo paraqiten Regjistrat për menaxhimin e mbetjeve. Duke mos vepruar me Masat Administrative **Në 5 raste**

- Proces–verbali i inspektimit datë 08.11.2022 në subjektin **B.B**
- Proces–verbali i inspektimit datë 09.11.2022 në subjektin **D.T**
- Proces–verbali i inspektimit datë 11.11.2022 në subjektin **G.J.L**
- Proces–verbali i inspektimit datë 08.06.2022 në subjektin **K.A.A**
- Proces –verbali i inspektimit datë 10.06.2022 në subjektin **N**

Në proces verbalet e inspektimit nuk është cilësuar mbarimi i afatit të lejes së përdorimit të basenit ujqor por vetëm aplikimi për rinovim të lejes, dhe nuk theksohet që hyrja në fuqi e lejes së përdorimit bëhet “Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve”

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar; ligjin nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar; VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020); Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Urdhri nr.13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e manualit të përgjithshëm. (Më hollësisht trajtuar në faqet 70-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektimit Kontrollit të marrë masa të planifikojë Inspektime për verifikim e konstatimeve dhe detyrave të lëna nga inspektimet në subjektet e inspektuara si dhe në subjektet: B.B, D.T, G.J.L, K.A.A dhe N, për verifikimin e pajisjes me leje përdorimi të basenit ujqor dhe aplikimin e kundërvajtjes administrative “gjobe”.

**Deri në 31.03.2024**

**11- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk ka inspektime të kryera me indicje nga rezultatet negative laboratorike për mostrat e mara në instalimet e subjekteve që ndotin mjedisin, konkretisht:

Për periudhën objekt auditimi sipas indicjeve janë kryer 33 analiza nga laboratorit i analizimit të mostrave, nga të cilat: 5 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga institucionet e tjera (Polici, Prokurori), 19 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga AKM apo Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, si dhe 9 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga Taks-Forcë për sezonin turistik 2022.

Në asnjë rast nuk ka informim për Drejtorinë e Inspektimit e Kontrollit mbi rezultatet e analizimit si për ato që kanë rezultuar me shkelje të normave të lejuara për mjedisin edhe për ato që kanë rezultuar brenda normave të lejuara. Inspektimet e kryera në këto subjekte janë sipas planifikimit të DIK, dhe në asnjë rast nuk kanë lidhje me rezultatet e analizimit të mostrave të ardhura në laborator apo të marra nga vetë specialistët e laboratorit.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448 “Për Lejet e Mjedisit”, date 7/14/2011 i ndryshuar; ligjin nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar; ligjin nr.10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar; Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; “Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit” me nr. 120, datë 12.01.2021. (Më hollësisht trajtuar në faqet 70-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të marrë masa:

-Të hartojë një bazë të dhënash të aksesueshëm mbi historikun e rezultateve të analizimit për subjektet në të cilët merren mostrat për analizim nga Drejtoria e Regjistrave Mjedisore e Inovacionit dhe Analizave Laboratorike.



-Të përcaktojë mënyrën shkresore për shkëmbim informacionesh midis drejtorive të AKM. Informacione këto për të përcaktuar riskun e inspektimeve dhe marrjen e masave për ndotësit e mjedisit.

**Deri në 31.03.2024**

**12- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga Drejtoria e Inspektimit dhe e Kontrollit për periudhën objekt auditimi janë hartuar e miratuar planë mujore inspektimi jo për tërë periudhën vjetore respektive konkretisht:

**Nga Sektori i Inspektimit të Mjedisit:**

-Për periudhën Gusht-Dhjetor 2020, vetëm për muajin Shtator.

-Për periudhën Janar–Dhjetor 2021 për 8 muaj, Muajt Janar-Shkurt, Maj –Qershor, dhe Gusht - Nëntor.

-Për periudhën Janar–Dhjetor 2022, për 11 muaj, Shkurt–Dhjetor.

**Nga Sektori i Inspektimit të Ujërave**

-Për periudhën Gusht-Dhjetor 2020, për 2 Muajt Gusht dhe Shtator.

-Për periudhën Janar–Dhjetor 2021, për 4 Muajt Qershor–Korrik dhe Nëntor-Dhjetor.

-Për periudhën Janar–Dhjetor 2022, për 5 Muajt Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Nëntor.

Në asnjë rast nuk ka analizë risku, në përzgjedhjen e veprimtarive apo subjekteve për inspektim dhe në asnjë rast nuk ka planifikim të kontrolleve për rekomandimet e lëna për përmirësimin e situatës mjedisore në rastet e konstatimit të shkeljeve.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 70-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektimit Kontrollit të marrë masa:

- Në planet vjetore të planifikoje edhe inspektimet për verifikimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e situatës mjedisore në rastet e konstatimit të shkeljeve.

- Në bazë të vlerësimit të riskut dhe përcaktimit të subjektet me risk të lartë me ndikim në mjedis. të hartojë Planin Strategjik të Inspektimeve dhe në përputhje e zbatim të tij të hartojë e të miratojë Planet Vjetore e Mujore të Inspektimeve.

**Deri në 31.03.2024**

**13- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i apeliave të masave administrative u konstatua:

1.Subjekti “K.I” me Nr. AKM-FR-2020-00007-5 datë, 25.09.2020 i është vendosur masë administrative gjohë 2.000.000 lekë. Nga konstatimi në shkelje të nenit 39 të Ligjit Nr. 110/2012 datë 15.11.2020 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (i ndryshuar). Komisioni i AKM-së pasi ka shqyrtuar ankimimin administrativ referuar analizave dhe fakteve të pretenduara ka vendosur të shfuqizojë masën administrative të marrë, ne mbështetje të pikës 4 nenit 137, Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

2.Subjekti “A.K” me Nr. AKM-TR-2020-000087-1 datë 12.11.2020 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit i është vendosur masë administrative me vlerë 300.000 lekë. Subjekti është gjobitur në shkelje “Për Lejet e Mjedisit”, për mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatës të mjedisit të tipave A, ose B nga operatori në një instalimi.

të vendosur nga inspektorët e Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tirane, për shkelje të nenit 29 pika 1/b,ii të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar. Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendosi: Shfuqizimin e masës administrative gjohë në vlerën 300.000 lekë.



3. R.P, objekti i aktivitetit: “ Bar, restaurant, birrari, hoteleri-turizëm import-eksport të mallrave të ndryshme industriale, bujqësore, ushqimore etj”.

Komisioni. Ka në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar konkretisht:

a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.

b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar.

Argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë.

4. P.S shpk, objekti i aktivitetit: “ Hapje dhe menaxhim baresh, restaurantesh, hotelesh, fast-food etj. Shërbime turistike.”

Komisioni. Ka marrë në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar konkretisht:

a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.

b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar.

Argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 92-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Sektori i Ankimimeve, (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve) në rastet e ndryshimeve të vendimeve të analizojë vendosjen e masave administrative të pa mbështetura ligjërisht duke propozuar edhe masa administrative për personat përgjegjës.

**Menjëherë e në vijimësi**

## **B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE NEGATIVE**

**1- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga mosrakordimi ndërmjet drejtorive dhe sektorëve të AKM-së për numrin e lejeve mjedisore, për vitet 2020 - 2021 evidentohet një diferencë tarife vjetore e pa arkëtuar prej 13 040 000 lekë. Gjithashtu nga evidentimi i bërë nga sektori i financës së AKM-së për periudhën 2015 deri më qershor 2020, janë evidentuar detyrime të tarifës vjetore për 840 subjekte në shumën 8 522 000 lekë. Në momentin e auditimit nga Sektorin e Financës në AKM nuk disponohet lista e 840 subjekteve debitorë. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të mundësojë evidentimin dhe arkëtimin e detyrimeve debitorë si dhe arkëtimin detyrime të tarifës vjetore nga 840 subjekte në shumën 8 522 000 lekë duke e evidentuar këto subjekte.

**Deri në 31.05.2024**

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.